

STRATEGJIA PËR SHQIPËRINË

E miratuar nga Bordi i Drejtorëve, më 4 prill 2006

Tryeza e Lëndës

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	2
1. PORTOFOLI I BANKËS	7
1.1 Pamje e përgjithshme e veprimtarive të deritanishme.....	7
1.2 Zbatimi i strategjisë së fundit	8
1.3 Efekti i tranzicionit dhe mësimet e nxjerra prej tij	9
1.4 Raporti dhe cilësia e portofolit.....	12
2. MJEDISI I PUNËS	13
2.1 Mjedisi i përgjithshëm i reformave	13
2.1.1 Mjedisi ligjor	14
2.1.2 Mjedisi	15
2.2 Ecuria në fushën e tranzicionit dhe reagimi i ekonomisë.....	15
2.2.1 Kushtet makroekonomike që lidhen me operacionet e Bankës	16
2.2.2 Sukseset dhe sfidat e tranzicionit	17
2.3 Mundësia e marrjes së kapitalit.....	19
3. ORIENTIMET STRATEGJIKE.....	21
3.1 Prioritetet e Bankës për periudhën e mbuluar nga strategjia	21
3.2 Sfidat sektoriale dhe objektivat e Bankës.....	21
3.2.1 <i>Infrastruktura, energjika dhe projektet bashkiake dhe mjedisore</i>	21
3.2.2 <i>Sektori i ndërmarrjeve</i>	24
3.2.3 <i>Sektori financiar</i>	25
4. BASHKËPUNIMI ME DONATORËT DHE IFN-të E TJERA.....	27
ANEKSI 1 – Vlerësim i Ligjeve Shqiptare për Shoqëritë Tregtare.....	30
ANEKSI 2 – Çështje politike dhe shoqërore	37
ANEKSI 3 – Sfidat e tranzicionit	43
ANEKSI 4 – Disa tregues të përzgjedhur ekonomik	47
ANEKSI 5 – Problemet mjedisore.....	48
ANEKSI 6 – Operacionet e miratuara të Bankës	50
ANEKSI 7 – Programet e Bankës për bashkëpunim teknik.....	52
ANEKSI 8 – Lista e projekteve në shqyrtim	56
ANEKSI 9 – Asistenca shumëpalëshe dhe dypalëshe	57
ANEKSI 10 – Harta e Shqipërisë	65

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria po vijon t'i plotësojë kushtet e paracaktuara në Nenin 1 të Marrëveshjes së Themelimit të Bankës. Zhvillimi i zgjedhjeve të fundit parlamentare, më datë 3 korrik 2005, ishte i përmirësuar në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, edhe pse ndodhën disa parregullsi dhe u desh që të përsëriten zgjedhjet në disa rrethe zgjedhore. Shumicën e vendeve në Kuvend i fitoi Partia opozitare Demokratike, edhe pse numri i tyre nuk ishte i mjaftueshëm për të formuar qeveri më vite. Pas një procesi të gjatë të nxjerrjes së rezultateve të zgjedhjeve, u formua në fillim të muajit shtator një qeveri koalicioni, me kryeministër Dr. Berishën. Partia e tij, Partia Demokratike, ka 10 prej 14 ministrave, ku katër ministrat e tjerë janë të secilës prej partnerëve më të vegjël të koalicionit. Kalimi i pushtetit nga qeveria socialiste te qeveria e re e koalicionit u bë në fillim të muajit shtator në mënyrë paqësore dhe relativisht pa probleme.

Shqipëria ka marrëdhënie të mira me fqinjët dhe luan një rol konstruktiv në rajon. Qeveria është treguar e matur në lidhje me pakicat e konsiderueshme shqiptare në Serbi e Mal të Zi dhe në IRJ të Maqedonisë. Bisedimet me BE-në për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit ("MSA") kanë nisur në vitin 2003. Negociatat për MSA-në kanë përfunduar dhe teksti i miratuar u siglua më 18 shkurt 2006. Ky tekst i është propozuar tani Këshillit Evropian për nënshkrim. Do të vazhdohet t'i kërkohet Shqipërisë të dëshmojë ecure të dukshme në lidhje me angazhimet, në fusha të tilla si reforma e sistemit të gjyqësorit dhe lufta kundër korrupsionit. Në të njëjtën kohë, Shqipëria po ndjek edhe rrugën drejt anëtarësimit në NATO.

Mjedisi makroekonomik ka vazhduar të jetë i favorshëm gjatë viteve të fundit, edhe pse deficioni i tregëtisë dhe deficioni fiskal, të dy të lartë, mbeten faktorë të ndjeshëm risku. Rritja ekonomike është e qëndrueshme, rreth shifrës 5-6 përqind, dhe ka si shtysë kryesore sektorët e ndërtimit, të shërbimeve të biznesit dhe të transportit. Papunësia zyrtare mbetet rreth shifrës 15 përqind e krahut të punës, por papunësia është e përhapur. Inflacioni vjetor i çmimeve të konsumatorit është ulur në shifrat 2-4 përqind. Norma e këmbimit valutor është relativisht e qëndrueshme, duke iu nënshtruar presionit për vlerësim dhe efektit sezonal të transfertave të ndryshueshme private nga jashtë (të remitancave) gjatë muajve të verës dhe të dimrit.

Shqipëria ka pasur një ecure të ndjeshme në lidhje me reformat e tranzicionit gjatë viteve të fundit por mbeten disa sfida të ndjeshme. Mjedisi i biznesit vuan nga një nivel i lartë korrupsioni, nga mangësi të rënda të gjyqësorit dhe nga një kapacitet shumë i dobët të institucioneve dhe strukturave që kujdesen për zbatimin e ligjit. Megjithë investimet e konsiderueshme gjatë viteve të fundit, infrastruktura nuk është në lartësinë e duhur për zhvillimin e sektorit privat, duke futur këtu rrjetin rrugor që nuk i përmbush standartet, mungesën e furnizimit me energji dhe vëmendjen e kufizuar që u tregohet pasojave mjedisore që shkakton aktiviteti i zgjeruar ekonomik. Një problem tjetër i ndjeshëm është edhe varfëria, sidomos jashtë zonës Tiranë-Durrës.

Sfidat që janë përpara qeverisë së re janë:

- Fuqizim i konsiderueshëm i sektorit publik, duke përfshirë luftën e efektshme dhe sistematike kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; përmirësim të efikasitetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit dhe të administratës publike, sidomos

të administratës doganore dhe tatimore; dhe zgjidhje të problemit të pronësisë së tokës;

- Përmirësime të infrastrukturës, duke përfshirë rritje të nivelit të sistemit rrugor, modernizim dhe zgjerim të porteve detare dhe të aeroporteve rajonale, ecuri në lidhje me ristrukturimin dhe privatizimin e ndërmarrjeve të shërbimeve komunale për të siguruar shërbime të qëndrueshme, sidomos në sektorët e energjisë dhe të telekomit, dhe një vëmendje më e madhe për çështjet mjedisore, duke përfshirë heqjen dhe largimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujrave të zeza, si edhe për çështjet mjedisore që lidhen me zgjerimin e sektorit privat; dhe
- Rritje e mundësisë për të marrë financim, sidomos për ndërmarrjet e vogla e të mesme jashtë zonës kryesore Tiranë-Durrës, si edhe përmirësim i mjedisit të biznesit për investimet e huaja të drejtpërdrejta (“IHD”) të cilat do të ndihmonin për zhvillimin e sektorit industrial.

Banka ka luajtur gjithnjë e më shumë një rol të rëndësishëm në procesin e tranzicionit të Shqipërisë: 21 operacione me financim të drejtpërdrejtë nga Banka prej 291 milion euro, dhe 709 milion të tjera nga mbështetës financiar dhe bashkëfinancues. Banka, në bashkëpunim të ngushtë me IFN të tjerë dhe me donatorë, mund ta rrisë edhe më tepër rolin e vet gjatë periudhës së mbuluar nga strategjia, duke u përqendruar në mënyrë më selektive te sfidat e evidentuara.

Operacionet e Bankës gjatë periudhës së mbuluar nga strategjia do të përqendrohen në pesë prioritet kryesorë të përgjithshme: (i) projekte të zhvillimit të infrastrukturës, të energjitikës, të infrastrukturës bashkiake dhe mjedisore; (ii) privatizim dhe ristrukturim i ndërmarrjeve komunale shtetërore që kanë mbetur (psh, në sektorin e telekomit, energjisë) dhe komercializimi i ndërmarrjeve komunale të pushtetit vendor (psh ujësjellës-kanalizime); (iii) zhvillim dhe konsolidim i sektorit financiar; (iv) IHD për ndërmarrjet vendore me vëmendje të veçantë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; dhe (v) dialog për politikën sidomos në fushat e rregullimit dhe të fuqizimit të tregjeve për infrastrukturën, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve dhe të institucioneve. Në mënyrë specifike, Banka do të përqendrohet te prioritetet e mëposhtme sektoriale:

Sektorët e infrastrukturës, energjitikës, bashkiakë dhe mjedisor: mbështetja e rindërtimit dhe ristrukturimit të sektorëve të transportit dhe energjitikës, sidomos brenda një konteksti rajonal, do të mbetet në fokusin kryesor të Bankës. Ku të jetë e mundur, Banka do të përpiqet për të kanalizuar financim afatgjatë për skemat e partneritetit privat-publik. Banka do të shikojë edhe mëvetësinë e strukturave të financimit që kanë si synim projektet mjedisore dhe të efikasitetit të energjisë.

Sektori i ndërmarrjeve: Paralelisht, do të ndiqen dy prioritetet: së pari, Banka do të vijojë të luajë një rol kryesor për nxitjen e zhvillimit të sektorit privat përmes financimit të investimeve ekzistuese dhe të investimeve të reja, me vëmendje të veçantë për investimet e brendshme në Shqipëri. Banka do të vijojë të plotësojë bankat vendore për kontratat e mëdha dhe do ta përqendrojë punën te mbushja e boshllëkut në lidhje me instrumentat e financimit që janë në dispozicion në treg për ndërmarrjet vendore përmes produkteve të përgatitura posaçërisht për këtë qëllim. Së

dyti, Banka do të mbështesë privatizimin dhe/ose komercializimin e ndërmarrjeve të mëdha mbetur në pronësi të shtetit.

Sektori financiar: Një objektivi parësor për Bankën do të jetë ripërtëritja e punës së saj për mbështetjen dhe nxitjen e huadhënies për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përmes bankave vendore. Banka do të shikojë mundësinë e ofrimit të produkteve të reja financiare të përshtatura për qëllimin e rritjes së huadhënies për NVM-të dhe të përmirësimit të aftësive të bankave vendore. Banka do të vijojë të mbështesë ristrukturimin dhe konsolidimin e sektorit bankar përmes investimeve të reja me pjesëmarrje në kapital të vet në bankat vendore dhe përmes pjesëmarrjes në proceset e bashkimit të mundshëm të bankave. Në sektorin financiar jobankar, Banka do të punojë për të mbaruar privatizimin e INSIG-ut.

Banka do të vijojë të kujdeset që të gjitha operacionet e BERZH-it në Shqipëri t'u nënshtrohen Politikave dhe Procedurave Mjedisore të Bankës dhe të trupëzojnë, ku duhet, Plane Pune Mjedisore.

Duke pasur parasysh sfidat e konsiderueshme të tranzicionit për Shqipërinë, Banka do të ketë nevojën, më shumë se kurrë, të donatorëve përsa i takon asistencës teknike, bashkëfinancimit me grante të infrastrukturave me rëndësi jetike dhe burimeve të lidhura me investimet. Banka do të punojë së bashku me BE-në, BEI-n, dhe donatorë të rëndësishëm, duke përmendur në mënyrë të veçantë Italinë, në kushtet e një dialogu të rritur për politikat dhe të një financimit më të madh të përbashkët.

Unë rekomandoj miratimin e kësaj strategjie.

Jean Lemierre

Lista e shkurtimeve

AREF	Fondi i Kapitalit për Rindërtim të Shqipërisë
KLV	Komisioni i Letrave me Vlerë
BEEPS	Studimi i Mjedisit të Biznesit dhe i Performancës së Ndërmarrjeve
BIA	Banka Italo-Shqiptare
BOO/BOOT	Ndërtoj-Zotëroj-Punoj (Build-Own-Operate) / Ndërtoj-Zotëroj-Punoj-Transferoj (Build-Own-Operate-Transfer)
BSEC	Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi
CEI	Nisma e Evropës Qendrore
BEI	Banka Evropiane e Investimeve
KE	Komisioni Evropian
ECSEE	Bashkësia e Energjitikës e Evropës Juglindore
ESAF	Linjë Financimi e Përshtatjes së Avancuar Strukture
BE	Bashkimi Evropian
IHD	Investimet e Huaja të Drejtpërdrejta
FEFAD	Foundation for Enterprise Finance and Development (<i>Fondacioni për Financimin dhe Zhvillimin e Ndërmarrjeve</i>)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
GEF	Linja Globale e Financimit të Mjedisit
GRECO	Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës Kundër Korrupsionit
GTZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
BNRZH	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore)
GJPN	Gjykata Penale Ndërkombëtare
SHNZH	Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (Banka Botërore)
KFN	Korporata Financiare Ndërkombëtare (Banka Botërore)
IFN	Institucion Financiar Ndërkombëtar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSIG	Instituti i Sigurimeve
INSTAT	Instituti i Statistikave
BJBN	Banka Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
KESH	Korporata Energjitike Shqiptare
KFOR	Forca për Kosovën – forca ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO-ja në Kosovë
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
IBM	Infrastruktura Bashkiake dhe Mjedisore
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
IFJB	Institucionet Financiare Jobankare
BKT	Banka Kombëtare Tregëtare
SKZHES	Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social
PfP	Programi i NATO-s “Partneriteti për Paqe”
PPP	Partneritet Privat-Publik
PRGF	Linjë Financimi për Uljen e Varfërisë dhe Rritjen Ekonomike
DSUV	Dokumenti i Strategjisë për Uljen e Varfërisë
REPO	Marrëveshje Riblerjeje
OECD	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit

AZZHB	Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SECI	Nisma për Bashkëpunimin Juglindor
SECP	Procesi i Bashkëpunimit në Evropën Juglindore
SEEP	Programi për Evropën Juglindore
BT	Bashkëpunim Teknik
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNEP	Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjensia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-ve
BB	Banka Botërore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetsisë

Monedhat

ALL	Leku shqiptar
EUR	Euro, monedha e Bashkimit Evropian
SDR	<i>Special Drawing Right</i> , “monedha” e FMN-së
USD	Dollari amerikan

Norma e këmbimit valutor

1 EUR	122 ALL
1 USD	102 ALL

1. PORTOFOLI I BANKËS

1.1 Pamje e përgjithshme e veprimtarive të deritanishme

Banka e ka mbështetur aktivisht Shqipërinë në përpjekjet për të ecur drejt një ekonomie të lirë tregu. Deri në fund të muajit dhjetor 2005, Banka kishte arritur një vëllim progresiv pune prej 291 milion euro, me një kosto totale të projekteve prej 1 miliard euro, në sektorë që mbulojnë energjitikën, telekomunikacionet, institucionet financiare, industrinë e përgjithshme, agrobiznesin dhe pronat (shih Aneksin 5). Portofoli i tanishëm arrin shifrën prej 233 milion euro, me 16 projekte, nga të cilët, 114.7 milion janë mjete të lëvruara neto.

Gjatë dy viteve të fundit, vlera neto e portofolit është rritur me 101 milion euro, ose 77%, ku rritja kryesore ka ardhur prej projekteve në sektorin e energjitikës dhe të transportit, ndërsa mjetet e lëvruara neto janë rritur me 194%, duke pasqyruar zbatimin e shpejtë të projekteve në sektorin privat si edhe zbatimin edhe më të shpejtë në projektet e mëparshme të infrastrukturës. Megjithatë, mjetet e lëvruara neto vazhdojnë të zenë 49% të portofolit të tanishëm. Faktori i lëvrimin të ulët është shkaktuar kryesisht si pasojë e vonesave në zbatimin e dy projekteve të mëdhenj të infrastrukturës publike, të cilët janë nënshkruar në vitin 2004 dhe vitin 2005: *Termocentrali i Vlorës (40 milion euro)* dhe *Projekti i Rrugës Fier-Tepelenë (35 milion euro)*. Procesi i gjatë i zgjedhjeve dhe ndryshimi i Qeverisë në vitin 2005 i theksuan edhe më shumë vonesat në zbatimin e këtyre projekteve.

Tabela 1.1 Portofoli i Bankës në Shqipëri, deri në fund të muajit dhjetor 2005

Emri i sektorit	SHUMA PROGRESIVE E PORTOFOLIT				PORTOFOLI I TANISHËM				
	Nr i projekt eve	Kosto gjithsej	Shuma e nënshkru ar nga BERZH-i	Pesha që ze sektori	Nr i projekt eve	Kosto gjithsej	Pesha që ze sektori	Mjete të lëvruara neto	Raporti i mjeteve të lëvruara neto
Institucionet financiare	6	52.8	24.2	8.3%	5	19.0	8.2%	18.7	98.4%
Bankat	4	35.1	16.1	5.5%	3	12.4	5.3%	12.4	100.0%
Fondet e pjesëmarrjes në kapital ¹	1	7.3	2.8	1.0%	1	0.9	0.4%	0.6	66.7%
Jobankare	1	10.4	5.3	1.8%	1	5.7	2.4%	5.7	100.0%
Infrastrutura	8	660.0	168.5	57.9%	6	155.0	66.5%	43.5	28.1%
Energjia elektrike dhe energjitika	5	475.8	95.5	32.8%	3	82.0	35.2%	19.2	23.4%
Transporti	3	184.2	73.0	25.1%	3	73.0	31.3%	24.3	33.3%
Industritë e specializuara	6	177.4	72.9	25.1%	4	33.7	14.5%	32.2	95.5%
Telekomunikacionet	2	113.4	33.0	11.3%	2	26.0	11.2%	26.0	100.0%
Agrobiznesi	2	18.6	7.4	2.5%	1	4.0	1.7%	2.5	62.5%
Pronat, turizmi & transporti i mallrave	2	45.4	32.5	11.2%	1	3.7	1.6%	3.7	100.0%
Industria e përgjithshme	1	109.9	25.4	8.7%	1	25.4	10.9%	20.3	79.9%

¹ Fondi i Kapitalit për Rindërtim të Shqipërisë është një linjë financimi e regjistruar për investimet që menaxhoet drejtpërdrejt nga Banka, përmes të cilit Banka bën investime me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë ose thuhet drejtpërdrejtë në kapital të vet të ndërmarrjet vendase. Qysh prej vitit 1999, AREF ka bërë njëmbëdhjetë investime, duke e çuar numrin e veprimeve të nënshkruara të Bankës në Shqipëri në 32.

Gjithsej për vendin	21	1,000.1	291.0	100.0%	16	233.1	100.0%	114.7	49.2%

Investimet e Bankës përqendrohen kryesisht në sektorët e energjitikës dhe të transportit, të cilët përfaqësojnë 33% dhe 25%, përkatësisht, të vlerës progresive të portofolit. Të tjerë sektorë të rëndësishëm janë telekomunikacionet dhe pronat, me një përqindje prej 11%, secili. Në përgjithësi, portofoli është i shpërndarë mirë në të gjithë sektorët përsa i takon numrit të projekteve. Megjithatë, përqëndrimi përsa i takon vlerës ka ardhur si rrjedhojë e madhësisë së projekteve në fushën e energjitikës dhe të transportit, të cilët kanë qenë më të mëdhenj në krahasim me ato të sektorëve të tjerë: projektet publike zenë 57% të vëllimit, por vetëm 38% të numrit të projekteve. Borxhi prej 262 milion euro përfaqëson 90% të operacioneve të miratuara nga Banka dhe kapitali i vet prej 29 milion euro përfaqëson 10% (shih Aneksin 5 për listën e plotë të projekteve të Bankës).

Gjatë dy viteve të fundit, Banka ka mobilizuar për projektet e veta 258 milion euro bashkinvestime nga mbështetës financiarë, bashkëfinancues dhe donatorë, çka përfaqëson një koeficient prej 2,1. Vlera gjithsej e fondeve të bashkinvestimeve është 709 milion euro. Me punën e saj me donatorë të ndryshëm, Banka ka mobilizuar fonde për 82 angazhime për bashkëpunim teknik në sektorin financiar, në telekomunikacione, në energjitikë, në transport dhe në industritë prodhuese. Fondet gjithsej të angazhuara për BT kanë arritur shifrën prej 15 milion euro, ndërsa lëvrimi i fondeve për BT deri në fund të vitit 2005 ishte 14 milion euro (shih Aneksin 6).

1.2 Zbatimi i strategjisë së fundit

Strategjia e fundit për Shqipërinë, e miratuar në muajin prill të vitit 2004, parashtronte tri prioritetet strategjike për Bankën në Shqipëri. Në përgjithësi, Banka ia ka dalë mbanë t'i arrijë objektivat e vet në infrastrukturë dhe në sektorët privat të IHD, por ajo është përballur me vështirësi në përfshirjen e vet në sektorin financiar dhe në lidhje me mbështetjen për NVM-të. Gjatë periudhës së shqyrtuar (prill 2004 – dhjetor 2005) Banka ka angazhuar 125 milion për 5 projekte të reja. Në veçanti:

Prioriteti: Nxitja e zhvillimit të sektorit privat përmes ndërmarrjeve të privatizuara dhe të reja, me vëmendje të veçantë të industria e përgjithshme dhe agrobiznesi, si dhe mbështetje për privatizimet e mëdha të ardhshme në fushën e energjitikës dhe të telekomunikacionit.

Rezultatet: Në përputhje me këtë prioritet strategjik, Banka angazhoi 29 milion euro për dy projekte private. Ajo i dha një hua prej 25 milion euro shoqërisë “Seament Albania” për ndërtimin e një uzine të re për prodhimin e çimentos në Shqipërinë e Mesme. Projekti, kur të mbarojë, do t'i japë fund importimit të çimentos dhe do të plotësojë një pjesë të madhe të kërkesës për çimento, në një industri ndërtimi gjithnjë e në rritje. Ky rast ka edhe një efekt të rëndësishëm tek investuesit e huaj që janë të interesuar të hyjnë në Shqipëri. Projekti i dytë është një hua prej 4 milion euro për shoqërinë “Morpack Albania” për ndërtimin e një uzine të re në Shqipërinë e Jugut për prodhimin e tubave të ujitjes dhe të lëndëve të tjera plastike për amballazhim, të cilat synojnë të zëvendësojnë importet me prodhim vendas. Privatizimi në sektorin e energjitikës dhe të telekomunikacionit nuk u realizua gjatë periudhës nën shqyrtim.

Megjithatë, Banka ka hedhur bazat për t'i mbështetur dhe për të marrë pjesë në këto privatizime në të ardhmen.

Prioriteti: Fuqizimi i sektorit financiar, si një faktor kryesor për zhvillimin e NVM-ve dhe mbështetje për privatizimin e shoqërisë së sigurimeve “INSIG”.

Rezultatet: Banka bleu 20% të aksioneve të INSIG-ut, shoqërisë së sigurimeve, e cila më përpara ishte e gjitha me kapital shtetëror dhe ka pasur më parë monopolin e sigurimeve. Gjithashtu, Banka dha edhe fonde të asistencës teknike për ristrukturimin e kësaj shoqërie në mënyrë që ta përgatisë për një privatizim të plotë. Banka ka ndihmuar edhe për kryerjen me sukses të privatizimit të “Banca Italo Albanese” dhe për thithjen e një aktori të rëndësishëm ndërkombëtar, si investues strategjik për këtë bankë. Banka e pati përsëri të vështirë t'i përdorë produktet e veta standarte për të mbështetur huadhënien për NVM-të, kryesisht për shkak të likuiditetit të madh në treg.

Prioriteti: Mbështetje e mëtejshme për përgatitjen e projekteve kyçe në sektorët e energjistikës, të transportit, infrastrukturës bashkiake dhe mjedisore.

Rezultatet: Banka ka dhënë një mbështetje të ndjeshme për zhvillimin e infrastrukturës gjatë periudhës në shqyrtim përmes tri projekteve të ndryshme me një vlerë gjithsej prej 96 milion euro. Ajo nënshkroi një hua të garantuar prej 35 milion euro për Qeverinë e Shqipërisë për rindërtimin e rrugës kombëtare Fier-Tepelene, pjesë e Korridorit Veri-Jug. Projekti i dytë ishte një hua prej 21 milion euro për shoqërinë “Airport Partners Albania”, e cila është një konsorcium, e përbërë nga “Hochtief Airport”, Fondi Shqiptaro-Amerikan dhe DEG për të financuar koncesionin për Aeroportin e Tiranës, njëri prej partneriteteve të para publik-privat në rajon. Projekti i tretë është një hua me garanci shtetërore prej 40 milion euro për Korporatën Energjitike Shqiptare për ndërtimin e një termocentrali të ri. Ky projekt ka si synim të ekuilibrojë prodhimin e energjisë elektrike dhe të përmirësojë furnizimin me energji elektrike.

1.3 Efekti i tranzicionit dhe mësimet e nxjerra prej tij

Me kalimin e viteve, Banka ka mundur ta rrisë praninë e vet në të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë shqiptare, me përjashtim të burimeve natyrore, të IBM dhe të rendimentit të energjisë. Banka ka pasur edhe një efekt të ndjeshëm në tranzicionin e energjistikës dhe të telekomunikacioneve. Nga ana tjetër, efekti i Bankës në agrobiznes, në industrinë e përgjithshme dhe në prona ka qenë *minimal*. Në përgjithësi, efekti i Bankës gjatë gjithë periudhës 1993-2005 vlerësohet si *i moderuar*.

Sektori i shoqërive aksionere private

IHD – Banka ka luajur një rol të rëndësishëm për nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit të sektorit të IHD-ve private. Banka është partner bashkëfinancues në thuajse të gjitha IHD-të e mëdha të vendit. Këto investime kanë pasur një ndikim të ndjeshëm, duke nxitur thithjen e IHD të tjera, për të cilat ka aq shumë nevojë vendi.

Agrobiznesi – Banka ka dhënë ndihmën e vet për investimet e huaja të drejtpërdrejta përmes projekteve të shoqërive “Coca-Cola Tirana” dhe “Morpack Albania”. Efektet

treguese të projektit të parë u zbehën nga problemet e drejtimit të shoqërisë. Banka mësoi se interesat e mbështetësit financiar të huaj më të rëndësishëm mund të mos ishin tërësisht në përputhje me interesat dhe prioritetet e mbështetësve financiar vendas. “Morpak Albania”, që u nënshkrua vjet, ka potencial për një efekt të mirë tranzicioni përmes ndikimit dëshmuar për investuesit e huaj dhe kalimit të njohurive teknike te punonjësit vendas.

Industria – Gjatë pesë viteve të fundit, Banka ka nënshkruar një projekt për financimin e një linje të re të prodhimit të çimentos me një investues të huaj strategjik. Pasi të zbatohet plotësisht, projekti pritet të ketë një efekt të ndjeshëm tregues për investuesit e tjerë të cilët janë të interesuar për investime në industrinë e pëgjithshme në vend. Gjithashtu, përmes Fondit të Kapitalit për Rindërtim të Shqipërisë (“AREF”), Banka ka bërë njëmbëdhjetë investime në ndërmarrje të vogla dhe të mesme në sektorë të ndryshëm (shih IFJB më poshtë).

Prona dhe turizëm – Banka ka ndihmuar në ndërtimin dhe vënien në punë të dy hoteleve të para me standarte ndërkombëtare: Hotel Tirana dhe Hotel Rogner. Hotel Tirana është përbërur me probleme ristrukturimi, pjesërisht prej projektit të dobët dhe pjesërisht për shkak të faktit që është penguar rëndë drejtimi i mirë i ndërmarrjes nga ndërhyrjet e qeverisë në nivelet drejtuese. Duke u nisur nga kjo përvojë, Banka duhet të favorizojë projekte hotelerie me një operator të fuqishëm ndërkombëtar i cili duhet të ketë kontroll të plotë të vendimeve në lidhje me drejtuesit dhe punonjësit.

Sektori financiar

Sektori bankar – Efekti kryesor i Bankës është arritur përmes mbështetjes dhe nxitjes së ngritjes dhe privatizimit të bankave. Pjesëmarrja e Bankës ka qenë kryesore për krijimin e bankës “Banca Italo-Albanese” (“BIA”) në vitin 1994, banka e parë private në Shqipëri. Problemet e drejtimit të brendshëm të BIA-s e penguan zhvillimin dhe efektin e saj në tranzicion. Banka mësoi nga kjo se një investues i fuqishëm strategjik nuk e liron Bankën nga ushtrimi me korrektesë i përgjegjësisë së vet monitoruese. Është i rëndësishëm frekuentimi i vazhdueshëm dhe korrekt në takimet e Bordit, si edhe kërkohet vëmendje e veçantë për monitorimin e praktikave të shëndosha bankare dhe të drejtimit të ndërmarrjes. Pjesëmarrja e Bankës në Bord ka qenë jetike për zgjidhjen e problemeve drejtuese. Angazhimi i Bankës ka qenë shumë i rëndësishëm edhe për kryerjen e privatizimit të BIA-s përmes shitjes së 80% të aksioneve te blerësi “Sanpaolo IMI” nga Italia: një investues i rëndësishëm i cili ka potencialin për t’i dhënë një shtysë të rëndësishme zhvillimit të tregut bankar në Shqipëri.

Gjatë vitit 2000, Banka ka bërë një investim me pjesëmarrje në kapitalin e vet në Bankën Kombëtare Tregtare (“BKT”) për të mbështetur privatizimin e parë të madh në këtë sektor. Pjesëmarrja e Bankës si aksionere ka ndihmuar që BKT të ketë rezultate të mira pune dhe që ajo të shndërrohet në një bankë tregtare me funksionim të mirë dhe në një aktor të rëndësishëm në treg, çka e ka përmirësuar konkurrencën në sektorin bankar.

NMVM – Një sukses i qartë i Bankës në sektorin e NMVM-ve ka qenë pjesëmarrja e saj në kapitalin e vet të bankës FEFAD, emri i së cilës më pas ndryshoi, duke u quajtur “Procredit Bank”, një bankë mikrokredie e cila është pronë e disa IFN-ve. Si sasia ashtu edhe cilësia e nënshkrimeve dhe e diversifikimit të degëve të saj kanë qenë

mbresëlënëse. Megjithatë, “Procredit Bank” vazhdon të përballet me shumë pak konkurrencë në tregun e NMVM-ve. Banka ka ndihmuar edhe për zhvillimin e sektorit përmes gjashtë projekteve të sektorit TAM/BAS.

IFJB – Banka ka bërë një investim (së bashku me KFN) në korrik të vitit 2004 në kapitalin e vet të shoqërisë INSIG, shoqëri shtetërore sigurimesh, në kuadër të një skeme paraprivatizimi. Pjesëmarrja e Bankës ka sjellë ndryshime të rëndësishme në punën dhe organizimin e kësaj shoqërie, duke përfshirë edhe aftësitë drejtuese dhe teknike të saj. Mbetet për t’u kryer privatizimi i plotë.

AREF-i, i ngritur nga Banka, është i pari dhe i vetmi fond investimi në kapital në Shqipëri. Efektet e treguese tregojnë për natyrën novatore të këtij produkti. Ai është përpjekur shumë për të gjetur investime të përshtatshme, por ka mundur të vendosë 32% të kapitalit të akorduar në 11 investime. Megjithë numrin e kufizuar të investimeve, veprimtaritë e këtij fondi kanë qenë shumë të dukshme dhe kanë treguar me sukses mënyrën se si mund zbatohen investimet me risk në një treg të vogël në të cilin ka shumë pak alternativa të daljes nga investimi.

Infrastruktura

Energjia – Banka ka pasur një angazhim të hershëm në këtë sektor dhe është përqendruar te nxitja e shndërrimit të ndërmarrjeve në shoqëri aksionere, licensimet dhe privatizimet e mundshme. Mirëpo, ecuria ka qenë shumë e vogël dhe projektet e Bankës nuk janë lëvruar për shkak të niveleve të ulëta të tarifave dhe të arkëtimeve. Atëherë, angazhimi i Bankës u zhvendos nga puna për rehabilitimin e ngutshëm të rrjetit të reformat e gjerësishme institucionale në mbështetje të reformave të tarifave dhe të ristrukturimit të sektorit. Janë arritur ngritje të ndjeshme të tarifave, së bashku me ulje të fuqishme të humbjeve komerciale dhe përmirësime të përqindjeve të arkëtimit të faturave. Subvencionet u eliminuan gradualisht gjatë kohëzgjatjes së projekteve. Kjo i dha mundësi Bankës që në vitin 2004 të fillojë strukturimin e një projekti të ri me KESH-in për të financuar ndërtimin e një termocentrali të ri me cikël të kombinuar me naftë në Vlorë. Këto projekte kanë ndihmuar në procesin e ndarjes të sektorit të energjisë elektrike.

Telekomunikacionet – Banka ka qenë e rëndësishme për nxitjen e shndërrimit në shoqëri aksionere, licensimin dhe privatizimin e mundshëm të operatorit mbizotërues dhe në fuqizimin e kuadrit rregullator përmes dy projekteve të bashkëpunimit teknik. Gjatë viteve të fundit, Banka ka ndihmuar për futjen me sukses të konkurrencës në pjesën e telefonisë celulare të tregut.

Transporti – Për një dhjetëvjeçar, i vetmi investim i Bankës në këtë sektor ka qenë projekti i rehabilitimit të rrugëve. Në vitin 2005, Banka nënshkroi një projekt tjetër për rrugët dhe një koncesion aeroporti gjatë periudhës nën shqyrtim. Projekti për rrugët përfshin edhe një marrëveshje politikash për financimin e rrugëve. Projekti i privatizimit të Aeroportit të Tiranës mbështet projektin e parë të rëndësishëm me partneritet publik-privat (“PPP”) në rajon, kontrata e të cilit është lidhur pas një konkursi me pjesëmarrjen e një investuesi strategjik të huaj dhe me përvojë. Ky është njëri nga të paktët në llojin e vet në rajon në sektorin e transportit. Banka ka luajtur një rol të rëndësishëm për nxitjen e ndryshimeve të procesit të tenderimit për të pasur një

analizë vlerësuese më transparente dhe për të ndihmuar në prokurimin e ofertave të krahasueshme.

Në përgjithësi, në sektorin publik, Banka ka fituar një përvojë të vyer në lidhje me marrëdhëniet me organet shtetërore dhe me njohjen e kapaciteteve të subjekteve publike për zbatimin dhe shlyerjen e borxhit, çka do të ndihmojë për zbatimin e projekteve të tjera në sektorin publik në të ardhmen.

Projektet e BT – Banka ka investuar burime të konsiderueshme për projekte të BT për t'u dhënë zgjidhje mangësive institucionale, edhe pse asnjëri prej tyre nuk ka qenë pjesë e Programit të Bankës për Asistencë Ligjore për Tranzicionin. Projektet në fushën e telekomunikacionit, të zbatuara gjatë viteve '90, kanë nxjerrë mësim në lidhje me proceset, mësim që janë ende të vlefshme. Së pari, kur zbatohen njëkohësisht disa komponentë të financimit të BT, nga Banka duhet të organizohet një nivel i mjaftueshëm bashkërendimi dhe monitorimi, për të siguruar një përdorim optimal të fondeve. Së dyti, përgatitja e bashkëpunimeve teknike të cilat përfshijnë anketa të mëdha studimore mund të justifikojnë një studim fizibiliteti përpara se të nisë me realizëm puna kryesore. Një qasje planifikimi i BT me kuadër logjik me pjesëmarrje të gjerë mund të ndihmojë duke identifikuar problemet kryesore për zbatimin.

1.4 Raporti dhe cilësia e portofolit

Raporti privat/publik i vlerës progresive të portofolit qëndron në shifrën 43/57 përqind. Strategjia e mëparshme, e miratuar në prill të vitit 2004, pranonte se projektet publike në infrastrukturë janë më të mëdha se projektet në sektorin privat të Shqipërisë. Mirëpo, përse i takon numrit të projekteve raporti privat/publik qëndron në shifrën 62/38 përqind. Shqipëria vazhdon të kërkojë investime të konsiderueshme për rehabilitimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së energjitikës dhe të transportit. Për shkak të diferencës strukturore midis projekteve të infrastrukturës publike dhe projekteve të sektorit privat, përqindja e sektorit privat nuk i ka gjasat për të arritur objektivin e vëllimit prej 60% gjatë periudhës që mbulon kjo strategji. Megjithatë, ky raport do të vazhdojë të anojë nga projektet e sektorit privat, në numër.

2. MJEDISI I PUNËS

2.1 Mjedisi i përgjithshëm i reformave

Shqipëria vazhdon të përmbushë kriteret e përcaktuara në Nenin 1 të Marrëveshjes së Themelimit të Bankës. Ajo është një demokraci pluraliste dhe shumëpartiake. Respektimi i të drejtave të njeriut është i krahasueshëm me atë të demokracive perëndimore.

Shqipëria ka ecur përpara në mënyrë të konsiderueshme në lidhje me reformat e tranzicionit gjatë viteve të fundit, por ende përballet me një mori vështirësish themelore të tranzicionit në të gjitha fushat. Autoritetet lipset t'i trajtojnë menjëherë këto vështirësi, megjithë kapacitetin e kufizuar zbatues, për të ruajtur qëndrueshmërinë makroekonomike dhe shoqërore dhe për të siguruar një rritje të fuqishme dhe të qëndrueshme në kohë në periudhën afatmesme. Sukseset e kohëve të fundit përfshijnë, ndër të tjera, ecjen përpara në lidhje me procesin e privatizimit dhe investimet e ndjeshme në infrastrukturë. Sektori bankar ka përfituar nga kryerja e privatizimit të bankës së fundit me kapital kryesisht shtetëror. Ky sektor po zhvillohet me shpejtësi, megjithëse nga një pikënisje shumë e ulët. Infrastruktura ka qenë në objektivin e investimeve të ndjeshme, duke sjellë përmirësime të prekshme, megjithëse boshllëqet në përmbushjen e infrastrukturës janë ende të mëdha.

Vështirësitë e ndjeshme të reformave, që duhen zgjidhur në periudhën afatshkurtër deri afatmesme, përfshijnë, ndër të tjera, fuqizimin e kapacitetit administrativ të shtetit, uljen e korrupsionit të përhapur, luftën kundër krimit të organizuar në lidhje me trafikun e drogës dhe të qenieve njerëzore, formalizimin e veprimtarive tregtare të mbështetura nga zgjidhja e problemeve të pronësisë së tokës, fuqizimin e sistemit të tatimeve dhe të doganave, përmirësime të infrastrukturës për të krijuar një rrjet transporti të standarteve ndërkombëtare në mbarë vendin dhe për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji dhe shërbime të tjera komunale, luftën kundër varfërisë së përhapur dhe pabarazive rajonale në lidhje me standartet e jetesës dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Ndryshe nga korrupsioni, sidomos në administratën tatimore dhe doganore, niveli i përgjithshëm i krimit ka rënë, nga dikur, kur ka qenë pengesa më e madhe me të cilën përballeshin ndërmarrjet sipas Anketës së Mjedisit të Biznesit dhe Performancës së Ndërmarrjeve në vitin 1999 ("BEEPS"), në pengesën më të vogël me të cilën përballet biznesi sipas anketës BEEPS të vitit 2005. Skemat e 'gjobave' të kriminelëve nuk përmenden nga bizneset si një problem i rëndësishëm dhe nuk ka shenja të pastrimit të madh të parave përmes sektorit të vogël financiar në vend. Megjithatë, niveli i krimit të organizuar mbetet një shqetësim i madh dhe të ardhurat nga krimi i organizuar, të cilat lidhen me trafikun e drogës dhe të qenieve njerëzore, ka mundësi të pastrohen përmes bizneseve në vend, duke përfshirë edhe shoqëri të cilat janë aktive në sektorin e ndërtimit dhe të pasurive të patundshme. Edhe çështjet e mundshme të ndershmërisë janë një problem i konsiderueshëm për bizneset e ligjshme të cilat punojnë në vend, duke përfshirë edhe investuesit e huaj të cilët mendojnë të fillojnë të punojnë në Shqipëri.

Zhvillimi i zgjedhjeve është përmirësuar gjatë viteve të fundit, edhe pse vazhdojnë të ndodhin parregullsi, dhe zgjedhjet parlamentare të muajit korrik 2005 u desh të përsëriteshin në disa zona zgjedhore. OSBE-ja deklaroi se përmbushja e angazhimeve dhe standarteve ndërkombëtare për zgjedhje demokratike nga ana e zgjedhjeve

parlamentare të vitit 2005 ishte e pjesshme. Procesi zgjedhor ishte i hapur ndaj keqpërdorimeve, listat e votuesve ishin me kast të pasakta dhe pati raste të votimit të sugjeruar apo të votimit në familje. Megjithatë, OSBE-ja theksoi edhe disa zhvillime pozitive në procesin zgjedhor, siç ishin numri i madh i partive të ndryshme politike të cilat ishin regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhje, administrimi transparent i procesit dhe mbulimi i lirë i zgjedhjeve nga mjetet e komunikimit. Edhe Komisioni Evropian ka deklaruar se procesi i zgjedhjeve në përgjithësi përputhej me kërkesat e standartave demokratike, përkundër disa incidenteve të vogla. Vlerësimi pozitiv i KE-së për zgjedhjet pati një rëndësi jetike për ecurinë e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian. Shumicën e vendeve në kuvend i fitoi Partia Demokratike, atëherë në opozitë, por kjo shumicë nuk i mjaftonte për të formuar qeverinë e vet. Pas një procesi të gjatë të nxjerrjes së rezultateve, u formua një qeveri koalicioni, kryeministër i së cilës është ish-presidenti i republikës, Sali Berisha. Partia e tij, Partia Demokratike, ka 10 ministra, nga 14 që janë gjithsej. Secili prej katër ministrave të tjerë janë nga secili prej katër pjesëmarrësve më të vegjël në koalicion. Kalimi i pushtetit nga qeveria socialiste, e udhëhequr nga Fatos Nano, te qeveria e koalicionit, e udhëhequr nga Sali Berisha, në fillim të muajit shtator 2005 ishte i qetë dhe relativisht pa probleme. Pas zgjedhjeve, Fatos Nano dha dorëheqjen dhe u zëvendësua si kryetar i Partisë Socialiste nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Edi Rama. Zgjedhjet vendore janë planifikuar të mbahen gjatë vitit 2007.

2.1.1 Mjedisi ligjor

Qysh në fillim të viteve '90, kur Shqipëria filloi tranzicionin drejt ekonomisë së tregut, kuadri ligjor i këtij vendi është zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme. Megjithatë, kjo ecuri është penguar shumë nga paqëndrueshmëria e brendshme politike, nga kolapsi i madh i sektorit financiar në vitin 1997, nga kriza e Kosovës në vitin 1999 dhe nga një korrupsion i përhapur.

Shqipëria është republikë parlamentare, me një kushtetutë e cila njeh ndarjen e pushteteve, pavarësinë e gjyqësorit dhe të drejtat e njeriut. Megjithëse ky kuadër ligjor i jep pavarësi gjyqësorit, mangësi të mëdha në lidhje me trajnimin, burimet dhe nivelin e ulët të pagave të gjykatësve, e kanë kthyer korrupsionin në gjykata në një dukuri të shpeshtë dhe kanë krijuar një mungesë besimi mes bashkësisë së biznesit.

Në “Raportin e ecurisë për Shqipërinë, për vitin 2005” Komisioni Evropian, ndër të tjera, theksonte se ka pasur zhvillime pozitive përsa i takon bashkërendimit të standarteve ligjvënëse të Shqipërisë me ato të BE-së. Megjithatë, një vlerësim i përgjithshëm i ligjeve tregtare të Shqipërisë tregon se i mbetet ende të bëjë hapa të konsiderueshëm për të krijuar një sistem ligjor i cili të trupëzojë standartet ndërkombëtare. Disa prej faktorëve të cilët kanë ndikuar në këtë performancë të dobët janë nevoja e ngutshme për reformë në fushën e legjislacionit për tregjet e letrave me vlerë, mangësi në standartet e legjislacionit për drejtimin e shoqërive aksionere dhe ligjet për konçesionin si edhe një regjim i dobët i kontrollit të zbatimit të ligjeve në fushën e transaksioneve të sigurta. Edhe pse ligji i ri i Shqipërisë për falimentimin krahasohet për mirë me ato të vendeve të tjera me të cilat ka aktivitet BERZH-i, zbatimi i efektshëm i regjimit të paftësisë paguese të këtij ligji mbetet një sfidë. Këta faktorë, të shoqëruar nga një gjëndje e dobët e sistemit gjyqësor dhe nga mungesa e respektimit të shtetit ligjor në vend, kanë shërbyer si faktorë largues apo pengues për investuesit vendas dhe të huaj.

Megjithatë, ka pasur përmirësime në kuadrin ligjor: në vitin 2003 është miratuar një ligj i ri për konkurrencën, i cili fut në vend normat e Bashkimit Evropian, ndërsa në vitin 2004 u ngrit autoriteti i pavarur për konkurrencën. Në vitin 2005 është miratuar një ligj i ri për ndihmën shtetërore, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2006. Janë miratuar edhe disa masa të reja për luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Shqipëria vazhdon të ecë përpara në fushën e përgatitjes së legjislacionit që do ta ndihmojë për tranzicionin drejt ekonomisë së tregut. Mirëpo, problem mbeten zbatimi, mangësitë në shtimin gjyqësor dhe kapaciteti i dobët për kontrollin e zbatimit të ligjit.

2.1.2 Mjedisi

Gjatë vitit 2003, fondet e ndara nga buxheti i shtetit për mjedisin zinin vetëm 0.24% të buxhetit gjithsej (kjo përqindje në Hungari ka qenë 1.8% gjatë vitit 2004). Për më tepër, bashkësia ndërkombëtare, duke përfshirë edhe BERZH-in, BE-në dhe PNUD-in, e ka vënë theksin te kapacitetet e pamjaftueshme institucionale mjedisore. Gjatë vitit 2005, Shqipëria miratoi një plan kombëtar për të transpozuar të gjitha Direktivat Mjedisore të BE-së në legjislacionin e vet për mjedisin. Ligji i gjerësishëm për Mbrojtjen e Mjedisit (2002) dhe një ligj për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2003), për rrjedhojë, do të fuqizohen edhe më shumë. Sfidat e vërtetë do jetë nëse do të arrijë ky hap ta kthejë prapa ecjen negative të Shqipërisë në lidhje me mjedisin. Kërkohej, në mënyrë të ngutshme, planifikim dhe buxhetim për të investuar në infrastrukturën mjedisore prioritare dhe për pastrimin mjedisor si edhe sisteme të gjerësishme të menaxhimit mjedisor për të nxitur industrinë dhe publikun për të përqafuar qëndrime të shëndosha nga ana mjedisore. Harmozimi mjedisor i Shqipërisë me BE-në mund të shërbejë si shtysë sidomos përmes vlerësimit të rregullt të BE-së për ecurinë mjedisore të Shqipërisë (Vlerësimi i Përbashkët i Shqipërisë nga Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara 2004).

Nga këndvështrimi i mjedisit, projektet e BERZH-it do të duhet të marrin në konsideratë si mangësitë e regjimit të tanishëm drejtues mjedisor ashtu edhe problemet aktuale mjedisore. Banka po shqyrton idenë e përgatitjes së mjeteve të kredisë për të financuar një mori projektesh mjedisore të cilat përfshijnë uljen e ndotjes së ujit në Detrat e Egjeut dhe Adriatikut, rendimentin e përdorimit të energjisë nga bizneset dhe familjarët dhe prodhimin e energjisë nga burime të ripërtëritshme. Këto linja kredish do të mbështeten te strukturat dhe suksesi i Mjetit të Kredisë Mjedisore Sllovene të BERZH/Linjës Globale të Financimit të Mjedisit dhe Linjat e Kredisë së Rendimentit të Energjisë për Bullgarinë. Për të ndihmuar për këtë proces, janë zhvilluar një sërë seminaresh pune në pesë vende, ndër të cilat edhe Shqipëria, për të marrë mendimet e këtyre vendeve nga një gamë palësh të interesuara të cilat kanë përfshirë qeverinë, autoritetet vendore, qarqet akademike, institucionet financiare dhe industrinë. Duke u mbështetur te mendimet dhe orientimet e marra gjatë këtij seminari pune, banka do të marrë vendim se cilat çështje janë më aktuale për Shqipërinë (ndotja e ujit, rendimenti i përdorimit të energjisë apo energjia e ripërtëritshme) dhe cilat mund të krijojnë një kërkesë të mjaftueshme në mbështetje të një linje kredie të përqendruar për këto qëllime të caktuara.

2.2 Ecuria në fushën e tranzicionit dhe reagimi i ekonomisë

2.2.1 Kushtet makroekonomike që lidhen me operacionet e Bankës

Gjatë vitit 2005, rritja ekonomike u ngadalësua në 5.5 përqind, pas një rritjeje të PBB-së prej 6.7 përqind në vitin 2004. Ky ngadalësim ka qenë për shkak të krizës energjitike gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2005 (shih Aneksin 3, Tabelën e Treguesve të Përzgjedhur Ekonomik). Performanca ekonomike merr kryesisht shtytje nga ndërtimi, shërbimet e biznesit dhe transporti, dhe ka përfituar prej zgjerimit të vullshëm të kredive reale për ekonominë gjatë viteve të fundit, paçka se kjo rritje ka për pikënisje një bazë shumë të ulët. Ruajtja ose madje edhe ngritja e rritjes së tanishme, e cila në periudhën afatmesme pritet të jetë rreth 5-6 përqind në vit, do të varet nga përmirësimet në klimën e biznesit dhe nga rritja e nivelit të infrastrukturës të cilat, në fund fare, do t'i jepnin mundësi Shqipërisë t'i zgjeronte tregjet e eksporteve dhe të thithte investues të huaj. Faktorët kyç për të ardhmen ekonomike janë qëndrueshmëria politike, mbështetja e vazhduar nga jashtë dhe një përfundim i suksesshëm i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me BE-në.

Përqindja e papunësisë çmohet se është 14.7 përqind e krahut të punës në vitin 2005, por papunësia është e përhapur dhe zakonisht nuk raportohet për shkak të rrjetit të kufizuar të ndihmës sociale. Çmuarja zyrtare e krahut të punës është rreth 1.1 milion persona: 175 mijë punojnë në sektorin publik, 215 mijë punojnë në sektorin privat dhe 550 mijë punojnë në bujqësi. Numri i emigrantëve, të cilët nuk janë të përfshirë në krahun e punës, çmohet të jetë rreth 500-700 mijë persona, kryesisht në vendet fqinje të Greqisë dhe Italisë.

Edhe varfëria është një problem i rëndësishëm, sidomos jashtë kryeqytetit. Një e katërta e popullsisë jeton poshtë kufirit të varfërisë, që është 2 dollarë për person në ditë. Të ardhurat mesatare bruto nga pagat në muaj në sektorin shtetëror janë rreth 260 USD. Paga minimale është vendosur rreth shifrës 100 USD dhe asistenca për papunësinë është mesatarisht rreth 40 USD. Asistenca sociale është rreth 20-30 USD në muaj dhe mbështetja sociale informale nga të afërmit është shumë më e rëndësishme se rrjeti zyrtar i mbështetjes sociale.

Inflacioni vjetor i çmimeve konsumatore ka qenë brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 2 deri 4 përqind, gjatë dy viteve të fundit, dhe pritet të mbahet nën kontroll. Gjatë vitit 2005, inflacioni mesatar arriti shifrën 2.3 përqind. Banka e uli përqindjen e vet kryesore të REPO-s në 5 përqind në muajin mars 2005. Norma e këmbimit valutor u vlerësua me rreth 5 përqind në vlerë nominale kundrejt euros gjatë vitit 2004 dhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2005 u vu re një presion për vlerësim të mëtejshëm, çka ra gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2005. Norma e këmbimit ka lëvizje të ndjeshme sezonale për shkak të fluksit të transfertave private nga jashtë të cilat kulmin e vet e kanë gjatë muajve të verës dhe të dimrit. Transaksionet në monedhë të huaj tani bëhen kryesisht përmes kanaleve zyrtare, në krahasim me të shkuarën, kur tregu informal i parregulluar i valutës së huaj ka qenë i konsiderueshëm.

Deficiti i përgjithshëm qeveritar çmohet se ishte 3.3 përqind e PBB-së gjatë vitit 2005. Së bashku me rritjen e të ardhurave buxhetore gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2005, shpenzimet qeveritare u rritën me vull përpara zgjedhjeve parlamentare të korrikut. Megjithatë, viti 2005 ishte viti i parë gjatë të cilit teprica rrjedhëse e

qeverisë, dmth duke hequr grantet dhe shpenzimet kapitale, ishte pozitive. Borxhi i qeverisë gjithsej ra paksa, në 54.8 përqind në fund të vitit 2005, nga 55.9 përqind që ishte në fund të vitit 2004 dhe pritet të vijojë këtë rënie shkallë-shkallë në periudhën afatmesme. Një pjesë e madhe e borxhit të ri të qeverisë të marrë gjatë viteve të fundit është prej institucioneve ndërkombëtare me kushte të favorshme. Qeveria e re ka zbatuar disa ndryshime të vogla tatimore, të cilat përfshijnë uljen e normës së tatimit mbi biznesin e vogël në 1.5 përqind nga 3 përqind dhe të taksës së regjistrimit të bizneseve të vogla, e cila ndryshon sipas natyrës së aktiviteteve dhe vendndodhjes, me 50 përqind, pas diskutimeve me FMN-në në lidhje me efektin që do të kishin ndryshimet e propozuara në qëndrueshmërinë makroekonomike. Në të ardhmen e afërt mund të zbatohen ndryshime të tjera tatimore, ndër të cilat më të rëndësishme janë ulja e TVSH-së dhe e Tatimit mbi Fitimin me 3 pikë përqindjeje, në 17 dhe 20 përqind, respektivisht. Kjo do të varet nga efekti i pritshëm që do të kenë këto ndryshime në qëndrueshmërinë fiskale.

Deficiti tregtar mbetet mbi 20 përqind të PBB-së, dhe arriti 22.1 përqind të PBB-së gjatë vitit 2005, por kryesisht financohet nga flukset hyrëse të transfertave private nga jashtë, të cilat gjatë vitit 2005 çmohen se kanë qenë 13.4 përqind të PBB-së. Borxhi i jashtëm gjithsej (kryesisht zyrtar dhe afatgjatë) është modest, rreth 20 përqind në fund të vitit 2005. Flukset hyrëse të investimeve të huaja të drejtpërdrejta ("IHD") arritën 288 milion USD gjatë vitit 2005. Rezervat ndërkombëtare u rritën në 1.5 miliardë USD në fund të vitit 2005, duke mbuluar më shumë se 4 muaj importe.

Vështirësitë kryesore makroekonomike janë deficiti i lartë tregtar dhe deficiti i lartë fiskal. Ulja e qëndrueshme e deficitit tregtar dhe atij fiskal do të kërkojë ndryshime të ndjeshme strukturore. Ngushtimi i deficitit tregtar pa një efekt negativ në qëndrueshmërinë makroekonomike do të arrihej vetëm përmes rritjes së kapacitetit të eksporteve. Konsolidimi fiskal, i shoqëruar me një përmbushje më të mirë sociale, po të kemi parasysh financimin e pamjaftueshëm të shërbimeve bazë sociale siç janë kujdesi shëndetsor dhe arsimit si edhe skemën e kufizuar të mbështetjes sociale, do të kërkonte rritje të ndjeshme të rendimentit të administratës publike si edhe zgjerimin e bazës tatimore, duke përfshirë edhe kalimin e aktiviteteve ekonomike të paligjshme në sektorin zyrtar, për t'iu nënshtruar tatimit.

2.2.2 Suksesi dhe sfidat e tranzicionit

Spektori i ndërmarrjeve

Problemet e rënda të reformës së përgjithshme në industri lidhen me kontrollin e dobët të zbatimit të ligjit, korrupsionin dhe përqindjen e madhe të PBB-së që vjen nga ekonomia informale, e cila mendohet se është 30 përqind sipas çmuarjeve të OECD. Kryesisht ndërmarrjet janë biznese familjare, të cilat parapëqejnë të punojnë përmes kanaleve informale. Fluksi hyrës i investimeve të huaja të drejtpërdrejta është i vogël, edhe po të krahasohet me vendet e tjera në EJT. Standartet e drejtimit të shoqërive aksionere dhe të kryerjes së biznesit janë të ulëta. Pronësia e paqartë e tokës në zonat kryesore qytetëse dhe bregdetare vijon të pengojë zhvillimin ekonomik, ku vetëm 18 përqind e pronave të patundshme janë të regjistruara siç duhet.

Ka një sektor privat ndërtimi i cili po rritet me vrull dhe i cili, në një shkallë të madhe, financohet nga transfertat private nga jashtë. Rritja shpërthyesë e ndërtimit tani po i

nënshtrohet një rregullimi më të madh: ndërtesat e ngritura në mënyrë të paligjshme në Tiranën qendrore janë shkatërruar gjatë viteve të fundit dhe kërkesat e urbanistikës janë kontrolluar e zbatuar më shumë se në të shkuarën. Shumë pak është ecur përpara në lidhje me rindërtimin dhe zgjerimin e sektorit të turizmit, duke përfshirë edhe produktet e reja dhe metodat e financimit. Zonat bregdetare vuajnë nga ndotja dhe aktivitetet e ndërtimit të parregulluar. Zhvillimin e sektorit të turizmit e pengon mungesa e infrastrukturës.

Infrastruktura

Një kontratë ndihme për bashkëmenaxhim midis KESH-it dhe ENEL-it, shoqëria kryesore italiane e energjisë, (2000-2004), ka ndihmuar ndjeshëm për përmirësimin e rezultateve të punës të KESH-it. Çmimet e energjisë elektrike janë rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë pesë viteve të fundit dhe rritjet e tarifave duhet të vazhdojnë edhe gjatë viteve të ardhshme, siç është përcaktuar në Planin e Punës të Sektorit të Energjitikës 2005-2007. Është ecur ndjeshëm përpara përpara përpara i takon rritjes së përqindjeve të arkëtimit dhe uljes së humbjeve në transmetim dhe shpërndarje. Përmirësimet në drejtim dhe investimet në sistemin e energjisë e kanë ulur numrin e periudhave pa furnizim të energjisë elektrike, mirëpo një ndërthurje e thatësirës së verës së vitit 2005, e një zjarri në njërin prej hidrocentraleve dhe e mungesës së një planifikimi të mirë të importit të energjisë kanë çuar në disa javë ndërprerje të furnizimit me energji elektrike në mbarë vendin gjatë muajit nëntor 2005. Situata është përmirësuar prej atëherë, me nënshkrimin e kontratave të reja të importimit të energjisë elektrike dhe me rritjen e nivelit të ujit në liqenet e hidrocentraleve. Megjithatë, qëndrueshmëria e rrjetit të furnizimit mbetet poshtë standarteve ndërkombëtare, ndërprerjet e lokalizuara ndodhin më shpesh dhe ndërprerjet në shkallë të madhe të energjisë mund të përsëriten në të ardhmen.

Në qershor të vitit 2005, Qeveria miratoi shitjen e operatorit shtetëror të telefonisë fikse "Albtelecom". Të drejtën për të blerë 76 përqind të kapitalit të kompanisë e fitoi shoqëria "Calik Energy Telecommunication", kundrejt shumës 120 milion euro, ndërsa shtetit i mbeteshin 24 përqind. Si pjesë e procesit të privatizimit, Albtelecomit iu dha licenca e tretë e telefonisë celulare, duke i mundësuar të konkurojë drejtpërdrejt me dy ofruesit ekzistues të këtij shërbimi. Mirëpo, në mes të muajit tetor 2005, parlamenti i ri nuk pranoi ta ratifikojë kontratën e privatizimit dhe vendosi të kontraktojë konsulencë ndërkombëtare për ta shqyrtuar kontratën dhe procedurën e tenderit. Deri në mes të muajit mars 2006, qeveria është ende duke tenderuar kontratën për shqyrtimin e privatizimit të telekomit.

Rrjeti i transportit është i pamjaftueshëm dhe kërkon investime të konsiderueshme të cilat mbështeten në mekanizimin e reformuar të financimit të rrugëve, duke përfshirë edhe ngritjen e nivelit të rrugëve kryesore që lidhin qendrat qytetëse, në mënyrë që ato të jenë në standartet ndërkombëtare. Një shtytje e rëndësishme i është dhënë reformës në sektorin e transportit nga koncesioni privat për të rehabilituar aeroportin ndërkombëtar të Tiranës, e cila është arritur përmes një procesi tenderi ndërkombëtar transparent. Gjithashtu, nga shoqëri private po punohen një sërë terminalesh të porteve.

Sektori financiar

Privatizimi i sektorit bankar ka mbaruar. Kredia për sektorin privat po rritet me rreth 40 përqind në vit, por ende përbënte vetëm rreth 14 përqind të PBB-së në fund të vitit 2005, nga të cilat kredia për ndërmarrjet private përbënte rreth 10 përqind të PBB-së dhe huadhënia për familjarët përbënte rreth 4 përqind të PBB-së. Rreth 90 përqind e kredisë është e garantuar me kolateral dhe rreth 80 përqind e huave jepen në monedhë të huaj. Përqindja e huave të pakthyera është e ulët, rreth 4 përqind e huave gjithsej. Vazhdon të mbizotërojë huadhënia informale, sidomos mes ndërmarrjeve mikro dhe të vogla. Një sfidë e rëndësishme për sektorin financiar mbetet rritja e huadhënies së bankave vendase për sektorin privat, sidomos për SME-të. Një bankë mikro-kredish ka gjashtë vjet që u jep hua ndërmarrjeve mikro dhe të vogla.

Shoqëria shtetërore e sigurimeve INSIG është privatuzar pjesërisht përmes përfshirjes së BERZH-it dhe të KFN-së dhe ligji i ri për sigurimet e ka fuqizuar mjedisin ligjor dhe rregullator. Bursa kryesisht konsiston në këmbimin e valutës së huaj, ndërsa legjislacioni dhe rregullimi ka nevojë për fuqizim të konsiderueshëm në fushat e detyrimit për të bërë publik informacionin dhe të standarteve të kontabilitetit dhe të auditimit. Shqipëria ende nuk ka një klasë menaxherësh kapitali privat me njohuri teknike aktuale për vendin apo investues të cilët të kenë dëshirë të investojnë në fonde kapitali privat të cilat funksionojnë në vend. Po përgatitet një legjislacion i ri për qeradhënien e mjeteve, i cili mund të ndihmojë për zhvillimin e një tregu privat të dhënies së mjeteve me qera.

2.3 Mundësia e marrjes së kapitalit

Një burim kryesor financimi për ekonominë shqiptare janë transfertat private nga jashtë, të cilat çmohen se janë rreth 1.2 miliardë USD në vitin 2005, e barazvlefshme me 13.4 përqind e PBB-së. Shqipëria përfiton edhe nga transfertave zyrtare, të cilat çmohen se janë 130 milion USD ose 1.5 përqind e PBB-së në vitin 2005. Flukset hyrëse të kapitali tregtar janë shumë të kufizuara, në shumën 57 milion USD ose rreth 0.7 përqind të PBB-së. Shqipëria nuk është vlerësuar nga agjensitë kryesore të vlerësimit me pikë, nuk ka emetuar ende një Eurobond, dhe flukset hyrëse të IHD janë të vogla, në shumën 288 milion USD ose përafërsisht 3.3 përqind të PBB-së në vitin 2005. Në vitin 2004 janë arritur flukset rekord hyrëse të IHD, në shumën 343 milion USD, e cila përfshinte edhe të ardhurat nga privatizimi nga shitja e Bankës së Kursimeve.

Shuma progresive e IHD ka arritur 1,745 milion USD në fund të vitit 2005, e barazvlefshme me rreth 545 USD për frymë, çka është rreth një e dyta e mesatares për rajonin dhe më pak se një e pesta e shumës për frymë të IHD në Evropën Qendrore. Privatizimi i ardhshëm i shoqërisë së telefonisë fikse dhe i shoqërive të tjera të shërbimeve komunale mund të ndihmojë në mënyrë të konsiderueshme për rritjen e flukseve hyrëse të IHD në të ardhmen, por këto do të jenë flukse që do të ndodhin vetëm një herë, ndërsa rritja e konsiderueshme e flukseve hyrëse të IHD për investime në ndërmarrje të reja, sidomos në sektorin e turizmit që ka një potencial të madh të paplotësuar, do të varet nga zgjidhja e problemeve të pronësisë së tokës dhe regjistrave përkatës si edhe nga përmirësimet e infrastrukturës.

Tregtia me shumicë, prodhimi i veshjeve dhe i këpucëve, agrobiznesi dhe ndërtimi zënë rreth 40 përqind të shumës së IHD. Disa investues të huaj ka edhe në sektorin e nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve, me kontrata koncesioni afatgjata. Burimi

kryesor i IHD-ve është Italia, me gati një të dytën e IHD-ve në vend, pas së cilës vjen Greqia e cila zë rreth një të tretën e IHD-ve. Pjesa më e madhe e investimeve italiane janë në përgjithësi ndërmarrje të vogla dhe të mesme me një ortak vendas, që punojnë në fushën e prodhimit të tekstileve dhe të këpucëve, në ndërtim, në tregti dhe shërbime dhe në përpunimin e produkteve bujqësore. Investimet greke janë përqendruar në sektorin e telekomunikacioneve, në sektorin bankar dhe në ndërtim.

Programi i tanishëm i FMN-së, i miratuar në janar 2006, përfshin një tavan prej 70 milion euro për kontraktimin ose garantimin e borxhit të jashtëm publik ose të garantuar nga shteti me periudhë maturimi mbi një vit deri në dhjetor 2006. Ky program i ri kërkon të kujdeset që të mos lehtësohen politikat makronomike dhe të vazhdohen reformat strukturore. Borxhi i qeverisë gjithsej mendohet nga FMN-ja se do të bjerë shkallë-shkallë nga 54.8 përqind në fund të vitit 2005 në 52.6 përqind të PBB-së në fund të vitit 2009.

3. ORIENTIMET STRATEGJIKE

3.1 Prioritetet e Bankës për periudhën e mbuluar nga strategjia

Prioritetet e Bankës do të pasqyrojnë analizën e tanishme të sfidave të tranzicionit për Shqipërinë. Ka ende një mori fushash ku asistenca e Bankës do të vazhdojë të ketë rëndësi jetike për të mbështetur punën e Qeverisë drejt nxitjes së reformave, përmirësimit të nivelit të tanishëm të infrastrukturës dhe klimës së investimeve në vend. Megjithatë, Banka do të ketë një përqendrim të qartë të aktiviteteve të veta gjatë periudhës së mbuluar nga strategjia. Megjithë fokusin e fuqishëm te sektorit privat, tani që në proces janë një sërë projektsh të mëdha të infrastrukturës publike, raporti i portofolit ka gjasa të lëvizë në favor të sektorit publik. Megjithatë, siç u përmend edhe në Pjesën 1, më sipër, numri i projekteve në sektorin privat do të mbetet ndjeshëm më i madh se në sektorin publik.

Operacionet e Bankës gjatë periudhës së mbuluar nga strategjia do të përqendrohen në pesë prioritete kryesore të përgjithshme:

- Përgatitja e projekteve të infrastrukturës së transportit, energjitike, bashkiakë dhe mjedisorë;
- Privatizimi dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve të mëdha shtetërore;
- Konsolidim i mëtejshëm dhe ristrukturim i sektorit financiar;
- Mbështetje për IHD dhe ndërmarrjet vendore me vëmendje të posaçme për NVM-të dhe
- Dialog për politikën, sidomos në fushat e rregullimit dhe të fuqizimit të tregjeve për infrastrukturën duke përfshirë edhe fuqizimin institucional.

Dialogu për politikën do të vijojë të jetë një pikë e rëndësishme për të maksimizuar efektin e tranzicionit dhe të gjitha operacionet e BERZH-it në Shqipëri do të vijojnë t'i nënshtrohen Politikës Mjedisore të Bankës dhe Banka do të përdorë sa herë të duhet Planet e Punës të Mjedisit.

Duke pasur parasysh sfidat e konsiderueshme të tranzicionit në Shqipëri, Banka do të ketë nevojë më shumë se kurrë për mbështetjen e donatorëve përsa i takon asistencës teknike, bashkëfinancimit të infrastrukturës përmes granteve dhe burimeve të varura të investimeve. Banka do të punojë krahas BE-së, BEI-t dhe donatorëve të tjerë të rëndësishëm, me theks të veçantë te Italia, në kontekstin e rritjes së dialogut të politikave dhe të financimit të përbashkët.

Më konkretisht, Banka do të përqendrohet në prioritetet e mëposhtme gjatë periudhës së mbuluar nga strategjia e re.

3.2 Sfidat sektoriale dhe objektivat e Bankës

3.2.1 Infrastruktura, energjika dhe projektet bashkiake dhe mjedisore

Qëllimet e tranzicionit

- Përmirësimi i drejtimit dhe i funksionimit të rrjetit të transportit rrugor duke përfshirë fuqizimin institucional, reformën e financimit të sektorit rrugor dhe

përmirësimin e mirëmbajtjes së rrjetit rrugor. Një fushë e rëndësishme përfaqësohet nga komercializimi i sektorit të porteve me struktura PPP aty ku është e mundur.

- Shërbimet e qëndrueshme të energjisë mbeten një problem i madh në Shqipëri. Me më shumë se 90 përqind të kapacitetet prodhues të natyrës hidroenergjitike, Shqipëria ka nevojë të ngutshme për t'u diversifikuar me lloje të tjera prodhimi të energjisë si edhe të investojë në transmetimin e energjisë për të pasur mundësi lidhjeje me alternativa të shumta dhe për të siguruar furnizimin. Edhe shpërndarja, e cila vuan nga humbje të mëdha ka nevojë të përmirësohet.
- Shqipëria duhet të nxisë reformat dhe decentralizimin dhe shpërndarjen në sektorët Mjedisor dhe Bashkiak. Duhet të kryhet përmirësimi, privatizimi dhe/ose komercializimi i ndërmarrjeve të shërbimeve komunale, duke përfshirë edhe nxitjen e përfshirjes së sektorit privat në sektorët e transportit dhe energjistikës.

Prioritetet operative

Transporti

- Banka ka qenë aktive në sektorin rrugor të Shqipërisë duke dhënë financim për rehabilitimin e një segmenti 30 km të korridorit rrugor lindje-perëndim, Korridori i Tetë, i cili mbaroi në muajin qershor 2005. Banka ka dhënë financim edhe për përmirësimin e lidhjes veri-jug nga Fieri (Levani) deri në Tepelenë (rrugë e cila shkon në kufirin me Greqinë). Ky projekt do të lidhet me përmirësimet e financimit të sektorit rrugor dhe me reformën institucionale dhe mund të zgjerohet për të përfshirë edhe segmentin Fier (Levan) – Vlorë, i cili do të ofronte një lidhje të rëndësishme me Portin e Vlorës. Banka do të shqyrtojë edhe mundësinë e projekteve të tjera prioritare rrugore, siç është lidhja rrugore Durrës-Kukës e cila shkon drejt Kosovës në veri të vendit edhe në kontekstin e integritit rajonal të rrjetit të transportit.
- Banka po shqyrton idenë e dhënies së bashkëfinancimit krahas BEI-t për ndërtimin e terminalit të trageteve të pasagjerëve dhe për përmirësimin e objekteve të transportit të mallrave në Portin e Durrësit. Si pjesë e fazës tjetër të zhvillimit të Portit të Durrësit, Banka do të shqyrtojë mundësitë për të zhvilluar terminale të tjera portuale përmes PPP, në varësi të zhvillimit të një kuadri të duhur ligjor dhe të ristrukturimit të Autoritetit të Portit të Durrësit.
- Banka do t'u përgjigjet kërkesave të Qeverisë për të mbështetur projekte të realizueshme transporti të cilat do ta ndihmojnë Shqipërinë për të përmirësuar lidhjet e veta të transportit dhe do të mundësonte zhvillimin e turizmit, sidomos në jug të vendit. Aty ku do të jetë e mundshme, Banka do të shqyrtojë mundësinë e mbështetjes së strukturave PPP për zhvillimin e infrastrukturës së transportit.

Energjika

- Prodhimi i brendshëm i Shqipërisë mbështetet thuajse tërësisht te hidroenergjitika. Rritja e kërkesës, humbjet dhe varësia nga rreshjet do të thotë që oferta e brendshme e Shqipërisë do të vijojë të jetë e çrregullt dhe do të varet në mënyrë të konsiderueshme nga importet. Për t'u dhënë zgjidhje problemeve të mëdha, Banka ka dhënë angazhimin për tri projekte në fushën e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes, dy prej të cilëve po lëvrohen rregullisht.
- Edhe pse zbatimi i projekteve ekzistuese do të vijojë të jetë një prioritet kryesor, Banka do të vazhdojë të nisë projekte për t'u dhënë zgjidhje këtyre problemeve teknike por të cilët mbështesin gjithashtu edhe punën ristrukturuese të sektorit të energjisë elektrike dhe integrimin e tij rajonal. Kështu, Banka do të përqendrohet edhe te mbështetja e integritetit të sistemit elektrik të Shqipërisë në rrjetin elektrik të rajonit dhe me Bashkësinë Energjitike të Evropës Juglindore ("ECSEE"). Në këtë kontekst, Banka po shqyrton mundësinë e financimit të 20 milion USD për rehabilitimin e investimeve në transmetim të cilat synojnë ndërtimin e një interkoneksioni të ri rajonal me IRJ të Maqedonisë, një projekt nga i cili do të përfitonte e gjithë treva e Evropës Juglindore. Studimi i fizibilitetit për këtë projekt të mundshëm po i afrohet përfundimit.
- Për të përmirësuar shpërndarjen, përveç përmirësimeve teknike, Banka është e gatshme të mbështesë privatizimin e këtij nënsektori me një investues strategjik që i plotëson kushtet në çastin e duhur pasi të jenë kryer reformat e kërkuara dhe një tender i hapur dhe transparent ndërkombëtar. Banka do të shqyrtojë mundësinë e investimit me borxh ose me kapital të vet në shoqëritë e shpërndarjes për të mbështetur suksesin e privatizimit.
- Në projektet e tjera të sektorit privat, Banka do të mbështesë koncesione të realizueshme BOO/BOOT për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj të vegjël dhe të mëdhenj në Shqipëri, nëse projekte të tilla i plotësojnë kërkesat e politikave koncesionare të Bankës. Aty ku do të jetë e mundur, Banka do të punojë për të krijuar struktura të realizueshme financimi në fushat e rendimentit të energjisë dhe të energjisë së ripërtëritshme.
- Paralelisht, Banka do të vazhdojë të kërkojë asistencën e duhur teknike për KESH-in për të mbështetur fuqizimin e vazhdueshëm institucional dhe arritjen e qëllimeve të parashtruara më sipër. Programi i Asistencës Bashkëmenaxhuese që ka kërkuar Banka për angazhimet e veta ekzistuese, të realizuara nga ENEL (Itali) pas një tenderi me konkurim ndërkombëtar, ka treguar se programe të tilla asistence mund të kenë sukses. Në të vërtetë, KESH-i ka pasur një ecuri të mirë gjatë tre viteve të fundit në fushat e arkëtimit dhe të humbjeve, mes fushave të tjera jetike të punës.

Infrasktruktura bashkiake dhe mjedisore

- Sektori vuan nga mungesa e investimeve dhe mirëmbajtja e shtyrë në kohë. Më konkretisht, shërbimet bashkiake si furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimet, transporti urban dhe mbetjet e ngurta do të duhet të lidhen me reformën institucionale, ligjore dhe rregullatore për të siguruar që bashkitë të kenë burime të parashikueshme të ardhurash të pavarura kundrejt të cilave ta kenë të mundur

të marrin hua dhe që parimet e nivelit vendor të mbulimit të kostove të respektohen në nivel të shoqërive që kryejnë shërbimet.

- Zhvillimi i një linje projektesh të realizueshëm në sektorin e infrastrukturës mjedisore dhe bashkiake do të jetë një objektiv kryesor i Bankës gjatë periudhës së mbuluar nga kjo Strategji. Banka po shqyrton mundësinë e financimit të një huaje me garanci qeveritare prej 8 milion euro për një projekt të zhvillimit të rrugëve me Bashkinë e Tiranës. Ky do të ishte operacioni i parë në sektorin bashkiak në Shqipëri dhe do të shërbejë si një projekt pilot.
- Shanse të mundshme ekzistojnë në sektorin e trajtimit të ujrave të zeza dhe të furnizimit me ujë të pijshëm, ku në mënyrë tipike është i mundshëm mbulimi i kostove përmes një reforme të përshtatshme të tarifave. Edhe investimet për transportin urban dhe për trajtimin e mbetjeve të ngurta do të shqyrtohen si mundësi, rast pas rasti. Banka do të punojë për të krijuar struktura të realizueshme për decentralizimin dhe kthimin e ndërmarrjeve të shërbimeve komunale në shoqëri aksionere. Në një fazë të mëvonshme, në varësi të cilësisë së shoqërive dhe të natyrës së mbështetjes nga autoritetet bashkiake apo qendrore, Banka mund të shqyrtojë mundësinë e financimit të pushteteve lokale. Banka do të vlerësojë aftësinë kredimarrëse të ndërmarrjeve në pronësi të pushtetit vendor dhe do të përcaktojë, duke u mbështetur te ky vlerësim, realizueshmërinë e projekteve.

3.2.2 Sektori i ndërmarrjeve

Qëllimet e tranzicionit

- Ristrukturimi dhe privatizimi i shoqërive të mëdha shtetërore që kanë mbetur, duke përfshirë edhe Albtelekomin dhe rafinerinë shtetërore “Armo” kanë rëndësi jetike për të rritur konkurrencën dhe rendimentin.
- Shqipëria është njëri prej marrësve më të vegjël të IHD-ve në rajon. Pra, një sfidë kryesore për të mbetet lehtësimi dhe thithja e sa më shumë investimeve të huaja.
- Shqipëria duhet ta përqendrojë vëmendjen te zhvillimi i industrisë së turizmit për të realizuar potencialin e vendit në këtë fushë.
- Megjithë rritjen e vullshme të huadhënies nga bankat në vend, ka ende një hendek midis ofertës dhe kërkesës për financim. Gama e produkteve financiare është e kufizuar vetëm me hua të siguruara me garanci. Pra, mbetet një sfidë e rëndësishme të ofrohen instrumenta financiarë më elastikë në mbështetje të zgjerimit të ndërmarrjeve vendase që po rriten me vull.

Prioritetet operative

- Vëmendja e Bankës do të drejtohet nga mbështetja dhe mundësimi i privatizimeve të mëdha të ardhshme të atyre pak shoqërive shtetërore që kanë mbetur, e të cilat janë të afta të qëndrojnë më vete ekonomikisht, përmes një financimi të mundshëm për operatorin e telefonisë fikse me kabëll,

“Albtelecom”, dhe për rafinerinë shtetërore”Armo”. Duke pasur parasysh privatizimin e afërt të operatorit të telefonisë fikse, Banka po punon për të ofruar asistencë teknike për Entin Rregullator, për të përditësuar dhe përmirësuar kuadrin ligjor për telekomunikacionet.

- Banka do të vijojë të luajë një rol të madh për nxitjen e zhvillimit të sektorit privat dhe të prurjeve të IHD-ve gjatë periudhës që mbulon kjo strategji, përmes financimit të shoqërive ekzistuese, investimeve në shoqëri të reja ose përmes blerjeve të atyre ekzistuese, siç janë një objekt i ri magazinimi i naftës dhe gazit në Vlorë. Banka do të mbështesë projektet në industrinë e shitjeve me pakicë si edhe propozime të tjera të mundshme në industrinë e agrobiznesit dhe të turizmit.
- Banka do të mbështesë ndërmarrjet e leverdishme vendase me një linjë të re financimi të orientuar nga kapitali i vet, Linja e Financimit e BERZH-it dhe Italisë për Ndërmarrjet Vendase të Ballkanit Perëndimor (“Linja e Financimit”), e cila është miratuar nga Bordi më 7 shkurt 2006. Linja e Financimit do të plotësojë produktet ekzistuese të financimit të cilat u ofrohen ndërmarrjeve vendase dhe do të kishte në objektiv ndërmarrjet vendase private, të cilat janë në një pozitë të mirë për t’u rritur në tregjet vendase dhe/ose kanë një potencial eksporti në të gjithë sektorët, nga agrobiznesi te turizmi. Po ashtu, Banka do të kërkojë të përmirësojë drejtimin e shoqërive aksionere dhe të rrisë aftësitë drejtuese të shoqërive vendase përmes asistencës teknike në kuadër të programit TAM/BAS.
- Banka do të vijojë të zhvillojë dialogun për politikat me Qeverinë, duke synuar ofrimin e asistencës teknike për të mbështetur ngritjen institucionale dhe zhvillimin e sektorit privat, përmes zhvillimit të synuar të kuadrit administrativ, ligjor dhe rregullator.

3.2.3 Sektori financiar

Qëllimet e tranzicionit

- Mundësia e financimit, sidomos për NVM-të, mbetet një sfidë madhore e sektorëve financiarë. Edhe pse huadhënia është rritur vullshëm, konkurrenca midis bankave është përqendruar te shoqëritë e mëdha vendase. Përfshirja e financimit të NVM-ve në vëmendje është një sfidë e rëndësishme për sektorin bankar. Brenda këtij kuadri, duke pasur parasysh përvojën e kufizuar në huadhënie, përmirësimi i aftësive të punonjësve vendas të bankave është shumë i rëndësishëm për krijimin e një portofoli të mirë huash.
- Një sfidë e rëndësishme për tregun e sigurimeve mbetet kontrolli i zbatimit të ligjit të ri për sigurimet dhe arritja e pavarësisë së plotë të qenësishme të Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve, për të krijuar kushte të barabarta loje për shoqëritë e sigurimeve. Një sfidë tjetër e rëndësishme është prova e marrë nga qeveria për synimin për ta privatizuar tërësisht INSIG-un me objektivin për t’ia shitur një investuesi të besueshëm sigurimesh dhe për t’u kujdesur që sektori i sigurimeve të funksionojë në një mjedis konkurrence të ndershme, e cila do të jetë kyçi për të tërhequr një investues të tillë strategjik.

- Tani ka 17 banka që kryejnë aktivitet në Shqipëri, dhe shumë syresh kanë nisur strategji shumë aktive të zgjerimit përmes degëve në mbarë vendin. Konsolidimi i ardhshëm i këtij tregu është i rëndësishëm për të racionalizuar dhe për të përmirësuar rendimentin e sektorit bankar dhe bazën e kapitalit të bankave.
- Shqipëria merr një sasi të konsiderueshme transfertash private nga emigrantët. Pjesa më e madhe e këtyre transfertave private hyjnë në Shqipëri përmes kanaleve të tjera dhe jo përmes sistemit bankar. Thithja e këtyre fondeve në sistemin bankar përbën një sfidë të rëndësishme për Shqipërinë, sidomos meqenëse kështu do të siguroheshin fonde të rëndësishme në monedhë të huaj për një sistem i cili ka një mospërputhje të ndjeshme valute midis depozitave dhe portofolit të huave.
- Edhe pse tregjet e kapitaleve janë ende në fazën e foshnjërisë, është e rëndësishme të krijohet një kuadër ligjor dhe rregullator i fuqishëm, për të krijuar bazën për mënyrat strategjike të ofrimit të financimit bizneseve vendase.

Prioritetet operative

- Një objektiv kryesor për Bankën do të jetë ripërtëritja e punës për t'u shërbyer më mirë NVM-ve përmes bankave vendase. Banka do të shikojë mundësinë e dhënies së linjave të financimit kushtuar NVM-ve, duke përdorur njohurinë vendase për identifikimin e projekteve. Një fushë tjetër do të jetë krijimi i linjave të financimit të NVM-ve e gërshetuar me asistencë teknike me bankat vendase për të mbështetur dhe rritur aktivitetin e tyre huadhënës dhe për të përmirësuar aftësitë e punonjësve të bankave vendase.
- Për më tepër, Banka (i) do të punojë për privatizimin e plotë të INSIG-ut përmes një ristrukturimi të suksesshëm në kuadër të një skeme investimi para-privatizimi, me objektivin për të bërë një shitje të plotë ndaj një investuesi strategjik sigurimesh brenda një grafiku kohor të përcaktuar qartë; (ii) do të nxisë dhe do të ofrojë mbështetje për konsolidimin e sektorit bankar përmes bashkimit dhe blerjeve të bankave vendase; (iii) do të mbështesë bankat e reja vendase përmes pjesëmarrjes në kapitalin e vet; (iv) do të shikojë mundësinë e skemave të ndryshme të cilat synojnë të mbështesin huadhënien e mikrondërmarrjeve; dhe (v) do të shohë mundësinë e dhënies së mbështetjes për shoqëritë e lizingut (dhënies së aktiveve me qera) që janë krijuar rishtas.
- Brenda misionit të vet, Banka do të mbështesë nismat që synojnë të kanalizojnë transfertat private përmes sistemit financiar vendas. Po kryhet një studim për këtë temë, i cili ka për objektiv përcaktimin e masave dhe të produkteve të reja të mundshme për të zhvilluar bashkëpunimin me bankat vendase dhe të huaja.
- Ekipi Ligjor për Tranzicionin pranë Bankës do të punojë për t'i dhënë asistencën teknike Komisionit të Letrave me Vlerë të Shqipërisë, me synimin për të përmirësuar kuadrin ligjor për tregjet e kapitaleve dhe për të krijuar legjislacionin për instrumentat e rinj të tregjeve të kapitaleve.

4. BASHKËPUNIMI ME DONATORËT DHE IFN-të E TJERA

Banka do të vazhdojë të ndjekë objektivat operativ të propozuar në bashkëpunim të ngushtë me donatorët e tjerë të cilët janë aktivë në Shqipëri, për të arritur një zbatim të sukseshëm të strategjisë së saj dhe për të optimizuar efektin e tranzicionit.

Banka ka bashkëpunuar aktivisht me donatorë shumëpalësh dhe dypalësh për të arritur një zgjidhje afatgjatë për krizën energjitike në Shqipëri. Banka po bashkëfinancon me Bankën Botërore, BEI-n, Bankën Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (“BJBN”), Sekretariatit Shtetëror Zvicëran për Çështjet Ekonomike (“SECO”) dhe Qeveritë e Austrisë e Spanjës tri projekte të mëdha për rehabilitimin e sistemit energjitik të Shqipërisë. Po kështu, Banka ka lidhur dhe administron një kontratë asistence bashkëmenaxhimi me ENEL (Itali) për të ndihmuar Korporatën Energjitike Shqiptare (“KESH”) përmes financimit në formë granti nga Italia.

Bashkëpunimi vijon në sektorin e transportit, ku Banka bashkëfinancon me BEI-n dhe BE-në rehabilitimin e rrugës Fier-Tepelenë pas mbarimit të segmentit të rrugës Elbasan-Librashd, e bashkëfinancuar me Italinë përmes Bashkëpunimit Italian për Zhvillim dhe Nismës së Evropës Qendrore (“NEQ”). Është duke u përgatitur një projekt tjetër në fushën e infrastrukturës së transportit me bashkëfinancim nga BEI.

Me cilësinë e huadhënësit kryesor, Banka ka bashkërenduar me sukses dhe ka nënshkruar një projekt madhor Partneriteti Publik Privat (“PPP”) për modernizimin e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”. Bashkëfinancimi është dhënë nga “DEG-Deutsche Investitions und Entwicklungsgesellschaft GmbH” (Gjermani) dhe nga banka vendase të nivelit të dytë.

Përveç bashkëfinancimit të projekteve të rehabilitimit fizik, Banka po punon aktivisht me donatorë të tjerë për të bashkërenduar dialogun për politikën për t’i dhënë një shtytje më të fortë dhe më efikente procesit të reformave në sektorët përkatës së infrastrukturës. Edhe pse bashkërendimi në sektorin publik po ecën mirë, duhet punuar më shumë për të nxitur zbatimin e projekteve dhe për të përmirësuar kapacitetet zbatuese, duke pasur parasysh dobësitë e përgjithshme të institucioneve vendase dhe përvojat e shkuara me projektet publike.

Banka merr gjithashtu pjesë aktive në dialogun për politikën në përgjithësi në Shqipëri. Objektivat afatgjatë të politikave të Qeverisë Shqiptare jepen në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social (“SKZHES”), të shprehur në Dokumentin e Strategjive të Uljes së Varfërisë (“DSUV”), ndërsa objektivat afatmesëm operativ paraqiten si përmbledhje në Programet Buxhetore Afatmesme (“PBA”), të cilat mbulojnë periudha trevjeçare dhe përditësohen çdo vit. PBA-ja publikohet nga Ministria e Financave, pas konsultave me IFN-të, me donatorët e interesuar dhe me organizatat ndërkombëtare, për të siguruar që caktohen burime të mjaftueshme për sipërmarrjet e propozuara. Në të jepet një listë e projekteve dhe reformave prioritare, së bashku me partnerët që mbështesin zbatimin e tyre. Për të krijuar një strategji të vetme të menaxhimit të asistencës me një pikë të vetme kontakti për të gjithë donatorët, Këshilli i Ministrave ka promovuar Sistemin e Planifikimit të Integruar (“SPI”). Ky sistem synon të bashkërendojë burimet kombëtare dhe ato të ndihmës rreth një strategjie të integruar, të prioritizuar dhe të buxhetuar, e cila e përqendron vëmendjen fuqimisht te programi i integritit evropian dhe është në

përputhje me mundësitë ekonomike afatmesme. Një synim tjetër i tij është për të mbuluar të gjithë ciklin e menaxhimit të ndihmës, nga strategjia deri te planifikimi, zbatimi dhe monitorimi, te analiza vlerësuese, duke integruar kështu një mori funksionesh të cilët tani janë të shpërndarë nëpër ministri të ndryshme. SPI-ja synon t'i japë mundësi qeverisë për t'i prioritetizuar shpenzimet buxhetore për të ecur përpara me integrimin evropian, zhvillimin ekonomik dhe social dhe qëllimet e tjera politike, por, për të qenë e efektshme, kjo do të kërkojë një angazhim të konsiderueshëm politik.

PBA-ja pasqyron qëllimet afatgjata të DSUV-së dhe bashkërendohet me dokumentat strategjik të publikuar nga IFN-të, ku përfshihet Strategjia e Ndihmës për Shqipërinë nga Banka Botërore/SHNZH, Programet Vjetore të BE-së, Partneriteti Evropian dhe Programet Indikative Shumëvjeçare të BE-së, të cilët mbështeten te Strategjia për Vendin e BERZH-it. BERZH- merr pjesë edhe në takimet e rregullta bashkërenduese sektoriale me përfaqësues të qeverisë, BE-në, Bankën Botërore dhe donatorë dypalësh. Debati për buxhetin dhe konsultat e rregullta të kryesuara nga FMN-ja formojnë një tjetër platformë dialogu me qeverinë dhe me IFN-të e tjera për të vendosur prioritetet e investimeve, për të bashkërenduar veprimtaritë e donatorëve dhe për t'u konsultuar për projektet e propozuara të investimeve me garanci shtetërore. Tryeza e Rrumbullakët e Donatorëve shërben si platformë për të shkëmbyer informacion për burimet e disponueshme të donatorëve dhe për planet e tyre të veprimtarive. Së fundmi, dialogu i nivelit të lartë politik bëhet edhe në kuadër të nismave të ndryshme të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore.

Në përputhje me prioritetet e Bankës për dy vitet e ardhshme, do të ndiqen objektivat e mëposhtëm për bashkëpunimin me donatorët shumëpalësh dhe dypalësh:

- Do të ruhet një bashkëpunim i ngushtë me Bankën Botërore, BE-në, BEI-n dhe institucionet e tjera për të vijuar dialogun për politikat me qeverinë për çështje të cilat kanë lidhje me përmirësimin e klimës së investimeve. Banka do të punojë edhe me bashkësinë e biznesit për të identifikuar pengesat ekzistuese për sektorin privat, sidomos për zhvillimin e NVM-ve dhe për të marrë mendime të drejtpërdrejta për politikat dhe masat e qeverisë.
- Do të bashkërendohet puna me Bankën Botërore dhe me BE-në, si edhe me agjensi të tjera të përfshira aktivisht në dialogun për politikat me autoritetet shqiptare, për projekte të cilat përfshijnë investues privat për zhvillimin dhe vënien në punë të fushave kyçe të infrastrukturës dhe asistencën për reformat sektoriale.
- Do të vijojë bashkëpunimi me KFN-në, ku të jetë e nevojshme në sektorin financiar.
- Do të vijojë bashkëpunimi me Bankën Botërore dhe me donatorët dypalësh për ristrukturimin dhe rehabilitimin e sektorit të energjitikës.

- Do të vijojë bashkëpunimi i ngushtë me BE-në, BEI-n, Bankën Botërore dhe donatorë të tjerë të mundshëm në sektorin e infrastrukturës së transportit (rrugore dhe portuale).


ANEKSI 1 – Vlerësim i Ligjeve Shqiptare për Shoqëritë Tregtare

BERZH-i ka përgatitur dhe përditëson rregullisht një sërë vlerësimesh të shndërrimit ligjor të vendeve ku ushtron aktivitet, duke e drejtuar vëmendjen të fushat e përzgjedhura të cilat lidhen me veprimtaritë e investimeve, tregjet e kapitaleve, ligji për shoqëritë tregtare dhe drejtimi i shoqërive aksionere, koncesionet, paaftësia paguese, transaksionet e sigurta dhe telekomunikacionet. Instrumentat ekzistues bëjnë një vlerësim si të cilësisë së ligjeve në letër (që ndryshe quhet edhe “shkalla e mbulimit”) ashtu edhe zbatimin në praktikë të këtyre ligjeve (që ndryshe quhet “shkalla e efektshmërisë”). Të gjitha rezultatet e këtyre vlerësimeve mund të shihen në adresën: www.ebrd.com/law. Në këtë aneks paraqitet një përmbledhje e rezultateve për Shqipërinë, të shoqëruara me mendime kritike të ekspertëve ligjor të Bankës, të cilët kanë kryer këto vlerësime.

Tregjet e kapitaleve

Legjislacioni kryesor që mbulon tregun e letrave me vlerë është Ligji për Letrat me Vlerë i vitit 1996, me ndryshimet dhe shtesat e muajit shkurt 2001 (“Ligji për Letrat me Vlerë”). Enti rregullator i letrave me vlerë është Komisioni i Letrave me Vlerë (“KLV”), i cili është ngritur sipas Ligjit për Letrat me Vlerë. KLV-ja ka shtatë komisionerë, të emëruar nga Parlamenti, me një mandat pesëvjeçar. Bursa e Tiranës është krijuar në vitin 1996. Pas krijimit, Bursa ka pasur një aktivitet shumë të kufizuar tregtimi (kryesisht bono thesari dhe bono privatizimi) dhe duket se tani nuk është aktive. Për rrjedhojë, sistemi financiar shqiptar aktualisht është i përqendruar te bankat, ndërsa tregu i kapitalit të vet është tej i pazhvilluar.²

Cilësia e legjislacionit për tregjet e letrave me vlerë: Shqipëria (2004)



Shënim: Ekstremiteti i secilit aks përfaqëson pikët ideale, dmth u korespondon standarteve të paraqitura në materialin “Objektivat dhe parimet për rregullimin e letrave me vlerë” të IOSCO. Sa më e madhe të jetë “rrjeta” aq më shumë u afrohet legjislacioni për letrat me vlerë këtyre parimeve.

Burimi: Vlerësim i Legjislacionit për Tregjet e Letrave me Vlerë (BERZH) 2004

Rezultatet e vlerësimit të BERZH-it të vitit 2004 për legjislacionet e tregjeve të letrave me vlerë e renditën Shqipërinë të fundit në Evropën Juglindore. Legjislacioni shqiptar u vlerësua si “me përputhshmëri të ulët” kur u krahasua me parimet e IOSCO-s, duke treguar kështu nevojën e ngutshme për reformë. Vlerësimi u përditësua në vitin 2005 dhe rezultatet e konfirmuan edhe një herë vlerësimin “me përputhshmëri të ulët”.

Në veçanti, ligji nuk ka dispozita të mjaftueshme për organizatat vetërregullatore dhe rregullimi i ndërmjetësve të tregut dhe tregut dytësor u pa se ishte i dobët në shumë aspekte. Kleringu dhe shlyerja e letrave me vlerë nuk jepet me shumë hollësi në ligj dhe mungesa e dispozitave zbatuese

² Gjatë vitit 2002, mjetet e bankave përbënin 98.1 % të mjeteve të të gjithë ndërmjetësve financiarë – shifra më e lartë në gjithë Evropën Juglindore (EJL) – ndërsa kapitalizimi i tregut të aksioneve është më i ulët në EJL (Studim pune i FMN-së “Kush zgjohet herët, kush zgjohet vonë dhe bukuroshet e fjetura: rritja e kredisë bankare për sektorin privat në Evropën Juglindore dhe në Ballkan” – 2003)


(nënligjore) e bën edhe më të paplotë kuadrin. Kur shqyrtoi kontabilitetin dhe auditimin, përsëri vlerësimi zbuloi një kuadër që ishte në nevojë të ngutshme për t'u reformuar. Në lidhje me këtë, ligji i ri që përcakton standartet e auditimit do të hyjë në fuqi në vitin 2006, çka do ta përmirësojë kuadrin.

Së fundmi, rregullimi i instrumentave financiarë është i kufizuar dhe nuk ka asnjë përkufizim të ofruesit të shërbimit të investimeve.

Ligji për shoqëritë tregtare dhe drejtimi i shoqërive aksionere

Ligji për Shoqëritë Tregtare ka hyrë në fuqi në vitin 1992 dhe ndryshimet më të fundit në të janë bërë në vitin 1996. Sipas këtij ligji, një shoqëri tregtare mund të krijohet si ortakëri e përgjithshme, si ortakëri e kufizuar, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, si shoqëri aksionere ose si ortakëri e kufizuar me aksione.

Cilësia e legjislacionit për drejtimin e shoqërive tregtare: Shqipëria (2004)



Shënim: Ekstremitati i secilit aks përfaqëson pikët ideale, dmth u korespondojnë Parimeve të Drejtimit të Shoqërive tregtare të OECD. Sa më e madhe të jetë “rrjeta” aq më shumë u afrohen këtyre parimeve ligjet për drejtimin e shoqërive tregtare

Burimi: Vlerësim i Sektorit të Drejtimit të Shoqërive Tregtare, BERZH, 2004

Sipas rezultateve të vitit 2004 të projektit të Vlerësimit të BERZH-it për Drejtimin e Shoqërive Tregtare, në kuadër të të cilit u vlerësuan “ligjet në letër” që lidhen me drejtimin e shoqërive tregtare, Shqipëria u vlerësua si një vend me “përputhshmëri të mesme”, krahasuar me Parimet e OECD për drejtimin e shoqërive tregtare. Siç tregohet edhe në tabelën e mësipërme, dobësi u gjetën në lidhje me “deklarimin e informacionit dhe transparencën”, “përgjegjësinë e bordit” dhe “të drejtat e aksionerëve”.

Mes gjërave të tjera, vlerësimi tregoi se të dhënat financiare dhe operative nuk përgatiten dhe nuk deklarohen në përputhje me standartet e kontabilitetit që njihen botërisht, se ligji nuk ofron një test për të siguruar pavarësinë e audituesit dhe hesht në lidhje me funksionet dhe përgjegjësitë e bordit për të siguruar integritetin e sistemeve kontabile dhe të raportimit financiar të shoqërisë dhe për të siguruar një auditim të pavarur. Së fundmi, ligji nuk i kërkon bordit të ketë komitete të veçanta që të merren me raportimin financiar, shpërblimin e drejtuesve dhe të bordit dhe propozimet e kandidaturave të bordit apo për të përfshirë një numër të mjaftueshëm drejtorësh jo ekzekutivë dhe të pavarur.

Gjatë vitit 2005, BERZH-i nisi një anketë për të testuar efektshmërinë e drejtimit të shoqërive aksionere (dmth si funksionojnë ligjet në praktikë). U hartua një rast studimor në lidhje me transaksionet me palët e lidhura. Rasti studimor hetonte statusin e një aksioneri me një pakicë aksionesh i cili kërkonte të merrte informacion për shoqërinë aksionere për të kuptuar nëse kishte kryer shoqëria transaksione me palë të lidhura dhe sa ishte i mundshëm dëmshpërblimi në rast se ishte shkaktuar ndonjë dëm. U mat efektshmëria e legjislacionit sipas katër ndryshoreve të parimeve: kompleksiteti, shpejtësia, mundësia e kontrollit të zbatimit të ligjit dhe mjedisi institucional. Kjo anketë zbuloi disa mangësi në Shqipëri. Procedurat për të marrë informacion dhe dëmshpërblim janë

të ndërlikuara, sidomos nëse shoqëria dhe/ose aksioneri kryesues nuk pranon të bashkëpunojë me vullnet të lirë me aksionerin me pakicën e aksioneve. Mungesa e jurisprudencës, që do të ofronte orientim për interpretimin e ligjit, influencon negativisht në qartësinë e procedurave. Koha që nevojitet për të marrë një gjykim të përmbarueshëm mund të jetë diku afër 18 muajve, por pala e paditur e ka të lehtë ta vonojë procesin. Po t'i kthehemi mjedisit institucional, anketa zbuloi se informacioni i shoqërive në përgjithësi nuk është i besueshëm, ndërsa audituesit ligjor zakonisht nuk mund të punojnë në mënyrë të pavarur, çka e ul mundësinë e marrjes së informacionit të saktë. Kur vjen puna te dëshmipërblimi, rasti studimor tregoi se ka një mungesë përvoje dhe aftësie të gjykatave në lidhje me çështjet gjyqësore të shoqërive aksionere dhe nxorri në pah mundësinë e anshmërisë së tyre, sidomos në rastin e çështjeve ku i paditur është një palë e fuqishme. Së fundmi, efektshmëria e legjislacionit për drejtimin e shoqërive aksionere në vend në përgjithësi është e ulët.

Koncesionet

Koncesionet dhe partneritetet publike private rregullohen nga ligji i vitit 1995 për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet dhe infrastrukturën publike, me ndryshimet dhe shtesat e mëvonshme ("Ligji për koncesionet"). Sipas Ligjit për Koncesionet, koncesionarë mund të jetë një shoqëri tregtare ose një person, vendas ose i huaj, si edhe një grupim i tyre. Përveç Ligjit për Koncesionet, çështjet e koncesioneve rregullohen edhe me akte të tjera ligjore ose nënligjore sektoriale.

Ligji për Koncesionet përcakton qartë objektin e zbatimit edhe është nga të paktët në llojin e vet në rajon që rregullon konkretisht mbështetjen e qeverisë për koncesionet dhe parashikon garancitë që duhet të japë koncesionari (psh vënie në hipotekë të pronave të shoqërisë koncesionare), megjithëse, në thelb, rregullore të tilla kanë nevojë për përmirësime. Gjithashtu, Ligji për Koncesionet përcakton qartë që ka për synim të sigurojë pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet dhe infrastrukturën publike. Ligji për Koncesionet parashikon një listë ezauruese të sektorëve të cilët mund të zhvillohen me koncesion.


Ligjit për Koncesionet i mungon gjerësishmëria, sidomos kur bëhet fjalë për procedurat. Më konkretisht, në të nuk jepen rregulla të hollësishme në lidhje me tenderimin apo marrëveshjet e koncesionit. Rregullat për procesin e përzgjedhjes tani janë disi të paqarta dhe të paplota, nuk ka kërkesa ligjore për parapërzgjedhjen apo parakualifikimin e pjesëmarrësve në tender, publikimin e kritereve, për analizën vlerësuese të propozimeve apo për publikimin e njoftimit të fituesit të kontratës së koncesionit. Për më tepër, nuk thuhet asgjë për publikimin/regjistrimin e kontratës së koncesionit, bazat për negociatat e drejtpërdrejta dhe rregullimi i propozimeve të pakërkuara janë të paqarta dhe nuk përmenden procedurat e mundshme të shqyrtimit. Duhet të përmirësohen dispozitat për kontratën e projektit dhe për të drejtat e huadhënësve (dispozitat për zgjidhjen e kontratës dhe dëshmipërblimin, mundësia për të drejtat e "ndërrhyrjes").

Në përgjithësi Ligji për Koncesionet ua lë palëve të përcaktojnë kushtet e kontratës së koncesionit. Ligji për Koncesionet nuk parashikon, konkretisht, ndonjë dëshmipërblim në rast të zgjidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktues dhe nuk përmban një klauzolë qëndrueshmërie në rast të përkeqësimit të ligjeve pasi të ketë hyrë në fuqi kontrata e koncesionit. Ligji për Koncesionet parashikon zgjedhjen e arbitrazhit ose të sistemit shqiptar të gjykatave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (megjithëse nuk është e qartë nëse është i mundshëm arbitrazhi ndërkombëtar).

Vlerësimi që ka bërë kohët e fundit BERZH-i për ligjet për koncesionet, për të bërë një analizë vlerësuese të regjimeve të zbatueshme në të 27 vendet ku ushtron aktivitet (ligjet në letër, dhe jo zbatimi i tyre në praktikë) ka treguar se ligjet shqiptare kanë "përputhshmëri të ulët" me standartet e pranuar botërisht në këtë sektor. Siç mund të shihet nga grafiku në formë rrjete më poshtë, edhe pse rregullat për përkufizimet dhe objektin e ligjit si edhe ato për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me kontratat e koncesioneve rregullohen gjerësisht, shumica e fushave të tjera, sidomos, përzgjedhja e koncesionarit, rregullimi i kontratës së projektit dhe mundësia e pasjes së instrumentave financiarë dhe të mbështetjes shtetërore mund të përmirësohen në mënyrë drastike për të përmbytur kërkesat

ligjore të një kuadri që mundëson pjesëmarrjen e sektorit privat. Një dimension tjetër i cili patjetër do të kërkojë vëmendjen e autoriteteve është një kuadër politikash, mungesa e të cilit e bën tejet të vështirë zbatimin e çdo ligji.

Cilësia e legjislacionit për koncesionet: Shqipëria (2005)



Shënim: Ekstremitetet e secilit aks përfaqësojnë pikët ideale në përputhje me standartet ndërkombëtare siç është Guida Legjislative e UNCITRAL për projektet e infrastrukturës me financim privat. Sa më e madhe “rrjeta”, aq më shumë u afrohen këtyre standarteve ligjet e vendit për koncesionin.


Burimi: Vlerësim i Sektorit të Koncesioneve nga BERZH-i 2005

Megjithë mangësitë e shumta, qysh prej hyrjes në fuqi, janë dhënë një numër i konsiderueshëm koncesionesh në kuadër të Ligjit për Koncesionet, sidomos në nivel vendor, duke përfshirë edhe koncesionarë të huaj. Megjithatë, praktika e dhënies së koncesioneve ka qenë objekt i kritikave në vend dhe zbatimi gjatë tre viteve të fundit është parë si i debatueshëm. Mbase, kjo lidhet me ish qeverinë, megjithëse analiza e mësipërme të le përshtypjen se si politika ashtu edhe kuadri ligjor për PPP-të kërkojnë ndryshime të ndjeshme.

Paaftësia paguese

Falimentimi dhe paaftësia paguese në Shqipëri mbulohen kryesisht nga Ligji për Procedurat e Paftësisë Paguese në Republikën e Shqipërisë (me ndryshimet e fundit të vitit 2002) (“Ligji për Paftësinë Paguese”), njëri prej ligjeve kryesuese për paftësinë paguese, në vendet ku ushtron aktivitet BERZH-i. Në Studimin Vlerësues Sektorial të BERZH-it, 2003-04, i cili mat përputhshmërinë e legjislacionit për paftësinë paguese me standartet ndërkombëtare në 97 fusha të ndryshme, Ligji për Paftësinë Paguese ishte njëri prej 6 ligjeve të vetme në 27 vendet ku ushtron aktivitet Banka, i cili mori vlerësimin “përbushje e lartë” e standarteve. Grafiku më poshtë tregon nivelin e përputhshmërisë së Ligjit për Paftësinë Paguese në pesë fusha me rëndësi jetike për legjislacionin për paftësinë paguese.

Përputhshmëria e Ligjit Shqiptar për Paftësinë Paguese me standartet ndërkombëtare Cilësia e legjislacionit për paftësinë paguese: Shqipëria (2004)



Shënim: Ekstremiteti i secilit aks përfaqëson një rezultat ideal, dmth u korespondon standarteve ndërkombëtare siç janë Parimet dhe Orientimet e Bankës Botërore për Sisteme të Efektshme të Paaftësisë Pagueuse dhe të Drejtave të Kreditorëve, Grupi i Punës i UNCITRAL-it për “Udhëzuesit Legjislativ për Ligjin për Paaftësinë Pagueuse”, dhe të tjera. Sa më e madhe të jetë rrjeta, aq më shumë u afrohen këtyre standarteve ligjet për paaftësinë paguese.

Burimi: Projekti i BERZH-it për Vlerësimin Sektorial të Paaftësisë Pagueuse, 2003/4

Ligji për Paaftësinë Pagueuse është njëri prej të paktëve në vendet ku ushtron aktivitet BERZH-i i cili jep dispozita të qarta dhe i cili përputhet në përgjithësi me standartet ndërkombëtare, që trajton fillimin e procedurave, seancën dëgjimore dhe marrjen e vendimit për nisjen a zbatimeve, përfshirjen e kreditorëve dhe shmangjen e transaksioneve në periudhën para falimentimit.

Mirëpo, ky vlerësim i lartë nuk synon të sugjerojë që ligji është i përsosur por që ai i përmbush në mënyrë të konsiderueshme një mori elementesh të rëndësishëm të standarteve ndërkombëtare në fushën e paaftësisë paguese. Edhe sikur ligji të merrte vlerësimin “përputhshmëri e plotë”, përsëri do të kishte nevojë për përmirësime. Po kështu, Ligji për Paaftësinë Pagueuse mund të përmirësohet ndjeshëm në një sërë mënyrash. Mes të tjerash, ligji mund të jetë më i qartë në lidhje me atë se çfarë ndodh me të drejtat e kontrollit të zbatimit të ligjit të kreditorëve me garanci (me kontratë) kur kanë filluar procedurat e paaftësisë paguese. Ligji është i paqartë edhe se si do të menaxhohet një shoqëri debitore gjatë paaftësisë paguese. Dy llojet e menaxhimit që përdoren më shumë janë ose menaxhimi i debitorit në zotërim, ose menaxhimi përmes një administratori falimentimi. Të dy këto lloje përputhen me standartet ndërkombëtare, por është shumë e rëndësishme të vendosen detyrime shumë më të qarta për nëpunësit dhe drejtorët e shoqërive falimentuese për të dhënë informacion për shoqërinë (libra, të dhëna, etj.) për gjykatën ose funksionarin përkatës.

Vlerësimi i gjendjes së legjislacionit për paaftësinë paguese në Shqipëri jep vetëm një pjesë të situatës. Është e nevojshme të shikohet edhe funksionimi në praktikë i regjimit të paaftësisë paguese (“shtrirja e efektshmërisë” së këtij regjimi).

Studimi Tregues Ligjor për Paaftësinë Pagueuse kryer në vitin 2004 nga BERZH-i, në të cilin shikohej efektshmëria e regjimeve të paaftësisë paguese si në falimentimet e nisura nga kreditorët ashtu edhe në ato të nisura nga debitorët, zbuloi se për kreditorët dhe debitorët që kërkojnë të nisin procedura falimentimi në Shqipëri, është relativisht e lehtë të vendosin se në cilën gjykatë t’i nisin këto procedura. Mirëpo për të dyja palët procesi është tepër i shtrenjtë dhe, për kreditorët, është tejet i ngadaltë. Ky studim zbuloi edhe se gjykatësit nuk e zbatojnë të gjithë njësoj ligjin dhe se shteti ligjor nuk zbatohet shpesh me efektshmëri.

Në përgjithësi, Shqipëria vuan nga një “hendek i madh zbatimi” (diferenca midis cilësisë së legjislacionit dhe efektshmërisë së regjimit të paaftësisë paguese në praktikë). Ky hendek sugjeron se sistemi ligjor i Shqipërisë nuk mund të zbatohet në mënyrë të efektshme një ligj kaq të mirë dhe thekson nevojën për të kryer punë të mëtejshme për reformën për të fuqizuar gjykatat dhe institucionet e tjera të cilat zbatojnë legjislacionin e paaftësisë paguese.

Transaksionet e sigurta


Siguria e mjeteve të lëvizshme në Shqipëri mbulohet nga ligji i vitit 1999 mbi Barrët Sigurose, i cili u zbatua tërësisht në vitin 2001. Siguria apo garancia për mjetet e patundshme (hipoteka) mbulohet nga Kodi Civil (nenet 560-607). Taksat mbi pronat e patundshme duhet të regjistrohen në regjistrin vendor të pasurive të patundshme.

Ligji për Barrët Sigurose zbatohet për “të gjitha transaksionet, pavarësisht formës apo klasifikimit të tyre, të cilat krijojnë një barrë sigurose, ose përmes kalimit të pronësisë, pasjes në zotërim si në rastin e një pengu, ose në forma të tjera”, në lidhje me sende të tundshme, pasuri të patrupëzuara ose të drejta, si edhe "mallrat me numër serie" siç janë makineritë bujqësore, mjetet lëvizëse ajrore, motorët e mjeteve lëvizëse ajrore, automobilët, barkat, makineritë e ndërtimit, motoçikletat, mjetet lëvizëse të motorizuara, maunet tokësore dhe mjetet lëvizëse me shina. Regjistri Qendror i Barrëve Sigurose filloi të vihej në funksionim në shkurt të vitit 2001. Në përgjithësi ligji është i qartë, i gjerësishëm dhe parashikon elasticitetin e duhur për transaksionet relativisht të sofistikuara. Përdoruesit e tij thonë se nuk kanë pasur probleme me regjistrimin e një barre sigurose në Regjistrin Qendror. Një mangësi e ligjit lidhet me prioritetin e kreditorëve të siguruar meqënëse mund të mos kuptohet se kuji i takon prioriteti. Megjithatë, pika më e dobët e këtij regjimi ka lidhje me kontrollin zbatues.

Dispozitat ligjore synojnë të ofrojnë një sistem të shpejtë dhe eficient. Sipas këtyre dispozitave, në rast se debitori nuk i kryen detyrimet e veta, titullari i barrës sigurose ka të drejtën automatike për të kërkuar dhe marrë një urdhër gjykate, i cili i jep kompetencë përmbaruesit të marrë mjetet e vëna si barrë. Pastaj mund të ndodhë çlirimi i barrës sigurose ose përmes shitjes private ose përmes shitjes publike, e shitur si një e tërë ose të shitura si njësi ose pjesë komerciale. Mirëpo, siç ka treguar edhe studimi i kryer gjatë vitit 2003 nën udhëheqjen e BERZH-it, përmbaruesit nuk janë aq të besueshëm dhe eficientë sa duhet. Edhe gjykatat thuhet se janë të ngadalëta dhe pa shumë përvojë në rastet e përmbarimit, me një risk të lartë korrupsioni.

Megjithatë, kjo mund të ndryshojë meqënëse Banka Botërore po mbështet një ngritje të rëndësishme të nivelit të gjyqësorit në Shqipëri, e cila do të ndikojë si te gjykatat ashtu edhe te përmbaruesit.

Pengesat e procesit të përmbarimit të barrave sigurose: Shqipëria (2003)



Shënim: Sa më e madhe rrjeta, aq më të mëdha problemet në secilën prej kategorive përkatëse. Faktorët e “Procesit” masin efektin që kanë pengesa konkrete të ecuria të përmbarimit. Faktorët e “Objektit” tregojnë se në ç’ mënyrë mund të kryhet një përmbarim i efektshëm për lloje të ndryshme kolaterali dhe në rast të paaftësisë paguese të debitorit.

Burimi: Studimi i Treguesit Ligjor i BERZH-it 2003

Telekomunikacionet

Sektori i telekomunikacioneve në Shqipëri tani është i rregulluar nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (“ERT”) dhe mbulohet nga Ligji për Telekomunikacionet, i vitit 2000. ERT-ja

jep llogari përpara legjislativit dhe zbaton politikat e vendosura nga Ministria e Punëve Publike, e Transportit dhe e Telekomunikacioneve (“Ministria”). ERT-ja është formuar si një ent i pavarur me vetë-financim, me qëllim nxitjen e transparencës dhe të investimeve në sektor. Ligji për Telekomunikacionet, i vitit 2000, i cili është hartuar me asistencën e BERZH-it, ofron një kuadër relativisht modern për zbatimin e politikës së qeverisë dhe parashtron kërkesat kryesore ligjore për zhvillimin dhe standartet minimale të sektorit.

Sektori i telekomunikacionit në përgjithësi pasqyron mungesën e zhvillimit dhe të investimeve që janë të pranishme në mbarë infrastrukturën në Shqipëri. Me një penetrim të telefonisë fikse prej më pak se 10%, Shqipëria ka njërin prej niveleve më të ulëta në Evropë. Mirëpo, kjo përqindje përgjithësisht e ulët e telefonisë fikse është kompensuar disi nga rritja dinamike e sektorit të telefonisë celulare. Zhvillimi i këtij sektori e mori shtytjen nga privatizimi i operatorit shtetëror të telefonisë celulare “AMC” në vitin 2000, pas së cilës u fut edhe një operator i dytë GSM (“Vodafone Albania”) në vitin 2001. Shifrat e kohëve të fundit tregojnë një penetrim tregu prej 45% në sektorin e telefonisë celulare.

Nga ana e saj, Qeveria e Shqipërisë (“Qeveria”) ka disa vjet që është përfshirë në një program për zhvillimin e këtij sektori, ku një sukses i hapave të parë është arritur përmes miratimit të një politike sektoriale e cila përqendrohet tek e ardhmja dhe të një ligji modern në vitin 2000. Megjithatë, këto suksese në sektorin e telefonisë celulare, mesa duket, nuk kanë qenë të pranishme në sektorin e telefonisë fikse. Në këtë sektor, reforma dhe rritja duket se kanë mbetur në vend, pas përpjekjeve për të privatizuar operatorin e telefonisë fikse “Albtelecom”, shumicën e aksioneve të të cilit i ka shteti. Tenderi më i fundit për privatizimin u krye pak përpara se të bëheshin zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të kohëve të fundit. Edhe pse përpara zgjedhjeve u deklarua një fitues, qeveria e re është në proces të shqyrtimit të rezultateve të tenderit dhe përfundimi është ende i paqartë.

Edhe pse reformat legjislative dhe të politikave në fund të viteve '90 e afruan Shqipërinë me standartet moderne, zbatimi politikave dhe i legjislacionit ka qenë tejet i ngadaltë, ku shumë pak është ecur përpara në lidhje me miratimin e akteve nënligjore dhe të mekanizmave rregullatore. Sidomos, mungojnë mekanizmat e duhura për interkoneksionin dhe caktimin e tarifave. Nga ana tjetër, tregu ka ecur përpara dhe nuk është më në situatën kur kanë dalë legjislacioni dhe politika, kështu që këto dokumente kanë nevojë për një sjellje në kohë. Edhe pse ekziston një ent rregullator, kapaciteti i këtij enti për të zbatuar dhe për të kontrolluar zbatimin e kuadrin modern pengohet shumë nga mungesa e akteve nënligjore të nevojshme. Po kështu, burimet e kufizuara të ERT-së ndikojnë te aftësia e tij për t’u dhënë zgjidhje problemeve me të cilat përballet sektori dhe për të mbështetur reformën e duhur.

Megjithëse Qeveria dhe ERT-ja, mesa duket, kanë filluar një punë serioze për ta çuar përpara zhvillimin e kuadrit ligjor, rregullator dhe të politikave, mbetet që kjo punë të japë rezultatet e veta. E lidhur me këtë, paqartësia në lidhje me privatizimin e shoqërisë “Albtelecom” hedh hije dyshimi mbi zhvillimin e sektorit. Kështu, autoritetet duhet ta dyfishojnë punën për të zbatuar me shpejtësi një kuadër ligjor dhe politikash të përditësuar për sektorin e telekomunikacioneve, duke i dhënë ERT-së mbështetjen e plotë dhe burimet e nevojshme për të kryer deri në fund reformat e nevojshme. Gjithashtu, Qeveria duhet të marrë masa të menjëhershme për t’u dhënë zgjidhje vonesave të procesit të kryerjes së privatizimit të shoqërisë “Albtelecom”.

ANEKSI 2 – Çështje politike dhe shoqërore

Informacion i shkurtër politik

Shqipëria është republikë me një parlament unikameral i përbërë nga 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejtë dhe 40 të tjerë vendosen nga lista proporcionale e partive. Presidenti dhe kryeministri zgjidhen nga parlamenti. Kushtetuta që ka tani Shqipëria është miratuar me referendum në muajin nëntor 1998, kur zëvendësoi një dokument kalimtar i cili kishte qenë në fuqi qysh prej muajit prill 1991, pas shfuqizimit të kushtetutës së mëparshme komuniste. Kushtetuta e vitit 1998 ia jep pjesën më të madhe të pushtetit Kryeministrit dhe Qeverisë. Presidenca është kryesisht një post ceremonial me kompetenca të kufizuara. Kushtetuta parashikon një gjyqsor të pavarur, por korrupsioni dhe presioni i politikës deri tani ia kanë kufizuar pushtetin për të punuar si i pavarur dhe me efikasitet. Klima politike në parlament ka qenë e paqëndrueshme. Partitë opozitare, socialistët (pasardhës të komunistëve) nga njëra anë dhe Partia Demokratike nuk kanë mundur të bien dakort për ligjet e rëndësishme, çka disa herë ka ngadalësuar ose ka penguar nisma kyçe legjislative.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 sollën humbjen e socialistëve të cilët ishin në pushtet qysh prej vitit 1997. Partia Demokratike e ish-presidentit, Sali Berisha, dhe aleatët e saj fituan 80 vende në krahasim me 60 vende të socialistëve dhe të partive të tjera. Në bazë të shumicës në parlament, qeveria e kryesuar nga PD mori detyrën më 30 shtator 2005, pas ankesave të partive që kishin humbur zgjedhjet, ankesa të cilat e vonuan shumë kalimin e pushtetit. Qeveria e koalicionit të ri e uli numrin e ministrive nga 17 në 14. Partia e Berishës mori 10 ministri; katër të tjerat i morën partnerët e vegjël të koalicionit.

Qeveria njoftoi si prioritet të vetin kryesor luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Qeveria paraardhëse, e kryesuar nga Fatos Nano, në përgjithësi shihej si shumë e korruptuar. Nano dha dorëheqjen nga pozicioni i kryetarit të Partisë Socialiste pas humbjes zgjedhore të partisë së tij dhe zgjedhjet e kongresit të PS-së në tetor zgjodhën Edi Ramën, kryetarin popullor dhe proaktiv të Bashkisë së Tiranës, si pasardhës të kryetarit të mëparshëm. Zgjedhjet vendore, të cilat priten të zhvillohen në vitin 2007, do të tregojnë se sa e kanë marrë veten socialistët e copëzuar, për të kundërshtuar qeverinë e Berishës.

Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe bashkëpunimi rajonal

Synimet kryesore të politikës së jashtme të Shqipërisë pas rënies së Komunizmit kanë qenë anëtarësimi në BE dhe në NATO, çka do të vazhdojë të jetë si synim edhe gjatë qeverisjes së re të Berishës.

Bisedimet për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (“MSA”), e cila shihet si hapi i parë në rrugën drejt anëtarësimin në BE, filluan në muajin janar 2003, por në muajin mars 2004 Komisioni Evropian shprehu një mori shqetësimesh në lidhje me ritmin e ngadaltë të reformave në Shqipëri. Në mes të muajit shtator 2004, gjatë njërës prej kritikave më të forta për procesin e reformave deri atëherë, BE-ja u shpreh qartë që nëse zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 nuk do të mbaheshin në përputhje të plotë me standartet ndërkombëtare, atëherë marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në do të

shkonin mbrapa. Kjo kritikë dhe paralajmërime të tjera të cilat janë dhënë gjatë bisedimeve dypalëshe me qeveri të ndryshme të shteteve anëtare të BE-së u morën me seriozitet jo vetëm nga qeveria socialiste por edhe nga opozita. Sipas Raportit të Ecurisë të Komisionit Evropian për vitin 2005, i publikuar më 9 nëntor 2005, në lidhje me kërkesën e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE, parlamenti shqiptar kishte shërbyer si një forum i vërtetë i shkëmbimit të mendimeve politike. Deri në kohën e zgjedhjeve të vitit 2005, parlamenti kishte miratuar një mori ligjesh të rëndësishme, siç janë ligji për kthimin dhe kompensimin e pasurive, ndryshimet dhe shtesat e kodit zgjedhor dhe një paketë ligjore kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Parlamenti ka miratuar edhe një rregullore të re për t'i bërë më eficientë dhe më transparent mekanizmat e marrjes së vendimeve. Krijimi i Komisionit për reformën Ligjore ka qenë një hap i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë dhe të transparencës së procesit legjislativ. Të mbajtura sipas kodit të ndryshuar zgjedhor, zgjedhjet parlamentare, edhe pse sipas vëzhguesve të pavarur (ndër të cilët edhe vëzhgues nga BE-ja) ishin të zgjatura dhe me probleme, u bënë në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe çuan në një kalim pa probleme të pushtetit te Partia Demokratike të ish-presidentit, Sali Berisha.

Negociatat për MSA-në janë mbyllur dhe teksti për të cilin është rënë dakort u siglua më 18 shkurt 2006. Tani teksti i është propozuar për nënshkrim Këshillit Evropian. Megjithë tonin optimist të Raportit të Ecurisë të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2005, mbetet ende për t'u parë nëse do të mund t'i zbatojë qeveria ndryshimet e kërkuara nga BE-ja dhe nëse do të mund të ketë rezultate më të mira se qeveria e Nanos në një numër fushash, sidomos në atë të luftës kundër krimit të organizuar. Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2005 theksonte gjithashtu se Shqipëria ka ecur përpara në lidhje me përmirësimin e mbikqyrjes, marrjes në punë dhe trajnimit të shërbimit civil dhe ka bërë hapa përpara për të përmirësuar kuadrin e vet ligjor. Në lidhje me sistemin gjyqësor të Shqipërisë, në raport thuhet se është ecur disi përpara në lidhje me përmirësimin e funksionimit të tij, në lidhje me organizimin dhe transparencën e tij dhe në lidhje me disa aspekte të tjera. Megjithatë, zbatimi i drejtësisë penale mbetet i dobët; zbatimi i vendimeve, edhe pse po përmirësohet, mbetet i ulët dhe lipset të përmirësohet transparenca.

Shqipëria ka marrëdhënie të ngushta me SHBA-në. Në vitin 2003 ajo nënshkroi një marrëveshje me SHBA-në për të mos ia dorëzuar qytetarët amerikanë Gjykatës Penale Ndërkombëtare ("GJPN") në Hagë. Po në vitin 2003 ajo nënshkroi, së bashku me Kroacinë dhe Maqedoninë, Kartën SHBA-Adriatik. Ajo e ka mbështetur luftën e SHBA-së në Irak, ku në muajin nëntor 2005 dërgoi një kontingjent të ri prej 120 trupash atje, turni i gjashtë qysh prej muajit prill 2003. SHBA-të e mbështesin Shqipërinë, e cila tani bën pjesë në Programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s ("PfP"), në rrugën e saj drejt anëtarësimit të plotë në NATO. Takimi i krerëve të shteteve të NATO-s i vitit 2004, i mbajtur në Stamboll, nuk arriti të vendosë një datë për anëtarësimin e Shqipërisë, por kjo çështje është nën shqyrtim të vazhdueshëm në kontekstin e aplikimit të dy vendeve të tjera: Kroacisë dhe Maqedonisë. NATO ka 1,200 trupa në Shqipëri, si forcë mbështetëse për trupat e veta në Kosovë. Rreth zonave bregdetare të Vlorës dhe Durrësit ka të vendosura mjete lundrimi detare turke dhe italiane. Marrëdhëniet më të rëndësishme dypalëshe të Shqipërisë janë me Italinë dhe me Greqinë, dy partnerët kryesorë tregtare. Ushtria italiane ka ndërhyrë për të mbrojtur rendin civil si gjatë periudhës 1991-92 ashtu edhe si pjesë e një force ndërkombëtare gjatë trazirave civile pas rënies së skemave të përhapura piramidale

gjatë vitit 1997. Një numër i madh shtetasish shqiptarë punojnë në Greqi dhe në Itali, nga të cilët në vend vijnë një numër i madh transfertash private.

Qysh në fillim të konfliktit të armatosur në Ballkan në vitin 1991, Shqipëria ka luajtur një rol konstruktiv në këtë trevë. Në vitin 2001 ajo e mbështeti Marrëveshjen e Ohrit e cila i dha fund konfliktit me guerrilët e shqiptarëve etnik në shtetin fqinjë Maqedoni (ose Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë). Në fillim të bisedimeve për statusin e ardhshëm të Kosovës, në muajin nëntor 2005, qeveria e Berishës shprehu mbështetjen e vet për pavarësinë me kusht për këtë provincë, por deklaroi qartë se nuk ushqente asnjë aspiratë për “Shqipërinë e Madhe”. Shqipëria ka marrëveshje të tregtisë së lirë me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, me Kosovën, me Serbinë dhe Malin e zi, me Bosnjë-Hercegovinën, me Kroacinë, me Bullgarinë dhe Moldavinë. Ajo merr pjesë në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (“SECP”), në Paktin e Stabilitetit, në Nismën e Evropës Juglindore (“SEEP”), në Nismën Adriatiko-Joniane, në Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi (“BSEC”), në Nismën e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (“SECI”) dhe në Nismën e Sigurisë Kufitare.

Çështjet e integritetit

Korrupsioni është një problem i cili konsiderohet si nga popullsia në vend ashtu edhe nga të jashtmit si problem i rëndë. Madje, një pjesë të mirë të suksesit të vet gjatë zgjedhjeve të vitit 2005, Partia Demokratike e Sali Berishës ia dedikon faktit që luftën kundër korrupsionit e bëri moto të fushatës së vet. Megjithatë, edhe përpara zgjedhjeve dhe ndryshimit të qeverisë që sollën ato, janë bërë disa përpjekje për të luftuar korrupsionin, sipas Raportit të Ecurisë për Shqipërinë për vitin 2005 të Komisionit Evropian. Shqipëria merr pjesë në Grupin e Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (“GRECO”); janë miratuar ligje të reja për konfliktin e interesit; ka pasur një rritje të numrit të rasteve të ndjekjeve penale të zyrtarëve publikë për korrupsion (171 gjatë vitit 2004, nga 76 gjatë vitit 2003 dhe 58 gjatë vitit 2002) dhe është vepruar fort kundër korrupsionit brenda rradhëve të policisë; janë ratifikuar një sërë konventash ndërkombëtare kundër korrupsionit. Mirëpo, kanë mbetur problemet e zbatimit, kontrollit zbatues dhe bashkërendimit të punës dhe perceptimi i popullsisë në vend për korrupsionin vazhdon të jetë negativ. Sipas Raportit, rezultatet e dukshme në fushën e luftës kundër korrupsionit mbeten të dobëta megjithë mbështetjen aktive të bashkësisë ndërkombëtare për strategjinë shqiptare kundër korrupsionit.

Pas trazirave të vitit 1997, siguria është rikthyer në shumë pjesë të Shqipërisë, siç u pasqyrua edhe në mungesën relative të dhunës gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2005. Krimi i organizuar përbën një problem të rëndë në disa fusha. Një pjesë e përmirësimeve në fushën e ligjit dhe të rendit kanë ardhur si pasojë e presionit ndërkombëtar. Megjithatë, Shqipëria është në përgjithësi një fushëveprimi për kontrabandën, kryesisht në formë kalimtare për në vende të tjera. Trafikimi i qenieve njerëzore, sidomos i grave dhe fëmijëve, mbetet problem, sipas raportit për të drejtat e njeriut në Shqipëri i Departamentit Amerikan të Shtetit i vitit 2004, i publikuar në muajin shkurt 2005. Penalitetet e Kodit Penal janë të larta për trafikimin për shfrytëzim seksual ose për punë të detyruar. Në muajin tetor 2004, parlamenti miratoi një ligj të ri i cili parashikon sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive nëse burimi i tyre është krimi i organizuar ose trafikimi. Gjatë vitit 2004, sipas Prokurorisë, pati 234

çështje të hapura për trafikimin e qenieve njerëzore, ndërsa u dënuan 362 persona për veprën e trafikimit të qenieve njerëzore. Megjithatë, problem mbetet ndjekja penale e trafikantëve. Disa prej tyre lihen të lirë për shkak të mungesës së provave, ose, nëse kalojnë në ndjekje penale, akuzohen dhe dënohen për akuza më të vogla. Shqipëria është edhe burim edhe tranzit për trafikimin e grave dhe të fëmijëve për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe të punës së detyruar. Trafikantët përdorin kryesisht rrugët tokësore si Shqipëri-Maqedoni-Greqi ose Shqipëri-Mal i Zi ose dokumenta të fallsifikuar për t'i transportuar viktimat e tyre me avion ose me traget.

Çështjet sociale

Popullsia. Në krahasim me vendet e tjera në tranzicion të Evropës Juglindore dhe Qendrore, Shqipëria është më poshtë përsa i takon standartit të jetesës dhe treguesve të zhvillimit njerëzor. Sipas statistikave zyrtare, popullsia rezidente e Shqipërisë në kohën e regjistrimit zyrtar të popullsisë në vitin 2001 ishte 3,069,000, ose 3.6% më e vogël se në regjistrimin e vitit 1989. Sipas çmuarjeve të Institutit Shqiptar të Statistikave, popullsia është rritur prej atëherë (me 1.1% në vitin 2003). Rënia gjatë periudhës 1989-2001 pasqyron si përqindjet e lindjeve ashtu edhe emigrimin në shkallë të madhe. Jetëgjatësia mesatare në lindje është 74.3 vjet. Në vitin 2003 numri i lindjeve ishte 42.8% më i vogël se në vitin 1990. Gati një milion shqiptarë mendohet se kanë emigruar prej vitit 1990 – kryesisht në Greqi, Itali dhe në SHBA, sipas Ministrisë Shqiptare të Punës dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracion. Emigrimi dhe numri i vogël i lindjeve kanë çuar në një ulje të ndjeshme të përqindjes së popullsisë nën 34 vjeç – nga 69.2% në vitin 1969 në 59.3% në vitin 2004. Pjesa më e madhe e popullsisë vazhdon të jetojë në fshat, por përqindja e popullsisë në qytet është rritur në mënyrë drastike nga 35.8% gjatë vitit 1990 në 44.5% gjatë vitit 2004. Popullsia në kryeqytet, Tiranë, është rritur me 41% nga viti 1989 deri në vitin 2001.

Mbrojtja kushtetuese që ofron Kushtetuta e vitit 1998 u jepet të gjitha pakicave në vend – greke, etnike maqedonase, malazaze, vllahe dhe rome. Megjithatë, sipas raportit më të fundit (2004) të Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut në Shqipëri, i publikuar në muajin shkurt 2005, ka diskriminim social kundër pakicave – sidomos kundër romëve. Për të trajtuar këtë problem, qeveria ngriti në muajin mars 2004 Komitetin Shtetëror për Pakicat i përbërë nga përfaqësues të pakicave të ndryshme në vend. Grekët përbëjnë pakicën më të madhe kombëtare, pas të cilëve vijnë grupet e vogla të maqedonasve dhe të malazezëve, vllahëve dhe romëve e egjiptianëve. Pakica etnike greke përfshihet në debate me qeverinë në lidhje me zonat zgjedhore, arsimin në gjuhën greke, të drejtat për pronën dhe dokumentat shtetërorë. Si pasojë e ndalimit të fesë të imponuar nga Enver Hoxha në vitin 1967, shoqëria shqiptare është shumë laike. Ndarja fetare ka dekada që nuk matet, por sipas çmuarjeve 70% e shqiptarëve kanë origjinë myslimane, rreth 20% ortodokse dhe 10% katolike romane.

Shoqëria civile në Shqipëri mbetet e dobët. Shumë veprime janë bërë nga organizatat e shoqërisë civile për të dhënë kontributin e tyre për zhvillimin e vendit. Janë marrë nisma për të nxitur bashkëpunimin midis institucioneve shtetërore, ministrive dhe organizatave të shoqërisë civile, të përfshira në hartimin e strategjive kombëtare në lidhje me fusha të rëndësishme sociale siç janë ato të fëmijëve dhe anti-trafikimi. Presioni i ushtruar nga shoqëria civile është konsideruar si një hap pozitiv për të ndërgjegjësimin e publikut dhe nxitjen e një pjesëmarrjeje në procesin e marrjes së

vendimeve shtetërore. Gjithashtu, kjo është parë edhe si një mundësi për qytetarët për t'u dhënë zë shqetësimeve dhe probleme të tyre, duke sjellë kështu për herë të parë protesta publike të pamotivuara politikisht. Dy federatat kryesore të sindikatave veprojnë si organizata ombrellë për shumicën e sindikatave në vend: Konfederata e Pavarur e Sindikatave të Shqipërisë (rreth 75,000 anëtarë) dhe Konfederata Shqiptare e Sindikatave (rreth 100,000 anëtarë). Ka pasur një rënie të numrit të anëtarëve të sindikatave gjatë tranzicionit. Disa prej sindikatave nuk i përkasin asnjërës prej organeve të mësipërme.

Arsimi. Arsimi është falas dhe i detyrueshëm për nxënësit nga gjashtë deri në katërmëdhjetë vjeç dhe është falas deri në moshën 18 vjeç. Sipas një raporti të UNDP i vitit 2004, përqindja e braktisjes së shkollës e cila ka qenë 1% në vitin 1980 u rrit në fillim të tranzicionit, duke e pasur kulmin në shifrën 6.3% në vitin 1991. Kjo erdhi për shkak të migrimit të brendshëm dhe të jashtëm, të rritjes së kostove të shkollimit dhe të dobësimit të organeve shtetërore të cilat ushtrojnë kontrollin zbatues për arsimin e detyrueshëm. Përqindja e braktisjes së shkollës zbriti në 2% deri në vitin 2003, por një studim i INSTAT-it i vitit 2002 tregoi se vetëm 63% të 14-vjeçarëve e mbaronin në kohë arsimin e detyrueshëm. Është rishfaqur analfabetizmi, i cili gjatë epokës së komunizmit ishte zhdukur. Arsyeja kryesore për nivelin e lartë të mosmbarimit të shkollës është varfëria, meqenëse familjet fshatare detyrohen t'i përdorin fëmijët si krah pune. Përqindja e ndjekjes së shkollës nga vajzat bie pasi ato arrijnë pubertetin. Raporti mesatar nxënës/mësues në arsimin e mesëm është 18.9, i cili e kalon mesataren e OECD prej 13.9. Raporti i regjistrimit në arsimin terciar ishte 15% në vitin 2003. Arsimi i lartë publik është falas dhe pranimi bëhet përmes konkursit. Në Tiranë ekzistojnë dy universitete private, por shifrat e studentëve janë modeste. Studentët me pagesë janë rreth 10% e të gjithë studentëve në universitetet publike. Mendohet se rreth 5,000 studentë i kryejnë studimet jashtë shtetit çdo vit, shumica e të cilëve nuk kthehen më në Shqipëri. Arsimi është vendosur si njëri prej prioriteteve të strategjisë kombëtare për zhvillim ekonomik dhe social e prezantuar në publik në vitin 2001. Megjithatë, shpenzimet qeveritare për arsimin ranë nga 3.4% e PBB-së në vitin 1999 në 2.85% e PBB-së në vitin 2003. Rrogat e mësuesve janë rritur më shpejt se ato të punonjësve të tjerë të sektorit publik, për të parandaluar largimin e tyre nga profesioni. Grevat e mësuesve kanë qenë njëri prej faktorëve për këtë rritje.

Shëndetsia. Gjatë fillimit të viteve '90, sistemi i centralizuar shëndetsor i Shqipërisë, i mbështetur në dhënien falas të shërbimeve në pikën e shërbimit (duke përfshirë edhe banorët e zonave të largëta) u shpërbë nën presionin e migrimit të pakontrolluar nga fshati në qytet. Sistemi i shëndetit publik vuan nga mungesa e investimeve, humbja e personelit të kualifikuar në drejtim të sektorit privat dhe nga një pakësim i madh i personelit në zonat e largëta. Sipas Njësisë së Informacionit Ekonomik (*Economist Intelligence Unit*), Shqipëria ka 1.3 mjekë për çdo 1,000 banorë, më pak se gjysma e përqindjes së BE-së prej 3 mjekësh për 1,000 banorë. Përmirësimet e kohëve të fundit në shëndetsi kanë ardhur pjesërisht nga asistencë prej OBSH-së dhe UNICEF-it. Vdekshmëria foshnjore ka rënë, por vazhdon të mbetet e lartë në krahasim me vendet e tjera të Evropës. Tuberkulozi, i cili ishte zhdukur gjatë epokës së komunizmit, është rishfaqur si pasojë e varfërisë dhe e mbipopullimit në qytetet kryesore. Shërbimet shëndetsore financohen nga një gërshetim i tatimeve, sigurimeve të detyrueshme shëndetsore dhe fondeve të donatorëve. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit Shqipëria ka shpenzuar mesatarisht 2.2% të PBB-së çdo vit për kujdesin shëndetsor, krahasuar me rreth 4% të vendeve të tjera në tranzicion. Shëndetsia, sikurse edhe arsimi, përbën një

prioritet për autoritetet por shpenzimet buxhetore për shëndetsinë shpesh ndërpriten papritur për shkak të rënies së të ardhurave buxhetore.

ANEKSI 3 – Sfidat e tranzicionit

Shqipëria përballlet me një mori sfidash të rëndësishme tranzicioni në të gjithë sektorët. Vlerësimi që paraqitet më poshtë është një version i përditësuar i “Vlerësimit të sfidave të tranzicionit” i vitit 2005.

Industritë e specializuara

Industria e përgjithshme: Problemet serioze të reformës së përgjithshme në industri lidhen me kontrollin e dobët të zbatimit të ligjit, korrupsionin dhe përqindjen e madhe të PBB-së e cila vjen nga ekonomia informale (e cila çmohet se është afro 30 përqind e PBB-së së regjistruar, sipas OECD). Puna e qeverisë për të përmirësuar mjedisin e biznesit, si për shembull futja e legjislacionit të ri për konkurrencën dhe ngritja e një autoriteti të pavarur për konkurrencën, pengohet nga kapaciteti i dobët zbatues i sektorit publik. Lipset të ristrukturohen shumë ndërmarrje për të përmirësuar konkureshmërinë, ndërsa standartet e drejtimit të shoqërive aksionere dhe të etikës së biznesit janë të ulët. Ndërmarrjet janë kryesisht biznese familjare, të cilët parapëlqejnë të punojnë përmes kanaleve informale, duke përdorur njohjet e tyre për investime në biznese të reja, prokurimin, marketingun dhe shitjet dhe duke u mbështetur më shumë te besimi dhe te presioni shoqëror për lëvrimin e mallrave dhe të shërbimeve në bazë të kontratave gojore. Cilësia e gjyqësorit është e ulët dhe shumë pak besim ka te ky sistem i cili konsiderohet si i korruptuar, i ngadaltë dhe i ndërlikuar.

Agrobiznesi: Të gjitha çmimet bujqësore të prodhuesve dhe konsumatorëve janë liberalizuar, ndërsa tarifat e importeve janë ulur dalëngadalë. Rishpërndarja e madhe e tokës bujqësore shtetërore ka mbaruar, por një pjese të mirë të kësaj toke i mungojnë të drejta prone të sigurt dhe të qarta. Procedurat ligjore dhe administrative për zgjidhjen e konflikteve të pronësisë mbeten të dobëta. Në këtë sektor ka pasur investime të kufizuara të huaja. Shoqëritë tregtare pengohen nga pajisjet e amortizuara, mungesa e kredisë, standartet e ulëta të cilësisë dhe një njohuri e dobët e tregjeve konkurente. Kredia rurale po sigurohet në mënyrë të ngadaltë jashtë skemave të llojit “mikrokredi”, por mundësia e kredimarrjes për fermerët mbetet e kufizuar. Sektori i bujqësisë përbën rreth një të katërtën e PBB-së dhe nuk tatóhet.

Sektori i burimeve natyrore: Industria e burimeve natyrore në Shqipëri është e vogël dhe është përqendruar te kromi, bitumi, bakri dhe nikeli. Megjithëse në këtë sektor ushtrojnë aktivitet disa shoqëri private, të vendit dhe të huaja, rregullimi i këtij sektori është shumë i dobët dhe një shqetësim mbetet mbrojtja e mjedisit. Sektori ka nevojë për një reformë rregullatore dhe për investime. Është duke ecur përpara privatizimi i firmës së nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror “Albpetrol”. Mirëpo, privatizimi i Shoqërisë Shqiptare të Përpunimit dhe Shitjes së Naftës (“ARMO”) ka mbetur mbrapa për shkak të mungesës së interesit të investuesve.

Pronat dhe turizmi: Tregtueshmëria e tokës është *de facto* e kufizuar. Ka shumë pak ndërhyrje nga shteti për sa u takon subvencioneve dhe kontrollit rregullator. Pronësia e paqartë e tokës në zonat kryesore qytetare dhe bregdetare vijon të pengojë zhvillimin ekonomik, ku vetëm rreth 18 përqind e pronave të patundshme janë të regjistruara në rregull. Ndërsa e kundërta ndodh në zonat fshatare, ku toka e regjistruar është 80 përqind e tokave gjithsej. Në muajin korrik 2004 u miratua një ligj i ri për kthimin dhe kompensimin e pronave. Megjithatë, metodika e zbatimit të këtij ligji u miratua vetëm

në muajin prill 2005. Gjithashtu, edhe administrata që kontrollon zbatimin e ligjit mbetet e dobët dhe e pafinancuar siç duhet dhe mekanizmi i kompensimit për pronarët të cilët nuk mund ta rimarrin tokën e tyre është i paqartë. Ka një sektor ndërtimi i cili po rritet me vrull, i financuar në një shkallë të madhe nga transfertat private nga jashtë. Po zbatohet edhe ligji për legalizimin e pronave të patundshme të ndërtuara në mënyrë të paligjshme kohët e fundit, i miratuar në muajin tetor 2004. Deri në afatin përfundimtar të muajit mars 2005 ishin paraqitur rreth 50,000 kërkesa. Megjithatë, gjatë viteve të fundit mendohet se janë ngritur rreth 300,000 ndërtesa të paligjshme. Ky lulëzim i ndërtimit po i nënshtrohet tani një rregullimi më të madh: gjatë viteve të fundit janë prishur ndërtesat e ngritura në mënyrë të paligjshme në qendër të Tiranës, dhe kërkesat ligjore të urbanistikës po zbatohen më shumë se në të shkuarën. Shumë pak është ecur përpara në lidhje me ristrukturimin dhe zgjerimin e sektorit të turizmit, përfshi këtu edhe futjen e metodave të financimit dhe produkteve të reja. Zonat bregdetare vuajnë nga ndotja dhe nga aktivitetet ndërtimore të parregulluara. Zhvillimin e sektorit të turizmit e pengon mungesa e infrastrukturës.

Infrastruktura

Sektori i energjitikës: Kohët e fundit është realizuar ndarja e këtij sektori. Për përmirësimin e performancës së KESH-it ndihmoi ndjeshëm një kontratë asistence bashkëmenaxhimi midis KESH-it dhe ENEL-it, shoqërisë kryesore energjitike italiane, e cila ishte në zbatim nga viti 2000 deri në vitin 2004. Gjatë pesë viteve të fundit, çmimet e energjisë elektrike janë rritur në mënyrë të konsiderueshme, duke arritur rreth 6 centë të dollarit amerikan për kWh në fund të vitit 2004. Rritja e tarifave duhet të vazhdojë gjatë viteve në vijim, siç përcaktohet nga Plani i Punës për Sektorin e Energjitikës 2005-2007. Është ecur ndjeshëm përpara në lidhje me rritjen e përqindjes së arkëtimit dhe në lidhje me pakësimin e humbjeve në transmetim dhe shpërndarje. Përmirësimet menaxheriale dhe investimet në sistemin energjitik e kanë ulur numrin e ndërprerjeve të energjisë elektrike në shkallë të madhe, por një ndërthurje e thatësirës së verës së vitit 2005, një zjarri në njërin prej hidrocentraleve kryesore dhe mungesës së planifikimit të duhur për importimin e energjisë elektrike sollën disa javë ndërprerje të energjisë elektrike deri në 20 orë në ditë në mbarë vendin në muajin nëntor 2005. Qysh atëherë situata është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, me nënshkrimin e kontratave të reja të importimit të energjisë dhe me rritjen e nivelit të ujit në hidrocentralet kryesore. Megjithatë, qëndrueshmëria e rrjetit të furnizimit mbetet shumë më poshtë se standartet ndërkombëtare, ka shpesh ndërprerje të lokalizuara dhe ndërprerjet në shkallë të madhe mund të ndodhin përsëri. Ekziston një ent rregullator, por ai është ende i dobët.

Sektori i IBM: Kontrolli mbi shumë prej shërbimeve bashkiake u është kaluar autoriteteve vendore. Pjesërisht transporti urban kryhet nga shoqëri private, por shumica e shërbimeve bashkiake mbeten të çorganizuara dhe kërkojnë një reformë të konsiderueshme, duke përfshirë edhe rritjen e tarifave, komercializimin dhe rregullimin e duhur. Nuk ka objekte të trajtimit të mbetjeve ujore (ujrave të zeza).

Rendimenti energjitik: Sektori i efikasitetit energjitik është në një fazë shumë të hershme zhvillimi. Parakushte të nevojshme për funksionimin e këtij sektori janë siguria e ofertës, struktura e duhur tarifore, komercializimi i plotë dhe rregullimi adekuat.

Telekomunikacioni: Në muajin qershor 2005, qeveria miratoi shitjen e operatorit shtetëror të telefonisë fikse “Albtelecom”. Të drejtën për të blerë 76 përqind të aksioneve të kësaj shoqërie e fitoi shoqëria turke “Calik Energy Telecommunication”, kundrejt shumës 120 milion euro, ku shteti do të mbante 24 përqind të shoqërisë. Në kuadër të privatizimit, shoqërisë “Albtelecom” iu dha licenca e tretë e telefonisë celulare, duke i dhënë mundësi të konkuronte drejtpërdrejtë me dy shoqëritë ekzistuese të telefonisë celulare. Mirëpo, në mes të muajit tetor 2005 parlamenti i ri nuk pranoi ta ratifikojë kontratën e privatizimit dhe vendosi të kontraktojë një konsulencë të huaj për ta shqyrtuar marrëveshjen dhe procedurën e tenderit. Deri në mes të muajit mars 2006 procedurat e tenderit për konsulencën e huaj për shqyrtimin e privatizimit të Telekomit nuk kishin mbaruar ende. Menaxhimi i konkurrencës së rritur në këtë sektor, sidomos interkoneksioni midis operatorëve, do të jetë e vështirë për një kuadër rregullator që është më i dobët se në vendet e tjera në tranzicion. Ndërkohë që në Shqipëri ekziston zyrtarisht një ent rregullator i pavarur, kapaciteti i këtij enti për të zbatuar reformat rregullatore pengohet shumë nga mungesa e njohurive të duhura teknike, burimeve dhe angazhimit të qeverisë për t’u dhënë zgjidhje këtyre çështjeve dhe për të mbështetur reformat rregullatore (psh interkoneksionin, reformën e tarifave dhe lidhje për të gjithë). Tarifat e telefonisë fikse janë të ulëta dhe të paekuilibruara, si përsa u takon shërbimeve ashtu edhe përsa i takon llojit të klientëve. Penetrimi i telefonisë fikse është rreth 7.5 përqind, ndërsa penetrimi i telefonisë celulare është rreth 45 përqind.

Transporti: Sektori i transportit është joadekuat dhe kërkon investime të konsiderueshme. Në fushën e hekurudhave, funksionet e vendosjes së politikave dhe ato të ushtrimit të aktivitetit nuk janë të ndarë nga njëri tjetri dhe bizneset qendrore të hekurudhave (infrastruktura, pasagjerët, mallrat, etj.) ushtrohen nga i njëjti subjekt. Në fushën e rrugëve, është në proces e sipër minimizimi dhe komercializimi i shoqërive të ndërtimit, ka konkurrencë dhe privatizim të kufizuar. Financimi i sektorit të rrugëve mbetet i pareformuar. Një shtytje e rëndësishme i është dhënë reformës nga konçesioni privat për të rehabilituar aeroportin ndërkombëtar të Tiranës, i cili u arrit përmes një procesi transparent të një tenderi ndërkombëtar. Gjithashtu, një sërë terminalesh të porteve vihen në punë nga shoqëri private.

Institucionet financiare

Sektori bankar: Në Shqipëri ka një nivel të ulët ndërmjetësimi financiar, por privatizimi i bankës më të madhe në vend “Banka e Kursimeve” e ka kaluar të gjithë këtë sektor në menaxhim privat. Mbikqyrja financiare është përmirësuar, por ndërmjetësimi pengohet nga infrastruktura e dobët ligjore dhe rregullatore. Për shembull, ka ende probleme në lidhje me dokumentacionin e tepërt nga banka qendrore për kërkesat për kredi, çka mund të pengojë zhvillimin e kredive konsumatore, dhe kërkesa të tepërta për kolateral. Pas kryerjes së privatizimit të bankave, kredia për sektorin privat është rritur shumë shpejt. Shuma gjithsej e portofolit të huave gati u dyfishua gjatë vitit 2005, por vazhdon të jetë vetëm rreth 14 përqind e PBB-së (në fund të vitit 2005), nga të cilat kredia për ndërmarrjet private zinte rreth 10 përqind të PBB-së, ndërsa huadhënia për familjarët zinte rreth 4 përqind të PBB-së. Rreth 90 përqind të kredive garantohen me kolateral dhe rreth 80 përqind e huave jepen në monedha të huaja. Përqindja e huave të pakthyera është e ulët, përafërsisht 4 përqind e shumës gjithsej. Normat e interesit për huatë e reja janë ulur ndjeshëm si pasojë e konkurrencës së rritur. Megjithatë, konkurrenca është kryesisht e

përqendruar te huadhënia për sektorin e ndërmarrjeve të mëdha, duke qenë se bankat në vend nuk kanë dëshirë t'u japin hua bizneseve të vogla. Vazhdon të mbisundojë huadhënia informale, sidomos mes bizneseve të vogla dhe atyre mikro. Megjithatë, sipas studimeve të kryera me porosi të Bankës së Shqipërisë, ka informacion se bizneset po kalojnë nga huatë e marra në rrugë informale drejt huave formale. Një sfidë që mbetet për këtë sektor është rritja e huadhënies vendase për sektorin privat, sidomos për NMVM-të.

Sektori financiar jobankar: Legjislacioni dhe rregullimi i tregjeve të letrave me vlerë ka nevojë për një fuqizim të konsiderueshëm në fushat e detyrimeve të deklarimeve, standarteve të kontabilitetit dhe auditimit dhe zbatimit të një kuadri të fuqishëm për tregtimin e letrave me vlerë në tregjet dytësore. Në sektorin e sigurimeve, ligji i ri për sigurimet e ka fuqizuar mjedisin ligjor dhe rregullator, por një vështirësi mbetet zbatimi efektiv. Po përgatitet legjislacioni i ri për qeradhënien e mjeteve, i cili mund të ndihmojë për zhvillimin e një tregu të vogël të dhënies me qera të aktiveve. Bursa konsiston kryesisht në këmbimin e valutës së huaj, ndërsa tregu i sigurimeve është shumë i vogël. Shoqëria shtetërore e sigurimeve INSIG është privatizuar pjesërisht përmes përfshirjes së BERZH-it dhe KFN-së. Nuk ka kufizime për hyrjen e subjekteve të huaja në sektorin financiar jobankar.

Sektorët e fondeve private të kapitalit: Në vend nuk është zhvilluar ende një klasë e menaxherëve të kapitalit privat me njohuri konkrete vendase, ose investues të cilët të jenë të gatshëm të investojnë në fonde private të kapitalit që ushtrojnë aktivitet në Shqipëri. Mbetet ende për t'u zhvilluar njohuria e fondeve të kapitalit si instrument për të ofruar financim për ndërmarrjet.

NMVM: Nisja e një biznesi është e kushtueshme: duhen 11 procedura të ndryshme, mesatarisht 47 ditë dhe mbi 32 përqind të të ardhurave mesatare për të regjistruar një shoqëri të re. Korrupsioni, nepotizmi dhe mbrojtja politike përbëjnë pengesat kryesore për zhvillimin e NMVM-ve, çka prek edhe gatishmërinë e sipërmarrësve për të regjistruar bizneset dhe rrit koston e ushtrimit të biznesit. Sistemi tatimor perceptohet si jotransparent nga NMVM-të. Nuk ekziston ndonjë regjistër kredish apo ndonjë zyrë e kredive private. Ekziston legjislacioni për falimentimin, por mungesa e regjistrave efektiv të tokës dhe i kadastrave shpesh i ka penguar firmat të përdorin pronat e tyre si kolateral. Për pasojë, bankat e nivelit të dytë kërkojnë nivele të larta kolaterali, duke e ulur kështu mundësinë e firmave për të marrë hua përmes kanaleve formale. Kohët e fundit është ngritur një sistem i regjistrimit të pronave të patundshme. Ka një bankë mikrokredish e cila ka gjashtë vjet që u jep hua bizneseve mikro dhe të vogla. Ka shumë pak huadhënie nga bankat e nivelit të dytë për sektorin e NMVM-ve.

ANEKSI 4 – Disa tregues të përzgjedhur ekonomik

	2000	2001	2002	2003	2004	2005 <i>Çmuarje</i>	2006 <i>Parashikim</i>
Produkti dhe shpenzimet	<i>(ndryshimi në përqindje, në terma realë)</i>						
PBB	6.5	7.1	4.3	5.7	6.7	5.5	5.0
Konsumi privat	5.3	na	na	na	na	na	na
Konsumi publik	7.4	na	na	na	na	na	na
Formimi i kapitalit të qendrushëm bruto ¹	17.9	na	na	na	na	na	na
Eksporti i mallrave dhe i shërbimeve	5.8	na	na	na	na	na	na
Importi i mallrave dhe i shërbimeve	6.5	na	na	na	na	na	na
Produkti industrial bruto	0.5	7.1	-7.9	2.7	3.1	4.0	na
Produkti bujqësor bruto	4.5	2.2	2.1	3.0	3.8	3.0	na
Punësimi²	<i>(ndryshimi në përqindje)</i>						
Krahu i punës (në fund të vitit)	-1.8	-3.0	-12.2	-0.3	-0.8	0.9	na
Punësimi (në fund të vitit)	0.2	-13.8	0.0	0.7	-0.4	0.9	na
	<i>(si përqind i krahut të punës)</i>						
Papunësia (në fund të vitit)	16.8	14.5	15.8	15.0	14.5	14.7	na
Çmimet dhe pagat	<i>(ndryshimi në përqindje)</i>						
Çmimet e konsumatorit (mesatare vjetore)	0.1	3.1	5.2	2.4	2.9	2.3	3.0
Çmimet e konsumatorit (në fund të vitit)	4.2	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	3.0
Çmimet e prodhuesit (mesatare vjetore)	5.0	-5.8	6.5	6.7	12.4	2.5	na
Çmimet e prodhuesit (në fund të vitit)	na	-4.0	11.2	5.0	12.3	2.4	na
Të ardhurat mesatare bruto mujore në ekonomi (mesatare vjetore)	19.7	24.7	11.7	10.0	6.0	7.3	na
Sektori qeveritar	<i>(përqind e PBB-së)</i>						
Bilanci i përgjithshëm qeveritar	-9.2	-8.5	-7.2	-4.3	-5.1	-3.3	-4.1
Shpenzimet e përgjithshme qeveritare	31.8	31.5	31.0	27.7	28.8	26.7	na
Borxhi i përgjithshëm i qeverisë	71.1	66.6	64.7	59.1	55.9	54.8	na
Sektori monetar³	<i>(ndryshimi në përqindje)</i>						
Oferta e gjerë monetare (agregati M2, në fund të vitit)	10.4	15.4	5.3	9.2	10.8	11.4	na
Kredia e brendshme (në fund të vitit)	8.6	4.1	6.7	11.0	7.7	13.2	na
	<i>(përqind e PBB-së)</i>						
Oferta e gjerë monetare (agregati M2, në fund të vitit)	49.6	51.7	50.9	49.2	50.2	50.6	na
Normat e interesit dhe të këmbimit valutor	<i>(përqind për vit, në fund të vitit)</i>						
Norma e rifinancimit ⁴	10.8	7.0	8.5	6.5	5.3	5.0	na
Norma e bonove të thesarit (me maturitet 3-mujor)	10.8	8.0	11.2	7.4	6.2	5.5	na
Norma e depozitave (1-vjeçare)	6.9	6.9	8.0	5.5	4.5	3.0	na
Norma e huadhënies (1-vjeçare) ⁵	21.2	15.3	14.6	11.8	11.0	12.0	na
	<i>(Lek për 1 dollar amerikan)</i>						
Norma e këmbimit (në fund të vitit)	142.8	135.9	134.0	106.4	92.6	98.1	na
Norma e këmbimit (mesatarja vjetore)	143.9	143.6	140.2	121.3	102.8	98.1	na
Sektori i jashtëm	<i>(milion dollarë amerikanë)</i>						
Llogaria korente (rrethëse)	-273	-261	-435	-470	-460	-621	-662
Bilanci tregtar	-821	-1,027	-1,155	-1,336	-1,579	-1,933	-2,055
Eksportet	255	305	330	447	603	766	932
Importet	1,076	1,332	1,485	1,783	2,182	2,699	2,987
Investimet e huaja të drejtpërdrejta, neto	143	204	135	178	343	288	339
Rezervat bruto, pa florin (në fund të vitit)	608	737	860	1,026	1,374	1,459	na
Borxhi i jashtëm	1,640	1,200	1,180	1,420	1,673	1,747	na
	<i>(muaj importe mallrash dhe shërbimesh)</i>						
Rezervat bruto, pa florin (në fund të vitit)	4.8	4.9	5.0	4.8	5.1	4.4	na
	<i>(përqind e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve)</i>						
Shërbimi i borxhit	4.0	4.1	6.8	5.0	4.1	4.3	na
Tregues të përbërë	<i>(siç tregohet në kllapa, pas zërave)</i>						
Popullsia (në fund të vitit, në milion)	3.1	3.1	3.2	3.2	3.2	3.2	na
PBB (në miliardë lek)	533	590	631	714	776	857	937
PBB për frymë (në dollarë amerikanë)	1,190	1,312	1,409	1,858	2,359	2,730	na
Pjesa që ze industria në PBB (në përqind)	8.2	7.8	7.7	7.5	7.3	na	na
Pjesa që ze bujqësia në PBB (në përqind)	32.2	32.2	28.4	27.6	26.7	na	na
Llogari korente/PBB (në përqind)	-7.4	-6.3	-9.7	-8.0	-6.1	-7.1	-7.0
Borxhi i jashtëm - rezervat (në milion dollarë amerikanë)	1,032	463	320	394	299	288	na
Borxh i jashtëm/PBB (në përqind)	44.3	29.2	26.2	24.1	22.2	20.0	na
Borxh i jashtëm/eksporte të mallrave (në përqind)	232.4	142.9	128.9	121.7	104.2	86.7	na

1 Përfshin ndryshimet e inventareve

2 Shifrat nuk përfshijnë punonjësit që kanë emigruar jashtë shtetit, të cilët zinin rreth 27.4% të krahut gjithsej të punës në vitin 2000

3 Të dhënat deri në vitin 2001 (përfshirë edhe vitin 2001) mbështeten në standartin e mëparshëm të raportimit. Standarti i ri i raportimit, në përputhje me Manualin Statistikor Monetar dhe Financiar, i përjashton depozitat e bllokuara nga oferta e gjerë e parasë

4 Nga viti 2001 shifrat tregojnë normën e marrëveshjeve të riblerjes të Bankës Qendrore

5 Shifrat tregojnë normën mesatare mujore të ponderuar për kreditë e reja në lekë me maturim 6 muaj deri në 1 vit në muajin dhjetor të çdo viti

ANEKSI 5 – Problemet mjedisore

Procesi i tranzicionit në Shqipëri është shoqëruar me probleme të ndjeshme për mjedisin. Zhvillimi i ekonomisë së tregut në Shqipëri, qysh prej vitit 1990, ka sjellë një migrim të ndjeshëm të brendshëm nga fshati në qytet në mënyrë të paplanifikuar, dhe tani mendohet se përafërsisht 45% e popullsisë jetojnë në zonat urbane. Krahas shtimit të popullsisë në qytet, ende nuk ekziston trajtimi i ujrave të zeza dhe mbisundon një menaxhim i dobët i mbetjeve të ngurta. Ndotja e ajrit në qytete është rritur për shkak të rritjes së numrit të veturave private, sidomos të atyre që importohen të përdorura, të cilat kanë standarte më të ulëta mjedisore (psh ato me motor naftë). Banuesit e rinj në qytet, që shpesh janë të varfër dhe jetojnë në banesa të paligjshme, janë më shumë të zbuluar kundrejt rreziqeve të tilla mjedisore urbane. Ndotja industriale nga industritë kryesore (industritë e pasurimit të naftës, bakrit dhe kromit si edhe ato të çimentos) vazhdojnë të përbëjnë problem. Pesë “zona të nxehta” në të cilat përfshihen edhe zona industriale të braktisura, që janë kthyer në qendra banimi për migrantët, mbeten një rrezik për shëndetin publik. Porto Romano, pranë Durrësit, portit kryesor të Shqipërisë në Detin Adriatik, është njëri prej “zonave të nxehta” të një uzine kimike të braktisur, e cila dikur ka prodhuar insekticidin lindan dhe kromat natriumi i cili është përdorur në industrinë e rregjjes së lëkurëve. Më në fund kanë filluar përgatitjet për shpërnguljen dhe sistemimin e banorëve të rinj dhe për pastrimin e Porto Romanos. Në zonat fshatare, për shkak të brishtësisë së shtresave të sipërme të tokës, degradimi i tokës konsiderohet si njëra prej çështjeve më jetike, ndërsa gërryerja përbën një problem të përhapur. Përafërsisht 25% e tokës në Shqipëri vuan nga gërryerja natyrore e tokës (20 deri në 30 ton për hektar në vit). Për shkak të faktorëve njerëzor siç është “braktisja e tokës”, përqindja e erozionit është rritur deri në shifrën 150 ton/ha/vit. Edhe përdorimi i tepërt i tokës për kullotje të bagëtive përbën një rrezik të ndjeshëm për kullotat natyrore (të cilat nuk mund ta përballojnë më numrin gjithsej të krerëve të deleve dhe dhive në vend, që është rreth 3 milion) dhe kjo ka dëmtuar edhe ripërtëritjen e pyjeve. Prerja e paligjshme e pyjeve dhe gjuetia e tepërt e kanë përshpejtuar humbjen e biodiversitetit.

Konsultimet me publikun dhe organizatat mjedisore

Megjithëse Shqipëria e ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Arhusit (2000), procedurat e dhënies së informacionit dhe pjesëmarrjes së publikut nuk zbatohen nga autoritetet publike. Kohët e fundit, Ministria e Mjedisit ka filluar të zbatojë detyrimet e konventës përmes praktikave të reja dhe kuadrit të duhur ligjor. Nga ana tjetër, autoriteteve u mungon kapaciteti, dija dhe kualifikimet për të praktikuar deklarimin e informacionit të publikun dhe konsultimet në kuadër të menaxhimit të mjedisit.

Në Shqipëri ka rreth 75 grupe mjedisore të regjistruara, të cilat ushtrojnë aktivitetet në nivel vendor dhe kombëtar. Ato janë të përhapura në të gjithë vendin, por sidomos në qytetet e mëdha dhe pranë zonave me vlera konkrete natyrore. Vëmendja kryesore e tyre drejtohet nga biodiversiteti, problemet në qytet, edukimi mjedisor dhe mbrojtja e burimeve natyrore. Organizatat kryesore mjedisore joqeveritare në Shqipëri janë “Shoqata e Ruajtjes dhe e Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri” dhe “Shoqata për Ruajtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve të Shqipërisë”.

Lëvizja mjedisore dhe dukuria e OJQ-ve janë aspekte të reja të shoqërisë civile shqiptare. Nevoja për bashkëpunim midis OJQ-ve mjedisore është rritur së bashku me

ritjen e aktivitetit të tyre. Janë arritur dhe po arrihen një mori aktivitete në mënyrë të përbashkët nga disa OJQ, mirëpo niveli i bashkërendimit brenda bashkësisë lipset të fuqizohet më tej.

Edukimi mjedisor

Ndërgjegjësimi dhe edukimi mjedisor konsiderohet si një faktor kyç për mobilizimin e bashkësive për mbrojtjen e mjedisit dhe për menaxhimin e duhur të burimeve natyrore. Megjithatë, aktivitetet në këtë fushë janë ende minimale, sidomos në fshat, dhe nuk janë futur në mënyrë të strukturuar në programet shkollore. Përpjekjet e para për përgatitjen e materialeve edukative dhe të librave për mjedisin janë një dukuri e kohëve të fundit, e cila kryesisht ka mbështetjen e organizatave ndërkombëtare.

Institucionet e tjera

Mes organizatave të tjera, Banka Botërore ka zbatuar dhe po zbaton disa projekte në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të menaxhimit të burimeve ujore, të menaxhimit të burimeve natyrore dhe të menaxhimit të zonës bregdetare në Shqipëri. UNDP e ka mbështetur Ministrinë e Mjedisit në lidhje me një plan kombëtar zbatimi për Ndotësit Organik Rezistues (“POPs”) në kuadër të Konventës së Stokholmit për këta ndotës, me synimin për të larguar shkallë-shkallë këta ndotës dhe për t’i pastruar zonat e ndotura. Projekti do t’i japë mundësi Shqipërisë ta ratifikojë këtë Konventë. BE-ja do të vijojë të monitorojë ecurinë e mjedisit në vend në kuadër të harmonizimit mjedisor me BE-në. Banka do të vijojë të bashkëpunojë me organizatat e tjera për të përfituar nga bashkimi i forcave dhe për të shmangur mbivendosjen dhe dublikimin e punëve.

ANEKSI 6 – Operacionet e miratuara të Bankës

Projektet e miratuara të BERZH-it në Shqipëri, deri më datën 31 dhjetor 2005

Emri i operacionit	Borxh	Kapital i vet	Garanci tregtare	Nënshkruar nga BERZH	Kosto gjithsej	Privat / Publik	Aktiv / Mbaruar
Institucionet financiare							
<i>Sektori bankar</i>							
Banca Italo-Albanese		11.5		11.5	20.0	Privat	Aktiv
ProCredit Bank		1.1		1.1	4.8	Privat	Aktiv
Linja e kredisë për rimëkëmbjen e NVM-ve	1.2			1.2	1.2	Privat	Ka mbaruar
Banka Kombëtare Tregtare		2.3		2.3	9.1	Privat	Aktiv
TFP: American Bank of Albania*			2.5			Privat	Ka mbaruar
TFP: Banca Italo-Albanese*			2.0			Privat	Ka mbaruar
<i>Sektori jobankar</i>							
INSIG		5.3		5.3	10.4	Privat	Aktiv
Fondi i Kapitalit për Rindërtimin e Shqipërisë **		2.8		2.8	7.3	Privat	Aktiv
Infrastruktura							
<i>Sektori i energjistikës</i>							
Transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike ***	0.1			0.1	34.2	Publik	Ka mbaruar
Kaskada e lumit Drin***	1.4			1.4	80.9	Publik	Ka mbaruar
Rindërtimi i sektorit të energjisë	30.0			30.0	63.2	Publik	Aktiv
Rehabilitimi i shpërndarjes së energjisë	24.0			24.0	190.4	Publik	Aktiv
Termocentrali në Vlorë	40.0			40.0	107.1	Publik	Aktiv
<i>Sektori i transportit</i>							
Rehabilitimi i rrugëve	17.0			17.0	24.9	Publik	Aktiv
Terminali i aeroportit të Tiranës	21.0			21.0	50.3	Privat	Aktiv
Rruga Fier-Tepelenë	35.0			35.0	109.0	Publik	Aktiv
Industria e përgjithshme							
Fabrika e Çimentos në Fushë-Krujë	25.4			25.4	109.9	Privat	Aktiv
Sektori i telekomunikacionit							
Telekomi Shqiptar (Albtelekom)	8.3			8.3	40.9	Publik	Aktiv
Vodafone Albania	24.7			24.7	72.5	Privat	Aktiv
Sektori i agrobiznesit							
Coca-Cola Tirana		3.4		3.4	11.6	Privat	Ka mbaruar
Morpack	4.0			4.0	7.0	Privat	Aktiv
Sektori i pronave, turizmit dhe transportimit							
Hotel Tirana	10.1	0.8		10.9	18.4	Privat	Ka mbaruar
Hotel Rogner	19.6	2.0		21.6	27.0	Privat	Aktiv
Gjithsej për vendin	261.8	29.2	4.5	291.0	1,000.1		

Vlera Pesha Numri Pesha

Private	126.2	43.4%	13.0	62%
Shtetërore	164.8	56.6%	8.0	38%

* - Garancitë TFP nuk përfshihen në shifrën e numrit të projekteve

** - Banka ka nënshkruar 11 investime në kuadër të AREF, duke e çuar numrin gjithsej të projekteve në Shqipëri në 32 (nga të cilët, 24 në sektorin privat)

*** - Financimi i Bankës u ristrukturua dhe u përfshi në kuadër të Projektit të Rindërtimit të Sektorit të Energjisë

ANEKSI 7 – Programet e Bankës për bashkëpunim teknik

Përmbledhje progresive, deri më 31 dhjetor 2005

Angazhimi sipas sektorëve	€ Të angazhuar	€ Të lëvruar
Bujqësi, pyje	154,013	154,013
Shërbime sociale / komunitet	511,816	511,816
Energjitiqë	4,614,231	4,313,452
Industri nxjerrëse	243,090	243,090
Financë, biznes	6,056,668	5,479,467
Shërbimet e autoriteteve vendore	141,957	141,957
Prodhim	41,216	41,216
Telekomunikacion	1,970,039	1,970,039
Turizëm	222,763	222,763
Transport / Ndërtim	1,191,506	1,028,454
SHUMA GJITHSEJ (82 angazhime)	15,147,298	14,106,268

Lista e hollësishme e operacioneve, deri më 31 dhjetor 2005

Emri i angazhimit	Euro të angazhuara	Euro të lëvruara	Fonde të miratuara deri	Statusi i angazhimit	Spektori
Këshilltar për privatizimin, pranë Hotel Tirana	40,258	40,258	12/08/02	Ka mbaruar	Shërbime komunitare/sociale
Fondi i Kapitalit për Rindërtimin e Shqipërisë	2,262,886	2,262,886	01/12/98	Ka mbaruar	Financë, biznes
Fondi i Kapitalit për Rindërtimin e Shqipërisë	141,678	141,678	26/11/03	Ka mbaruar	Financë, biznes
Fondi i Kapitalit për Rindërtimin e Shqipërisë – zgjatje e kontratës së konsulencës	156,475	99,633	04/02/05	Në lëvrim	Financë, biznes
Fondi i Kapitalit për Rindërtimin e Shqipërisë	25,359	0	18/11/05	Është angazhuar	Financë, biznes
Planifikimi i investimeve në sektorin e energjitikës – Lumi Drin (rehabilitim i hidrocentraleve të vogla)	47,267	47,267	15/11/94	Ka mbaruar	Energjitikë
Rruga Fier-Tepelenë: konsulent i monitorimit të huadhënies	128,670	0	13/05/05	Është angazhuar	Ndërtim
Nisma e Evropës Qendrore – projekt për raportimin e informacionit për transportin (hartimi dhe mbikqyrja)	156,621	156,621	10/04/94	Ka mbaruar	Transport, magazinim
Shërbime këshillimore bashkëfinansimi	22,827	22,827	10/07/95	Ka mbaruar	Shërbime komunitare/sociale
Hua të Nismës së Evropës Qendrore për biznesmenët e vegjël në Shqipëri	268,586	268,586	13/07/00	Ka mbaruar	Financë, biznes
Asistenca për privatizimin nga Nisma e Evropës Qendrore për INSIG-un (Shqipëri)	495,000	0	15/07/05	Është angazhuar	Financë, biznes
Financimi i projektit mjedisor të Danimarkës	130,593	130,593	22/12/94	Ka mbaruar	Shërbime të autoriteteve vendore
Programi i zhvillimit institucional – analizë vlerësuese e kërkesave për zhvillimin menaxherial	48,000	48,000	20/12/92	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Programi i zhvillimit institucional – kontabiliteti dhe financa	258,901	258,901	20/01/93	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Programi i zhvillimit institucional – funksionimi dhe mirëmbajtja	390,660	390,660	20/01/93	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Programi i zhvillimit institucional – menaxhimi dhe zbatim i projektit	0	0	20/01/93	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Programi i zhvillimit institucional – studim diagnostikues strategjik dhe organizativ	49,000	49,000	12/02/93	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Studim për përmirësimin dhe rehabilitimin e hidrocentraleve	161,437	161,437	12/02/93	Ka mbaruar	Energjitikë
Programi i zhvillimit institucional – zbatim organizativ dhe menaxherial	383,726	383,726	20/05/93	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Programi i zhvillimit institucional – vënia në punë dhe mirëmbajtja – Komponenti IV (i)	0	0	20/05/93	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Krijimi i parqeve industriale – studim parafizibiliteti	91,805	91,805	03/06/93	Ka mbaruar	Ndërtim
Qendra e trajnimit bankar	127,923	127,923	20/12/93	Ka mbaruar	Financë, biznes
Qendra e trajnimit bankar	60,320	60,320	17/12/93	Ka mbaruar	Financë, biznes
Qendra e trajnimit bankar	31,715	31,715	17/12/93	Ka mbaruar	Financë, biznes
Asistencë për grupin e posaçëm të punës, Parku Industrial Durrës	62,269	62,269	22/11/96	Ka mbaruar	Shërbime komunitare/sociale
Projekti i rehabilitimit të rrugëve në Shqipëri	679,410	679,410	14/12/98	Ka mbaruar	Ndërtim
Projekti teknik i rrjeteve të pajtimtarëve	50,470	50,470	30/09/93	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Këshilltar kontabël për bankat e nivelit të dytë	131,231	131,231	08/10/93	Ka mbaruar	Financë, biznes
Programi i zhvillimit administrativ dhe rregullator i telekomunikacioneve	64,250	64,250	13/10/98	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Privatizimi i Albkromit – këshillim në fushën e minierave	90,285	90,285	01/12/92	Ka mbaruar	Industri nxjerrëse

Takimi vjetor 1999 – Strehim i delegacionit shqiptar	1,306	1,306	09/07/99	Ka mbaruar	Shërbime komunitare/sociale
Asistencë ligjore – shfrytëzimi i naftës në tokë	61,839	61,839	28/06/93	Ka mbaruar	Industri nxjerrëse
Programi i zhvillimit institucional – menaxhimi dhe zbatimimi i projektit	43,809	43,809	01/10/93	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Telekomunikacioni shqiptar – këshillim për njësinë e zbatimit të projektit	31,025	31,025	23/06/95	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Krijim i parqeve industriale – studim parafizibiliteti	30,000	30,000	12/08/94	Ka mbaruar	Ndërtim
Krijim i qendrës së nxitjes së biznesit	39,602	39,602	29/01/94	Ka mbaruar	Financë, biznes
Studim fizibiliteti për industrinë pyjore	154,013	154,013	09/09/93	Ka mbaruar	Bujqësi, pyje, peshkim
Privatizim i telekomunikacioneve – këshillim ligjor	12,819	12,819	13/03/95	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Studim fizibiliteti për transmisionin e energjisë	204,267	204,267	20/04/95	Ka mbaruar	Energjitiqë
Bankë hipotekore – këshillim ligjor	25,654	25,654	21/12/95	Ka mbaruar	Financë, biznes
Bankë hipotekore – analizë tregu	25,654	25,654	21/12/95	Ka mbaruar	Financë, biznes
Parku industrial i Durrësit – asistencë teknike për grupin e posaçëm të punës	46,149	46,149	15/01/97	Ka mbaruar	Shërbime komunitare/sociale
Asistencë për drejtorinë e KESH-it	1,896,862	1,896,862	30/06/00	Ka mbaruar	Energjitiqë
Asistencë për drejtorinë e KESH-it	578,368	578,368	14/03/03	Ka mbaruar	Energjitiqë
Asistencë për drejtorinë e KESH-it – zgjatje e dytë e kontratës ekzistuese	810,407	810,407	20/04/04	Ka mbaruar	Energjitiqë
Asistencë për drejtorinë e KESH-it	300,779	0	26/10/05	Është angazhuar	Energjitiqë
Master-plani i telekomunikacioneve	197,708	197,708	01/05/92	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Bankat e nivelit të dytë – krijimi i sistemeve të kontabilitetit	193,200	193,200	01/09/92	Ka mbaruar	Financë, biznes
Përgatitja e specifikimeve të tenderit	154,907	154,907	01/10/92	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Zhvillimi i sistemit bankar	27,144	27,144	01/12/92	Ka mbaruar	Financë, biznes
Trajnimi i bankave të nivelit të dytë	147,692	147,692	01/01/93	Ka mbaruar	Financë, biznes
Këshillim për zhvillimin e turizmit	63,430	63,430	01/07/93	Ka mbaruar	Tregti, turizëm
Rehabilitimi i kaskadës së lumit Drin – punët inxhinierike dhe menaxhimi i projektit	363,694	363,694	01/11/94	Ka mbaruar	Energjitiqë
Telekomunikacioni shqiptar – hartimi i politikave sektoriale	44,972	44,972	01/02/95	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Studim fizibiliteti për zhvillimin e telekomunikacionit rural	12,996	12,996	07/06/96	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Programi TAM - Ajka	11,226	11,226	20/07/01	Ka mbaruar	Prodhim
Shfrytëzimi i naftës në tokë – vlerësim dhe negociim i ofertave të huaja	130,223	130,223	01/09/92	Ka mbaruar	Energjitiqë
Studim matës i rendimentit të turbinave	79,741	79,741	01/03/93	Ka mbaruar	Energjitiqë
Rehabilitimi i sektorit të energjitiqës	16,964	16,964	01/09/92	Ka mbaruar	Energjitiqë
Teknikat e ristrukturimit të bankave / trajnim	11,364	11,364	01/10/91	Ka mbaruar	Shërbime të autoriteteve vendore
Kontabiliteti i bankave të nivelit të dytë	27,270	27,270	01/02/92	Ka mbaruar	Financë, biznes
Uzina e koksit	24,223	24,223	01/02/92	Ka mbaruar	Energjitiqë
Përdorimi i çentreve konteinere	65,889	65,889	01/02/92	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Zhvillimi i turizmit – studime për turizmin	103,422	103,422	01/04/92	Ka mbaruar	Tregti, turizëm
Këshilltar për industrinë e kromit	90,966	90,966	01/04/92	Ka mbaruar	Industri nxjerrëse
Analizë për mjedisin	49,187	49,187	01/04/92	Ka mbaruar	Shërbime komunitare/sociale
Zhvillimi i turizmit – ndryshimet ligjore dhe institucionale	55,911	55,911	01/05/92	Ka mbaruar	Tregti, turizëm
Bankat e nivelit të dytë – pajisje kompjuterike për sistemet e kontabilitetit (pjesa e lidhur)	149,466	149,466	01/07/92	Ka mbaruar	Financë, biznes
Negociata me kreditorët e jashtëm	77,364	77,364	01/10/92	Ka mbaruar	Financë, biznes
Seminar pune parlamentar	26,912	26,912	01/06/93	Ka mbaruar	Shërbime komunitare/sociale
Tirana Hotel	245,000	245,000	27/06/01	Ka mbaruar	Shërbime komunitare/sociale

Programi <i>TurnAround Management</i> - Instituti I Sigurimeve	29,990	29,990	01/05/96	Ka mbaruar	Prodhim
Programi <i>TurnAround Management</i> -kontratë për shërbime këshillimore: Alb-Baker	17,907	17,907	01/06/96	Ka mbaruar	Shërbime komunitare/sociale
Programi i zhvillimit administrativ dhe rregullator të telekomunikacioneve	25,058	25,058	02/12/98	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Shqyrtim i projekt-ligjit për telekomunikacionet	9,810	9,810	01/02/95	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Programi i zhvillimit administrativ dhe rregullator të telekomunikacioneve	80,185	80,185	13/10/98	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Programi i zhvillimit administrativ dhe rregullator të telekomunikacioneve	15,911	15,911	03/09/99	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Asistencë për procesin e përzgjedhjes së operatorit të dytë GSM	29,945	29,945	17/11/99	Ka mbaruar	Telekomunikacione
Projekti i rehabilitimit të rrugëve – konsulent i huadhënësit për monitorimin	105,000	70,619	20/03/00	Në lëvrim	Ndërtim
INSIG – këshilltar sigurimesh për Drejtorin e Përgjithshëm	23,542	23,542	22/04/03	Ka mbaruar	Financë, biznes
FEFAD Bank – zgjerim i degëve	1,041,163	1,041,163	22/08/00	Ka mbaruar	Financë, biznes
FEFAD Bank – mbështetje për zgjerimin e degëve	577,743	577,743	04/12/01	Ka mbaruar	Financë, biznes
Numri i angazhimeve:	15,147,298	14,106,268			
	82				

ANEKSI 8 – Lista e projekteve në shqyrtim

Lista e projekteve në shqyrtim në Shqipëri për 2006/2007

Projekti	Faza	Euro (mln)
Terminali i Tragetëve në Durrës	CR	25.0
Rehabilitimi i Nënstacioneve të Transmetimit të Energjisë	CR	16.5
Rrugët e Bashkisë së Tiranës dhe Mbikalimi i Kamzës	CR	14.0
Terminali Detar i Naftës dhe Gazit në Vlorë	SR	12.0
Union Bank – Tiranë	CR	3.0
WB SME: Banka Popullore	EX	5.0
WB SME: Banka Credins	EX	5.0
Telekomi Shqiptar	CR	45.0
Shitje me pakicë	CR	12.5
Rruga Fier-Vlorë	PreEX	20.0
Rruga Durrës-Kukës	PreEX	30.0
Totali		188.0

ANEKSI 9 – Asistenca shumëpalëshe dhe dypalëshe

I. ASISTENCA SHUMËPALËSHE

Më poshtë jepen, sipas renditjes alfabetike, donatorët kryesorë shumëpalësh në Shqipëri:

BE – PHARE / CARDS

Asistenca e BE-së për Shqipërinë filloi në vitin 1991 përmes programit PHARE. Gjatë periudhës 1991-2005, angazhimet e BE-së gjithsej për Shqipërinë kanë qenë mbi 1.1 miliardë euro, e cila përfshin ndihmën nga programi PHARE dhe nga programe të tjera siç janë ECHO (ndihmë humanitare), EDHIR (masa për demokracinë dhe të drejtat e njeriut) etj. Mbështetja nga BE-ja ka mbuluar një numër të madh sektorësh, ku përfshihen infrastruktura, reforma e administratës publike, bujqësia, shëndetsia, arsimi, gjyqësori dhe kontrolli i zbatimit të ligjit, ndihma humanitare, demokracia dhe të drejtat e njeriut dhe bashkëpunimi ndërkuftar.

Qysh prej vitit 2001, instrumenti kryesor financiar i KE-së për bashkëpunimin në vendet e Ballkanit është Programi i Ndihmës nga Komuniteti për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim (“CARDS”). Gjatë periudhës 2001-2005, angazhimet në kuadër të programit kombëtar CARDS për Shqipërinë kanë qenë 237 milion euro.

Strategjia e programit CARDS shprehet në Dokumentin Strategjik për Shqipërinë, 2002-2006, përgatitur nga Komisioni Evropian dhe Qeveria e Shqipërisë.

Prioritetet kryesore për financim në kuadër të programit CARDS, sipas Dokumentit Strategjik për Shqipërinë, janë:

- Legjislacioni;
- Ngritja e kapaciteteve administrative
- Zhvillimi ekonomik dhe social
- Burimet mjedisore dhe natyrore
- Stabiliteti dhe demokracia.

Për vitin 2006, CARDS ka vendosur 45.5 milion euro për Shqipërinë.

Tani po përgatitet Programi Indikativ Kombëtar 2007-2009. Duke filluar nga viti 2007, si një vend i mundshëm kandidat, Shqipëria do të përfitojë nga IPA (Instrumenti për Para-Anëtarësimin).

Në muajin prill 2004, Këshilli i Evropës vendosi t'i japë Shqipërisë asistencë makrofinanciare (“AMF”), me një vlerë maksimale prej 25 milion euro, të cilat përfshijnë 16 milion euro në formë granti dhe 9 milion euro si hua. Kjo asistencë ka si qëllim të lehtësojë pengesat e Shqipërisë për financim të jashtëm, të mbështesë bilancin e pagesave dhe të fuqizojë pozicionin e valutës së huaj. Vëmendja e kushteve të kësaj asistence drejtohet nga menaxhimi i financave publike, reforma në administratën publike dhe sektorin financiar, si edhe nga përmirësimi i mjedisit të

biznesit dhe zhvillimi i sektorit privat. Pjesa e parë është çelur pjesërisht: një komponent granti prej 3 milion euro është paguar në muajin nëntor 2005, ndërsa pagesa e komponentit të huasë prej 9 milion euro është në proces.

BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE

BEI është një aktor kryesor në zbatimin e objektivave prioritare të BE-së në zonën e Ballkanit. Aktive në Shqipëri prej vitit 1994, BEI ka kontribuar me mbi 240 milion euro për projekte të një rëndësie kyçe për ekonominë shqiptare, siç janë investime të ndryshme në fushën e infrastrukturës dhe nxitja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes një kredie globale (linje kredie) për sektorin bankar të Shqipërisë.

Gjatë periudhës 2000-2005, BEI ka dhënë hua të cilat përfshijnë 34 milion euro për rehabilitimin e korridorit Veri-Jug, 30 milion për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë (një projekt i bashkëfinancuar nga BERZH, BB dhe donatorë të tjerë dypalësh), 17 milion euro për rehabilitimin e Portit të Durrësit dhe 27 milion euro për rehabilitimin e objekteve të ujësjellës-kanalizimeve në pesë qytete të Shqipërisë në kuadër të një skeme koncesionare nga KE dhe donatorë të tjerë, 40 milion euro për financimin e termocentralit të Vlorës dhe 35 milion euro për bashkëfinancimin e një segmenti tjetër të korridorit Veri-Jug.

Strategjia afatmesme e BEI-t për Ballkanin Perëndimor ka identifikuar si fusha prioritare investimesh infrastrukturat e transportit dhe të energjitikës. Në përputhje me këto prioritete BEI po bashkëpunon me BERZH-in për të bashkëfinancuar terminalin e trageteve në Portin e Durrësit.

FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

Shqipëria u bë pjesë e Fondit Monetar Ndërkombëtar në muajin tetor 1991. Qysh atëherë, Shqipëria ka përfituar nga katër programe të FMN-së, të cilët mbështesin reformat e qeverisë për ndryshim ekonomik. Programi trevjeçar i Linjës së Rregullimit të Përmirësuar të Strukturuar i FMN-së ("ESAF"), i cili u miratua nga Bordi Ekzekutiv i FMN-së në muajin maj 1998, mbaroi në muajin korrik 2001. I mbështetur nga një huadhënie prej 60 milion USD gjithsej, ky program mbështeti politikat fiskale dhe monetare të Shqipërisë si edhe reforma të tjera kryesore institucionale, siç janë privatizimi i ndërmarrjeve strategjike dhe të vogla e të mesme dhe reforma e administratës publike për të pakësuar hapësirat për korrupsion dhe për të rritur transparencën.

Më 1 gusht 2005 Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Financiar mbaroi shqyrtimin e gjashtë të performancës së Shqipërisë në kuadër të programit trevjeçar të Linjës për Uljen e Varfërisë dhe Rritjen Ekonomike ("PRGF"). Mbarimi i këtij shqyrtimi do të mundësojë çeljen e një vlefte të barazvlefshme me 4.0 milion SDR (rreth 5.8 milion USD), të cilat e çojnë lëvrimin gjithsej në kuadër të programit në 28.0 milion SDR (rreth 40.5 milion USD).

Programi trevjeçar është miratuar më 21 qershor 2002, me një vlerë gjithsej prej 28.0 milion SDR (rreth 40.5 milion USD).

PRGF është linja më koncesionare e FMN-së për vendet me të ardhura të pakta. Programet e mbështetura nga PRGF mbështeten te strategjitë për uljen e varfërisë, të cilat vendet përkatëse i kanë miratuar përmes një procesi me pjesëmarrje, ku janë përfshirë edhe shoqëria civile dhe partnerët për zhvillim, dhe janë të shprehura në formën e Dokumentave Strategjike të Uljes së Varfërisë.

GRUPI I BANKËS BOTËRORE / SHNZH

Shqipëria u anëtarësua në Bankën Botërore dhe Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (“SHNZH”) në muajin tetor 1991. Asistenca e Bankës për Shqipërinë vijon t’i kushtojë vëmendje në periudhën afatmesme uljes së varfërisë përmes investimeve në sektorët kyç, mbështetjes për përmirësimin e qeverisjes dhe luftën kundër korrupsionit, thellimit të reformave kryesore strukturore dhe sektoriale dhe përmirësimin të menaxhimit të infrastrukturës. Operacionet specifike do të ndihmojnë përsheptimin e privatizimit të sektorëve kyç, ristrukturimin e ndërmarrjeve publike të shërbimeve komunale dhe zhvillimin e mbështetur te komuniteti. SHNZH-ja vijon të japë asistencë për përmirësimin e menaxhimit të shpenzimeve publike dhe për t’u kujdesur që burimet publike akordohen në funksion të zbutjes së varfërisë dhe zhvillimit të qendrueshëm në vend.

Deri tani, angazhimet e huave të Bankës Botërore për Shqipërinë janë 820 milion USD gjithsej për 59 projekte. Nga këto, 14 projekte janë aktive, ndërsa pjesa tjetër kanë mbaruar. 657 milion USD janë lëvruar deri tani në kuadër të këtyre projekteve. Aktualisht, ka 20 projekte në proces të cilët arrijnën shifrën prej 283.5 milion USD gjithsej në formë kredie.

Banka Botërore po përgatit Strategjinë e re të Asistencës për Shqipërinë (“CAS”) për vitet fiskale 2006–2009. CAS i ri, i cili është i katërti CAS që ka nxjerrë Grupi i Bankës Botërore për Shqipërinë, parashikon një program huadhënieje deri në 86 milion USD nga SHNZH-ja (Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim) dhe 110 milion USD nga BNRZH (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim). Përgatitja e strategjisë së re po bëhet me mbështetjen e konsultimeve të gjera me Qeverinë, Parlamentin, shoqërinë civile, sektorin privat, donatorët dhe palë të tjera të interesuara. CAS do të mbështesë programin e Shqipërisë për zhvillim, siç është shprehur në Strategjinë e saj Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social (“SKZHES”). Dy shtylla do të jenë komponentët kryesorë të kësaj strategjie të re: rritja ekonomike përmes mbështetjes për zhvillimin e sektorit privat dhe përmirësimi i realizimit të shërbimeve, sidomos në sektorët socialë. Vëmendje e veçantë do t’u kushtohet çështjeve të qeverisjes, të cilat do të trupëzohen në të gjitha programet dhe projektet.

GRUPI I BANKËS BOTËRORE / KFN

Shqipëria u bë anëtare e Korporatës Financiare Ndërkombëtare (“KFN”) në vitin 1991. Strategjia e KFN-së për Shqipërinë është të mbështesë zhvillimin e sektorit privat dhe të përmirësojë mjedisin e biznesit. Në punën e saj ajo i kushton vëmendje nevojës për të rritur fluksin e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në vend dhe të

ndihmojë futjen e konceptit të partneritetit publik-privat (PPP) në sektorët socialë dhe të infrastrukturës. KFN-ja po e përshkallëzon angazhimin e vet:

- (i) për të rritur mbështetjen për sektorin financiar dhe për të fuqizuar tregun financiar;
- (ii) për të ndihmuar ristrukturimin dhe për të kërkuar mundësi për investime në sektorë kryesorë strategjikë: transport, energjitikë, furnizim me ujë dhe telekomunikacione;
- (iii) për të ndihmuar dhe fuqizuar tregjet përkatëse strategjike duke ofruar asistencë teknike për përmirësimin e organeve rregullatore në telekomunikacione dhe energjitikë;
- (iv) për të dhënë shërbime këshillimore për partneritetin publik-privat në sektorët strategjikë dhe socialë;
- (v) për të dhënë asistencë financiare dhe teknike për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Angazhimi i KFN-së në Shqipëri është 125 milion USD. Investimet përfshijnë sektorë të tillë si ai financiar (7%), prodhimi i përgjithshëm (37%), infrastruktura (33%) dhe nafta e gazi (23%).

Përveç kësaj, KFN-ja ka realizuar 10 projekte të asistencës teknike duke përfshirë sigurimet, huadhënien e aktiveve (lizingu), marrjen e informacionit nga NVM-të, përgatitjen e shoqërive vendase për anëtarësimin në BE, pengesat administrative për investuesit dhe financimin e strehimit.

KFN-ja dhe BERZH-i kanë bashkëfinancuar projekte në sektorin financiar (Banka ProCredit, Banka Kombëtare Tregtare, INSIG) dhe në sektorin privat të shoqërive aksionere në Shqipëri (Vodafone Albania, Fabrika e Çimentos në Fushë Krujë)

II. ASISTENCA DYPALËSHE

Donatorët më të mëdhenj dypalësh në Shqipëri janë si më poshtë, të renditur sipas rendit alfabetik:

GJERMANIA

Qeveria Gjermane, si njëri prej partnerëve më të rëndësishëm të Shqipërisë në bashkëpunimin për zhvillim, ka angazhuar deri tani një vlerë progresive prej rreth 250 milion euro, nga të cilat 233 milion euro në bashkëpunim financiar dhe 16.4 milion euro në asistencë teknike.

Gjatë periudhës 2004 deri 2005, Gjermania ka dhënë 21.4 milion euro për bashkëpunimin financiar dhe 4.75 milion euro për bashkëpunimin teknik.

Projektet e bashkëpunimit financiar janë zbatuar nga KfW në emër të Qeverisë Federale Gjermane dhe janë përqendruar në sektorët e mëposhtëm:

- *Ujësjellës dhe kanalizime* – projekte në disa qytete si për investime për rehabilitimin e sistemeve të ujësjellsave ashtu edhe për zbatimin e masave të mbështetjes institucionale në nivel njësie vendore.
- *Sektori financiar* – projekti kryesor është Banka ProCredit, institucioni kryesues në Shqipëri për mikro-kreditë, aksionerë të së cilës janë edhe BERZH-i dhe KFN-ja.
- *Energjitikë* – projektet kryesore janë rehabilitimi i hidrocentralit të Bisticës dhe linja 400 kV nga Tirana në Podgoricë (Mal të Zi). Paralelisht, po bëhen edhe përmirësime institucionale dhe financiare në këtë sektor në bashkëpunim të ngushtë me IFN dhe donatorë të tjerë.
- *Infrastrukturë* – njëra prej ndërhyrjeve më të rëndësishme në këtë sektor ka qenë rindërtimi i pistës së Aeroportit të Tiranës.
- *Infrastruktura e vogël sociale dhe strehimi* – përfshin angazhime për nxitjen e qasjeve që kërkojnë shumë krah pune dhe zbatimin me pjesëmarrje.

Programet e asistencës teknike zbatohen nga agjencia qeveritare GTZ dhe kanë në qendër të vëmendjes formimin arsimor/profesional, nxitjen e zhvillimit rural, fuqizimin e sistemin ligjor.

Gjatë vitit 2006 bashkëpunimi do të vazhdojë të ketë në qendër të vëmendjes sektorët e energjitikës dhe të ujësjellës-kanalizimeve. Fusha të tjera prioritare do të jenë edhe zhvillimi i infrastrukturës së vogël sociale dhe mbrojtja e mjedisit.

GREQIA

Përveçse është partneri i dytë më i madh tregtar i Shqipërisë dhe njëri prej dërguesëve kryesorë të IHD-ve, Greqia ka dhënë edhe ndihmë me grante dhe fonde të bashkëpunimit teknik, kryesisht në fushën e bujqësisë, infrastrukturës së strehimit në qytet dhe në fshat dhe të shërbimeve sociale (shëndetësi, arsim) me një shumë gjithsej prej 279 milion USD gjatë periudhës 1997-2004.

Greqia ka nënshkruar një program pesëvjeçar (2002-2006) bashkëpunimi për zhvillim me Shqipërinë në kuadër të Planit Grek për Rindërtim Ekonomik të Ballkanit me një angazhim gjithsej prej 50 milion euro. Programi për zhvillim ka në qendër të vëmendjes: (i) modernizimin e infrastrukturës, sidomos të energjitikës dhe transportit; (ii) nxitjen e investimeve produktive; (iii) modernizimin e administratës publike dhe të vetëqeverisjes; (v) mbështetjen për shtetin ligjor dhe ndihmën sociale; (vi) zgjidhjen e pabarazive ekonomike; dhe (vii) mbështetjen për arsimin dhe formimin profesional dhe për potencialin administrativ dhe shkencor.

ITALIA

Italia është donatori më i madh dypalësh i Shqipërisë me një vlerë progresive gjithsej të fondeve të lëvruara gjatë periudhës 1991-2004 mbi 600 milion euro. Ndihma e Italisë për Shqipërinë është zhvilluar, nga një ndihmë për periudhën e emergjencës në fazat e para të tranzicionit dhe në kohërat e krizave, në një qasje zhvillimi më afatgjatë. Programi i asistencës për Shqipërinë 2002-2004 parashikon mbështetje të mëtejshme për një shumë gjithsej prej 202 milion euro. Fushat kryesore përfshijnë:

- *Sektorin e energjisë elektrike* – kjo ka qenë fusha kryesore e mbështetjes qysh prej vitit 1994 kur janë dhënë fonde të konsiderueshme për ndërhyrje emergjente si edhe për rehabilitimin e disa komponentëve të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë. Italia është njëri prej aktorëve aktiv të mbështetjes aktuale ndërkombëtare strukturore për sektorin e energjitikës në Shqipëri së bashku me BERZH-in, Bankën Botërore dhe donatorë të tjerë.
- *Objektet e furnizimit me ujë* – financimi për këtë sektor ka pasur në qendër të vëmendjes zonën rreth Tiranës dhe përfshin asistencë për një program strukturor në mbështetje të shoqërisë së ujësjellësit.
- *Infrastruktura e transportit* – Italia është përfshirë në mënyrë aktive në këtë sektor përmes financimit për rehabilitimin e disa segmenteve rrugore qytetëse dhe kombëtare, përmes asistencës teknike për përmirësime strukturore të Drejtorisë së Rrugëve dhe përmes mbështetjes për mirëmbajtjen dhe riparimin e rrugëve. Italia ka bashkëfinancuar projektin e emergjencës së rehabilitimit të rrugëve me BERZH-in.
- *Shërbimet sociale*, kryesisht sistemet shëndetsore dhe arsimore, kanë përfituar nga mbështetja italiane. Rindërtimi i shkollave, programet e shkëmbimeve universitare, rehabilitimi i qendrave të kujdesit shëndetsor dhe mbështetja menaxheriale kanë qenë disa prej fushave kryesore të ndihmës.

JAPONIA

Një tjetër donator i rëndësishëm për Shqipërinë është edhe Japonia. Asistenca dypalëshe japoneze ka filluar në vitin 1990 dhe përfshin një sërë programesh, nga financimi me grante dhe kreditë deri te asistenca teknike përmes agjencive të bashkëpunimit (OECD, JICA) dhe Fondit të Besimit të BERZH-it dhe të Bankës Botërore. Sektorët kryesorë që kanë përfituar nga asistenca japoneze janë energjitika (që përfshin edhe projektin e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë të bashkëfinancuar me BERZH-in), bujqësia dhe pyjet, ujësjellës-kanalizime, arsimi si edhe mbështetje për buxhetin, bilancin e pagesave dhe reformën e ndërmarrjeve.

ZVICRA

Shqipëria është mbështetur nga Zvicra qysh prej fillimit të bashkëpunimit me vendet e Evropës Lindore. Asistenca zvicerane ka qysh në vitin 1991 që zbatohet nga Sekretariati Shtetëror i Çështjeve Ekonomike (“SECO”), dhe nga viti 1995 përmes Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (“AZZHB”). Në fillim të vitit 1997, u hap në Tiranë Zyra Bashkërenduese për Bashkëpunim dhe Ndihmë Humanitare, e cila financohet në mënyrë të përbashkët nga AZZHB dhe SECO. Kjo zyrë ka për detyrë mbikqyrjen dhe monitorimin e programit të bashkëpunimit zviceran në Shqipëri.

Në shkurt të vitit 2000 është nënshkruar një marrëveshje kuadër për bashkëpunimin teknik me Shqipërinë. Kjo marrëveshje kuadër mbulon të gjitha aktivitetet e realizuara nga AZZHB dhe SECO në Shqipëri. Marrëveshja mbetet në fuqi deri në muajin prill 2006. Çdo projekt është objekt i një marrëveshjeje konkrete me ministritë e linjës.

Strategjia e asistencës zvicerane parashtrohet në Strategjinë e Bashkëpunimit Zviceran me Shqipërinë 2005-2008. Kontributi i asistencës zvicerane përfshin sektorët e ujësjellës-kanalizimeve, prodhimit dhe transmetimit të energjisë, shërbimet shëndetsore, grupet e prekshme, etj.

Asistenca zviceriane gjithsej deri në muajin dhjetor 2004 ka qenë 146.5 milion franga zvicerane. Për vitin 2006, SECO dhe AZZHB kanë akorduar 13 milion franga zvicerane.

SHBA / USAID

USAID ushtron aktivitet në Shqipëri prej vitit 1992. Gjatë kësaj kohe USAID/Shqipëri, përmes Fondit në Mbështetje të Demokracisë në Evropën Lindore (“SEED”), ka lëvruar më shumë se 386 milion USD në mbështetje të tranzicionit dhe zhvillimit afatgjatë në Shqipëri.

Programi i asistencës i USAID synon ta ndihmojë Shqipërinë të ecë drejt një vendi brenda bashkësisë së vendeve demokratike të orientuara nga ekonomia e tregut dhe të bëhet një forcë shtytëse e paqes, stabilitetit dhe prosperitetit në mbarë Evropën Juglindore.

Gjatë vitit 2005, buxheti i programit për Shqipërinë ishte afro 28 milion USD, nga të cilat 21.5 milion USD janë për zbatim nga USAID dhe 6.5 milion USD janë për t’u transferuar në programet e agjensive dhe zyrave të tjera të qeverisë amerikane.

USAID/Shqipëri zbaton një program me gamë të gjerë i cili ka për synim nxitjen e rritjes ekonomike dhe të uljes së varfërisë, fuqizimin e institucioneve demokratike dhe shoqërisë civile, përmirësimin e sistemit ligjor dhe uljen e korrupsionit, rritjen e efikasitetit të sistemit të kujdesit shëndetsor dhe nismat e posaçme të cilat përfshijnë energjitikën, trafikimin e qenieve njerëzore, harmoninë fetare.

USAID punon në partneritet të ngushtë me organizata vullnetare private amerikane, institucione vendase, bizneset amerikane dhe agjensi të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Portofoli i tanishëm i USAID konsiston në 25 aktivitete të mbështetur nga USAID, disa prej të cilëve jepen më poshtë:

- Në shërbim të mikrobizneseve në Shqipëri (ndihmë me mikro-kredi) – *Opportunity International*
- Shërbime të zhvillimit të ndërmarrjeve dhe të tregut të eksporteve (“EDEM”) (zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme) - *Development Alternatives Incorporated (“DAI”)*
- Demokraci dhe qeverisje (zhvillimi i shoqërisë civile) - *National Democratic Institute (“NDI”)*
- Pushteti vendor dhe decentralizimi në Shqipëri - *Urban Institute*
- Administrimi dhe mbështetja e zgjedhjeve - *International Foundation for Electoral Systems (“IFES”)*
- Programi për shtetin ligjor (anti-korrupsioni) - *Casals and Associates*

- Pro Shëndetit (kujdesi shëndetsor parësor) - *University Research Corporation (“URC”)*
- Veprimi ndërkombëtar kundër trafikimit të fëmijëve - *Terre des Hommes*
- Koordinimi i veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore - *Creative Associates International*

ANEKSI 10 – Harta e Shqipërisë

